



Universiteti Politeknik i Tiranës/Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

# **Drejt Prishtinës Metropolitane përmes bashkëpunimit regjional**

Punim disertacioni

Kandidate: Msc Elvida Pallaska

Udhëheqës: Prof. Asoc. Andrea Maliqari

Tiranë, 2014

## PARATHËNIE

---

*Qëllimi i këtij disertacioni është studimi me përdorimin e metodave bashkëkohore në vlerësimin e skenarëve zhvillimorë urban për qytetin e Prishtinës, duke synuar një qytet – metropolitan drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.*

*Konteksti - në rast të këtij studimi, bazohet në rolin historik, socio ekonomik e politik, funksional të shumtë të qytetit të Prishtinës, potencialeve të saj, pritjeve dhe synimeve për zhvillim urban, një qyteti me rol madhor për vendin e regjionin, qyteti metropolitan me zhvillim të bazuar në njohuri, zhvillim ky të cilin e ndjekin qytetet e shumta të suksesshme në Evropë dhe botë. Qyteti i Prishtinës, me rol dhe funksione, rëndësi gjatë historisë dhe ditët e sotme, duhet të quhet qytet amë – qytet metropolitan, porse dhe me këtë rast duhet të përmbushë parametrat e të qenit qytet me zhvillim të qëndrueshëm, zhvillim të bazuar në njohuri. Me bazë të lartë ekonomike, me shkolla e institute kualitative shkencore, kualitet të lartë të jetës, e qasshme dhe atraktive për banorët e vizitorët.*

*Prishtina në kontekst të këtij studimi, do të vlerësohet nëse I përmbush sot kriteret drejt ZHBNJ, sipas trendeve zhvillimore aktuale me potencialet që posedon, apo dhe nëse do të mund të përmbushë në të ardhmen e projektuar e planifikuar. Do të duhet të thuhet se trendi ishte dhe është I zhvillimit urban monocentrik të Prishtinës deri në vitin 2013, është e planifikuar për një zhvillim policentrik të cilat do të vlerësohen si skenarë sikurse dhe skenari i tretë sipas trendit evropjan të zhvillimit të qyteteve, si regjione urbane metropolitane.*

*Analiza - në rast të këtij studimi, bazohet në vlerësimin e tre skenarëve zhvillimorë për qytetin e Prishtinës, sipas parametrave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri: Skenarit të zhvillimit monocentrik, skenarit të zhvillimit policentrik dhe Skenarit të Zhvillimit si Regjion Urban me katër komunat fqinje (Lipjan, FushëKosovë, Kastriot dhe Podujevë).*

*Kjo analizë, vlerësim bëhet me determinimin e nivelit të përmbushjes së parametrave në tri rastet e skenarëve, të cilët më pastaj, në fund do të rezultojnë me listën e kriterëve të cilët do të duhej të përmbushen për të konkluduar dhe rekomanduar zhvillimet e ardhshme urbane dhe hapsinore për qytetin e Prishtinës.*

*Skenarët zhvillimorë për më shumë do të determinojnë nëse Prishtina me pozitën, resurset, planet dhe mundësitë zhvillimore shkon dhe do të mund të shkojë drejt synimit të të qenit metropolitane,*

*sipas përvojave ndërkombëtare dhe kritereve të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri sipas skenarit të parë si qytet me zhvillim monocentrik- trend të zhvillimeve deri në vitin '99; sipas skenarit të dytë policentrik, bazuar në planet zhvillimore urbane dhe hapsinore të pas vitit '99 dhe sipas skenarit të tretë –zhvillimit me organizim të një Qyteti - Regjioni Urban Metropolitan, sipas definicioneve dhe kategorizimit të Bashkimit Evropian për qytete dhe regjione, regjion në bashkëpunim me komunat fqinje (Fushë Kosovë, Kastriot, Podujevë dhe Lipjan).*

*Ky vlerësim I tre skenarëve zhvillimorë bëhet bazuar në pozitën, planet zhvillimore dhe mundësitë zhvillimore për qytet - Regjion Urban Metropolitan, qytet konkurues dhe bartës të zhvillimit ekonomik të vendit, me bazë ekonomike të zhvilluar, krijim dhe avansim të njohurive të reja, krijime të grupëzimeve të reja ekonomike, bashkëpunime të reja arsimore e prodhuese, barazi sociale dhe mjedis të shëndoshë e atraktiv jetësor për klasën kreative, banorët dhe vizitorët.*

*Me aplikimin e vlerësimit përmes kritereve të teorisë së Ekonomisë së Njohurive dhe të Teorisë së Kapaciteteve Organizative të pozitës dhe potencialeve zhvillimore të qyteteve pjesëmarrëse të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës, synohet të arrihet deri tek identifikimi i politikave urbane dhe veprimeve konkrete në përmbushje të kritereve për një Prishtinë, qytet- regjion konkurent në vend dhe më gjërë, gjenerator dhe kurriz të zhvillimit ekonomik të Kosovës.*

*Ka për qëllim listimin e veprimeve për përmbushjen e kritereve në aspekt të planifikimit hapsinor dhe të formave të organizimit institucional, të cilat do të shërbenin si udhërrëfytes dhe listë kontrolluese për plotësimin e dokumenteve strategjike zhvillimore të qyteteve pjesëmarrëse në RUM të Prishtinës dhe të shtetit të Kosovës, sikurse dhe do të inkurajonin dhe udhëheqnin drejt një shkalle të Zhvillimit të bazuar në Njohuri, përmbushjes në ngritje të kualitetit të jetës, ruajtjes dhe kultivimit të identitetit urban, etj.*

## **MIRËNJOHJE**

*Shpreh mirënjohjeje dhe falënderimin për disa persona dhe institucione, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të ishte i mundur finalizimi i disertacionit.*

*Falenderoj fillimisht udhëheqësin tim të tezës së disertacionit, Prof. Asoc. Andrea Maliqarin nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe Prof. Asoc. Flamur Doli nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, për ndihmën, konsultimet dhe udhëzimet për zhvillimin dhe përfundimin me sukses të disertacionit;*

*Falenderoj familjen time për mbështetjen e vazhdueshme, ndërsa në veçanti do të doja të falenderoja të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët e mi për mbështetjen që më dhanë, përderisa In memoriam, i jam mirënjohëse babait tim, këshillat e të cilit më udhëhoqën, më dhanë motiv dhe forcë shtytëse të jap kontribut shkencor për zhvillim të vendit tim.*

## INDEKSI I SHKURTESAVE

AENj	Aktivitetet e Ekonomisë së Njohurive
AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e statistikave të Kosovës
B.I.	Bashkësi Lokale
BB	Banka botërore
BE	Bashkësia Europiane
BE	Bashkimi Evropjan
BK	Buxheti i Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
CECODHAS	European Federation of Public, Cooperative and Social Housing
CLLD	Community-Led Local Development
DG REGIO	Directorate-General for Regional and Urban Policy
DUNMM	Departamenti i Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
EBRD	Banka Evropjane për Zhvillim
EF	Ekonomi Familiare
EIB	European Investment Bank
EJL	Evropa Juglindore
ERDF	European Regional Development Fund
ESDP	Programi Evropjan për Zhvillim Hapsinor
ESF	European Social Fund
IAK	Instituti Arkeologjik i Kosovës
ICT	Teknologjia Informative dhe e komunikimit
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IMMK	Instituti për mbrojtjen e monumenteve të Kosovës
IMMPR	Instituti për mbrojtjen e monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës
IPH	Instituti për Planifikim Hapsinor
ITI	Integrated Territorial Investment
KE	Komisioni Evropjan
KEK	Korporata Energjetike e Kosoves
KK	Kuvendi komunal Prishtinës (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Podujevë)
KO	Kapacitetet organizative
LPH	Ligji për Planifikim Hapsinor
MASHT	Ministria e Arsimit, shkencës dhe teknologjisë
MBPZHR	Ministria e bujqësisë, pyltarisë dhe zhvillimit rural
MEF	Ministria e ekonomisë dhe financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe te mesme
PHK	Plani Hapsinor i Kosovës
PTK	Post telekomunikimi i Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
RUM	Regjioni urban Metropolitan
ThENj	Themelet e Ekonomisë së Njohurive
TKK	Trashëgimia Kulturore e Kosovës
UP	Universiteti i Prishtinës
ZHBNJ	Zhvillimi i bazuar në Njohuri
ZK	Zyra e Kryeministrit

## LISTA E FIGURAVE

Fig. 1. Figura e Hyjneshës në fron .....	19
Fig. 2 Prishtina në fillim të shek XX.....	20
Fig. 3 Pamje e bërthamës historike të Prishtinës në fillim të shek. XX .....	21
Fig. 4 Prishtina dhe komunat fqinje – shtrirja hapsinore .....	22
Fig. 5 Investimet publike ne mil. Euro.....	23
Fig. 6 Arësyet kryesore për migrim jashtë vendit .....	24
Fig. 7. Buxheti I Kosovës – shpërndarja sipas sektorëve .....	25
Fig. 8. Kronologjia e planifikimit urban të qytetit të Prishtinës .....	29
Fig. 9 Plani I Përgjithshëm I Prishtinës deri më 2000    Fig. 10 Plani strategjik i Prishtinës 2004-2020 .....	29
Fig. 11 Rritja urbane e Prishtinës.....	29
Fig.12. Dendësia mesatare e popullatës sipas rajoneve në Kosovë gjatë viteve .....	31
Fig.13. Dendësia banimore në Kosovë ban/km2    Fig.14. Harta e migrimit të brendshëm në Kosovë .....	31
Fig.15. Personat që udhëtojnë rregullisht në Prishtinë    Fig.16. Personat që udhëtojnë rregullisht në Prishtinë .....	32
Fig. 17 Plani Hapsinor I Kosovës 2010-2020+    Fig. 18 Qyteti I Prishtinës në kontekst të “Hapësirës së Kaltërt” .....	33
Fig. 19 Propozim zhvillimi I qytetit të Prishtinës si Regjion Urban Metropolitan .....	34
Fig. 20 Qyteti I Prishtinës në kontekst të komunës së Prishtinës .....	34
Fig. 21. Prishtina/Kosova në kontekst rajonal dhe Evropjan.....	36
Fig.22. Përqindja e popullatës urbane sipas qyteteve (2008) .....	38
Fig. 23. Skema e kontekstit të regjionit urban të Prishtinës .....	40
Fig. 24. Harta e Regjionit Urban të Ljubljanës .....	42
Fig. 25. Niveli i arsimit tek qytetet e mesme dhe të mëdha mes 50000 dhe 250000 banorë në shtete e BE-së, viti 2001 .....	46
Fig. 26 Qyteti i Gjenova’s në Itali dhe pjesët e saj të migrimit ditor. ....	47
Fig. 27. Themelet dhe aktivitetet e Ekonomisë së Njohurive (Van den Berg et al, 2004) .....	50
Fig. 28. Korniza teorike e Kapaciteteve organizative (Van den Berg 1997) .....	53
Fig. 29. Korniza analitike e studimit .....	59
Tab.30. Definicionet për qytetin monocentrik sipas autorëve të ndryshëm .....	61
Fig.31. Paraqitja e qytetit të Prishtinës, qendrës dhe distrikteve të saj .....	63
Fig.32. Modeli policentrik-verzioni urbano rural    Fig.33. Modeli policentrik-verzioni i lëvizjeve të rëndomta sipas Bertraud, 2001 .....	67
Fig.34. Paraqitja e Prishtinës me dy poliçendra sipas PZHK 2013 .....	67
Fig.35. Përmirësimi i qasjes në Prishtinë, sipas PZHK .....	69
Fig.36. Korniza e zhvillimit hapsinor të Prishtinës sipas PZHU .....	73
Fig.37 Ndarja zonale e hapsinore urbane e Prishtinës.....	74
Fig.38. Ndarja regionale e Kosovës sipas potencialeve dhe orientimeve zhvillimore .....	82
Fig.39 Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) - administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agroindustriale, turistike – Prishtina.....	83
Fig.40. Pozita e Lipjanit karshi Regjionit Urban të Prishtinës    Fig.41. Rritja e hapësirave sipas kategorive zhvillimore në qytetin e Lipjanit sipas PZHK .....	85
Fig.42. Pozita e zonave industriale dhe tregtare në raport me ANP    Fig.43 Modeli i zhvillimit hapsinor të Lipjanit .....	86
Fig.44. Paraqitja e zonës industriale dhe tregtare    Fig.45 Paraqitja e zonës së ANP .....	86
Fig.46. Skenarët zhvillimorë të Lipjanit.....	87
Fig. 47 Hapësira e kaltër sipas PHK    Fig. 48 Harta e rrjetit hekurudhor të Kosovës me epiqendër në Fushë Kosovë .....	91
Fig.49. Harta e komunikacionit në Fushë Kosovë    Fig.50. Zona e ndikimit të ANP .....	93
Fig.51. Shfrytëzimi I tokës në komunën e Fushë Kosovës.....	93
Fig.52. Pozita e Kastriotit në kontekst të Kosovës    Fig.53 Pozita e Kastriotit në fqinjësi me Prishtinën dhe Podujevën .....	97
Fig.54 Shfrytëzimi I tokës si destinim    Fig.55 Shfrytëzimi I tokës në përçindje .....	98
Fig.56 Modeli I zhvillimit hapsinor të Kastriotit .....	98
Fig.57. Rrjeti i komunikacionit në Kastriot.....	99
Fig.58. . Pozita gjeografike e Podujevës    Fig.59. Peisazh i Fushëgropës së Llapit .....	102
Fig.60. Destinimi I sipërfaqeve    Fig.61. Pjesëmarja e tokës së punueshme.....	103
Fig.62. Rrjeti i rrugëve    Fig.63. Qasja në transport publik .....	104
Fig.64 Liqeni i Batllaves .....	105
Fig. 65. Rezultatet nga krahasimi I skenarëve të zhvillimit monocentrik dhe policentrik .....	114
Fig. 66. Rezultatet nga krahasimi I skenarëve të zhvillimit monocentrik dhe policentrik .....	114

## LISTA E TABELAVE

<i>Tab. 1. Numri I banorëve në Prishtinë gjatë historisë .....</i>	<i>20</i>
<i>Tab. 2. Numri I vizitorëve ne vit sipas komunave .....</i>	<i>24</i>
<i>Tab. 3. Citat nga raporti I Institutit GAP, për njohjen e gjuhëve të huaja në Kosovë .....</i>	<i>26</i>
<i>Tab. 4. Numri I banorëve të Regjionit Urban të Prishtinës .....</i>	<i>30</i>
<i>Tab. 5. Numri I ekonomive familjare sipas rajoneve .....</i>	<i>30</i>
<i>Tab. 6. Orientimet zhvillimore për Prishtinën sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010- 2020+ .....</i>	<i>35</i>
<i>Tab. 7. Definimi i madhësisë së qyteteve sipas OECD .....</i>	<i>39</i>
<i>Tab. 8. Ndarja e Njohurive (Knight, 1994) .....</i>	<i>50</i>
<i>Tab. 11. Tabela e vlerësimeve të skenarit I – Zhvillimi monocentrik aktual i Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO.....</i>	<i>64</i>
<i>Tab. 12. Tabela e vlerësimeve të skenarit II – zhvillimit policentrik të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO.....</i>	<i>82</i>
<i>Tab. 13. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Lipjanit në Regjion Urban metropolinan të Prishtinës .....</i>	<i>90</i>
<i>Tab. 14. Sfidat e përbashkëta të FK dhe Prishtinës dhe ndarja e hapësirës sipas kategorive të shfrytëzimit.....</i>	<i>92</i>
<i>Tab. 15. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Fushë Kosovës në Regjion Urban metropolinan të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO.....</i>	<i>96</i>
<i>Tab. 16. Sfidat e përbashkëta të Kastriotit në kontekst regjioni të Prishtinës dhe ndarja e hapësirës sipas kategorive të shfrytëzimit .....</i>	<i>96</i>
<i>Tab. 17. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Kastriotit në Regjion Urban metropolinan të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO.....</i>	<i>102</i>
<i>Tab. 18. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Podujevës në Regjion Urban metropolinan të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO.....</i>	<i>111</i>
<i>Tab. 19. Tabela e rezultateve nga të tri skenarët .....</i>	<i>112</i>

**TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>2</b>
<b>INDEKSI I SHKURTESAVE</b> .....	<b>5</b>
<b>LISTA E FIGURAVE</b> .....	<b>6</b>
<b>LISTA E TABELAVE</b> .....	<b>7</b>
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
<b>HYRJE</b> .....	<b>14</b>
<b>KAPTINA I- KONTEKSTI/PRISHTINA SI REGJION URBAN</b> .....	<b>17</b>
<b>I.I. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË PRISHTINËS</b> .....	<b>18</b>
<b>I.I.I. PRISHTINA NË KONTEKST HISTORIK</b> .....	<b>19</b>
<b>I.I.II. PROFILI URBAN I PRISHTINËS</b> .....	<b>22</b>
<b>I.I.III. PROFILI EKONOMIK I PRISHTINËS</b> .....	<b>23</b>
<b>I.I.IV. ARSIMI, SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA</b> .....	<b>25</b>
<b>I. I.V. PROFILI I INFRASTRUKTURËS DHE RRJETIT TË TRANSPORTIT</b> .....	<b>26</b>
<b>I. I.VI. HISTORIKU I PLANIFIKIMIT HAPSINOR DHE URBAN PËR PRISHTINËN</b> .....	<b>28</b>
<b>I.II. ANALIZA E TRENDIT SIPAS STATISTIKAVE TË MIGRIMIT DITOR NË PRISHTINË</b> .....	<b>30</b>
<b>I.III. ANALIZA E PRISHTINËS NË KONTEKST TË PLANIT HAPSINOR TË KOSOVËS 2010 – 2025+</b> .....	<b>32</b>
<b>I.III.I. PRISHTINA NË KONTEKST REGJIONAL DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>36</b>
<b>I.IV. ANALIZA E QYTETIT TË PRISHTINËS DHE DEFINIMI I ZONËS FUNKSIONALE URBANE TË SAJ SIPAS</b> <b>OECD</b> <b>38</b>	
<b>KAPTINA II. PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE TË QYTETEVE – METROPOLITANE- REGJIONEVE URBANE METROPOLITANE DREJT ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI</b> .....	<b>40</b>
<b>II.I. BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL –RASTI I QYTETIT AACHEN, QYTETIT TË LJUBLJANËS</b> .....	<b>40</b>
<b>II.II. TRANZICIONI DREJT EKONOMISË SË NJOHURIVE TË QYTETEVE EVROPJANE</b> .....	<b>43</b>
<b>II.III. TRANZICIONI DREJT BASHKËPUNIMEVE REGJIONALE</b> .....	<b>44</b>
<b>II.IV. ROLI I QYTETEVE</b> .....	<b>45</b>
<b>II. V. QYTETI DHE ZONA E SAJ E GJËRË E MIGRIMIT DITOR</b> .....	<b>47</b>
<b>KAPTINA III. ANALIZA E TEORIVE PËR REGJIONE URBANE METROPOLITANE ME ZHVILLIM TË BAZUAR NË NJOHURI</b> .....	<b>48</b>



III.I. TEORIA E ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI - ROLI I QYTETIT SI DETERMINANT SUKSESI .....	48
ROLI I DIVERSITETIT DHE KULTURËS SË QYTETEVE – METROPOLITANE DREJT ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI .....	49
RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI PËR QYTETET METROPOLITANE IMPLIKIMET NË POLITIKA DHE PLANIFIKIM .....	49
III.II. TEORIA E KAPACITETEVE ORGANIZATIVE.....	53
III.III. ZHVILLIMI I QYTETEVE –REGJIONE DHE KOHEZIONI TERITORIAL .....	54
<b>KAPTINA IV. QËLLIMI, HIPOTEZAT DHE PYETJET E HULUMTIMIT.....</b>	<b>56</b>
IV.I. QËLLIMI I STUDIMIT .....	56
IV.II. HIPOTEZA DHE PYETJET E HULUMTIMIT.....	56
IV.III. QASJA DHE METODOLOGJIA .....	57
<b>KAPTINA V. VLERËSIM I SKENARËVE POTENCIAL TË ZHVILLIMEVE URBANE TË PRISHTINËS .....</b>	<b>60</b>
V.I. – SKENARI I. - PRISHTINA - ME ZHVILLIM URBAN MONOCENTRIK.....	60
V.II. – SKENARI II. PRISHTINA - ME ZHVILLIM URBAN POLICENTRIK.....	65
V.II.I. SKENARI II - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2013 - 2022.....	65
V.II.II. SKENARI II - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR URBAN 2013 - 2025 .....	73
V.III. SKENARI III. ZHVILLIMI SI REGJION URBAN METROPOLITAN I PRISHTINËS .....	82
V.III. I. – SKENARI III - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR TË LIPJANIT .....	84
V.III.II. SKENARI III – SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FUSHË KOSOVËS .....	91
V.III.III. SKENARI III. SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KASTRIOTIT.....	96
V.III.IV. SKENARI III – SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË PODUJEVËS .....	102
<b>KAPTINA VI. REZULTATET, KONKLuzionET, SUGJERIMET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>111</b>
VI.I. REZULTATET .....	112
VI.II. KONKLuzionET .....	115
VI.III. REKOMANDIMET, SUGJERIMET .....	116
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>120</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Është rast studimi për qytetin e Prishtinës drejt të qenit metropolitane - sipas parametrave të një qyteti me Zhvillim të Bazuar në Njohuri, zhvillim ky tanimë model për qytete të suksesshme të Evropës perëndimore, atraktive për klasën kreative, banorët dhe vizitorët, me zhvillim të lartë arsimor, social dhe ekonomik, me nivel të lartë të kualitetit të jetës, konkurente në regjion.

Është rast studimi për qytetin e Prishtinës, me të cilin është bërë vlerësimi dhe krahasimi i tre skenarëve zhvillimor urban sipas parametrave të Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri: i)Skenarit të zhvillimit monocentrik bazuar në Plane Urbanistike të para vitit '99; ii)Skenarit të zhvillimit policentrik bazuar në synime/objektiva zhvillimorë sipas dokumenteve strategjike të pas vitit '99 dhe iii)Skenarit të zhvillimit si regjion urban metropolitane së bashku me komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë), sipas trendeve aktuale evropjane dhe botërore në zhvillim të qyteteve.

Në kontekst të këtij studimi fillimisht janë shqyrtuar: Pozita dhe gjendja ekzistuese e Prishtinës dhe resurset kapitale infrastrukturore, trendi i zhvillimeve në Prishtinë sipas statistikave të fundit të migrimeve ditore, orientimet zhvillimore për Prishtinën, të dala nga Plani Hapsinor i Kosovës 2010 – 2020+ sikurse dhe trendi i zhvillimeve të regjioneve urbane, qyteteve me zonën e tyre të gjërë urbane, sipas OECD - definimit të qytetit të Prishtinës në një qytet me zonë më të gjërë urbane, zonë të influencës së punës ditore drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

**KONTEKSTI** - Qyteti i Prishtinës – do të analizohet për të ardhur deri tek hipotezat dhe pyetjet e hulumtimit lidhur me funksionim si regjion urban metropolitane, me analizën e:

*I)Gjendjes aktuale dhe trendit të zhvillimeve të para vitit '99, bazuar në Pozitën gjeografike të qytetit të Prishtinës; rolit historik dhe politik; Shtrirjes së resurseve kapitale infrastrukturore (Aeropotit Ndërkombëtar të Prishtinës, HK-Stacionit Qendror të Hekurudhave të Kosovës) në komunë dhe në zonë- komunat fqinje;*

*II)Pritjeve për zhvillim të saj urban e hapsinor si qytet global e konkurent sipas dokumentit strategjik hapsinor kombëtar të Kosovës – PHK 2010 – 2025+;*

*III) Trendeve aktuale të migrimit ditor të punëtorëve në qytet dhe rritjes së popullatës së Prishtinës gjatë ditës për 35%;*

*IV)Definimit të qytetit të Prishtinës – si Regjionit Urban me zonën përreth sipas OECD-nomenklaturës dhe trendeve aktuale në Evropë dhe botë, për bashkëpunime ndërkomunale.*

Nga shqyrtimi i qytetit të Prishtinës në kontekst të përshkruar si më lartë, na del se Prishtina për të funksionuar si metropolitane do të duhej të funksionojë si regjion urban me komunat e tjera, përderisa të gjitha indikacionet orientojnë në nevojën e të funksionuarit në bashkëpunim me komunat fqinje, për arsye se sipas kontekstit na del se:

- Sipas gjendjes aktuale, del se qyteti i Prishtinës për të qenë metropolitane duhet: të ketë ingerencë dhe mundësi për zhvillim të shpejtë, sinkron dhe në favor të saj, të resurseve kapitale infrastrukturore që gjenden jashtë komunës së saj, sikurse është zhvillimi i rrjetit hekurrudhor të shpejtë dhe atij të mallrave të Hekurrudhave të Kosovës; Zhvillimit të linjës së shpejtë për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, përmes transportit të lehtë publik hekurudhor porse dhe zhvillimin e zonës së gjërë të ANP në kuptim të alokimit të kompanive multinacionale rreth ANP dhe masave të tjera në dobi të konkruentshmërisë së qytetit të Prishtinës.
- Sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010 – 2020+ kemi orientimin zhvillimor për Prishtinën në kuadër të një regjioni më të gjërë urban me komunat fqinje, sipas të ashtuquajturës Hapësirë të kaltër – Portë të Kosovës, në dobi të zhvillimit ekonomik të vendit dhe krijimit të një porti për vendin;
- Sipas statistikave të fundit, kemi migrim ditor në Prishtinë për më shumë se 35% - nga komunat fqinje, përderisa kjo paraqet funksionim ditor të tërë regjionit si një;
- Sipas definicioneve të OECD Organizatës evropjane për bashkëpunim dhe zhvillim, në Komision Evropjan -Drejtoria për Zhvillim Regjional – na del se qyteti i Prishtinës sipas trendit të zhvillimit, do të duhej të konsiderohej si një regjion funksional urban me komunat fqinje, me të cilin organizim do të mund të jetë e krahasueshme statistikisht me regjione tjera urbane.

Nga këto konstatime, na dalin hipotezat dhe pyetjet e hulumtimit si në vijim:

### *I HIPOTEZA dhe PYETJET E HULUMTIMIT*

Bazuar në analizën e kontekstit të qytetit të Prishtinës – nga perspektiva e të qenit qytet -metropolitan me parametra të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, si nevojë të kohës dhe trendit të zhvillimeve urbane të qyteteve të suksesshme evropjane dhe më gjërë, do dalim tek konstatimet për hipoteza dhe pyetje të hulumtimit. Kjo për më shumë në detaje, bazohet në: i) Potenciale ekzistuese, resurse kryesore infrastrukturore jashtë komunës; ii) Potenciale të ardhshme, të projektuara e të planifikuara të qytetit të Prishtinës; iii) Trendeve aktuale lokale të migrimit ditor

të popullatës nga regjioni i Prishtinës sipas statistikave të fundit të vitit 2011 dhe së fundmi iv)Trendit evropjan sipas nomenklaturës zyrtare të Eurostat për definim të Regjioneve Urbane Metropolitane. Hipotezat dhe pyetjet e hulumtimit janë si vijojnë:

1. *Qyteti i Prishtinës nuk është dhe nuk do të mund të jetë metropolitane - drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, pa bashkëpunim të ngushtë urbano – rural brenda komunë së saj porse dhe me komunat fqinje përreth. Kjo bazuar në pozitën dhe potencialet e saj ekzistuese, trendin e migrimit ditor të punës nga regjion dhe trendit të zhvillimit urban në botë. Zhvillimi i saj fizik aktual monocentrik me primesa të zhvillimeve korridorale përgjatë rrugëve kryesore nacionale, me mospërfshirjen e gjërë të fshatrave të komunës në zhvillim të tërësishëm urban, porse dhe të komunave fqinje nuk është i favorshëm për zhvillim kompakt metropolitane drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.*

***Pyetja 1 - A do të mund qyteti i Prishtinës me trendin e saj zhvillimor aktual, pa përfshirjen dhe bashkëpunim e ngushtë të fshatrave dhe komunave përreth të përmbushë kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri?***

2. *Qyteti i Prishtinës në rast organizimi dhe funksionimi si Regjion Urban Metropolitan, mund të përmbushë kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Zhvillimi i saj si regjion urban në bashkëpunim me komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Podujevë), do sjell sinergji reciproke, regjionit dhe qytetit të Prishtinës, regjionit më të gjërë, duke e bërë regjionin dhe jo vetëm Prishtinën, konkurente në aspekt global, rekomandim ky sipas dokumentit strategjik të Planifikimit hapsinor kombëtar të Kosovës dhe OECD – Organizatës Evropjane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, për definim regjionesh urbane.*

***Pyetja 2 - A do të mund qyteti i Prishtinës – si Regjion Urban Metropolitan sipas pritjeve zhvillimore për të, Planifikimit Hapsinor Kombëtar të Kosovës dhe sipas nomenklaturës së OECD të përmbush kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri? Cilat do të mund të ishin format dhe potencialet e bashkëpunimit regjional, lokal dhe ndërkufitar (qëllimi i të cilave është promovimi i zhvillimit të bazuar në njohuri)?***

***METODOLOGJIA*** - Studimi është kualitativ dhe përshkrues, i bazuar në të dhëna kualitative parësore dhe dytësore. Teoritë sipas parametrave të të cilëve do të bëhet skanimi i tre skenarëve zhvillimorë të Prishtinës janë: Teoria e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Teoria e Kapaciteteve Organizative. Analizat e tre skenarëve zhvillimorë për Prishtinën, do të rezultojnë në përshkrime kualitative dhe të kuantifikuar e të krahasuar, rezultate këto të cilat në formën e tyre tabelare - formë kuantitative, do të na udhëzojnë drejt formimit të konkluzioneve, rekomandimeve dhe sugjerimeve për këtë studim.

Tre skenarët zhvillimorë urbanë të qytetit të Prishtinës, do të vlerësohen sipas parametrave të teorive të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative, të paraqitur në formë tabelare ku paraqiten si vlera kuantitative porse dhe të plotësuar me përshkrime të dukurive, paraqitje këto të përqindjes së përmbushjes së kriterëve në fjalë.

Këto mëpastaj do shërbejnë për të formuluar konkluzionet, rekomandimet dhe sygjerimet në kontekst të vecantë dhe të përgjithshëm zhvillimor.

*ANALIZA E SKENARËVE ZHVILLIMOR URBAN*— Pas konstatimit të hipotezës dhe pyetjeve të hulumtimit për këtë studim, kaptina e ardhshme do të merret me analizën e tre skenarëve zhvillimorë urban të Prishtinës: *Skenarit I* – Skenarit të zhvillimit monocentrik të Prishtinës, sipas trendit aktual të zhvillimit të para vitit '99 bazuar në Planin Gjeneral Urbanistik deri në vitin 2000; *Skenarit II* – skenarit të zhvillimit urban policentrik, trendit të zhvillimit të pas vitit '99 - deri në aprovimin e Planeve zhvillimore komunale dhe urbane për periudhën 2013 – 2025, të aprovuara në vitin 2013 nga asambleja komunale e Prishtinës dhe *Skenarit III* - Skenarit të regjionit urban të Prishtinës me komunat fqinje, bazuar në planet zhvillimore komunale të të pesë komunave (përfshi dhe Prishtinën).

## HYRJE

---

*Me këtë studim trajtojmë problematikën e qytetit të Prishtinës, zhvillimit urban të saj duke tentuar të jetë metropolitane, qytet amë, qytet I rëndësisë parësore ekonomike për vend, qytet duke tentuar aritje të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.*

*Ky synim për qytetin e Prishtinës bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm urban, kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, njëres ndër forcave kryesore për ristrukturim të qyteteve të shekullit XXI. Këto parime, dhe përmbushje kriteresh për një zhvillim urban të bazuar në njohuri, ndihmon për të mbajtur, kultivuar apo dhe rindërtuar identitetin urban, duke qenë konkurent përmes formave të reja të funksionimit për më shumë si qytet – regjion – metropolë, për shkak të kriterit për t'u përmbushur, për të qenë I madh – territoialisht porse dhe me numër të banorëve që jetojnë dhe punojnë në të, përderisa në mesin e shumë parametrave të tjerë shumë me rëndësi është dhe kriteri i qasshmërisë, i domosdoshëm për një qytet metropolitane apo dhe regjion për më shumë.*

*Qytetet e mëdha, zhvillimin e qëndrueshëm të tyre u atribuojnë bashkëpunimeve të shumta brenda përbrenda komunës, raporteve urbano – rurale, lidhjeve zhvillimore sinergjike të tyre, bashkëpunimeve ndërkomunale, ndërkufitare dhe ndërkombëtare.*

*Me këtë studim vlerësojmë Prishtinën –si qytet dhe regjion urban metropolitane së bashku me komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë), me vlerësimin e pozitës, trendit të zhvillimeve, pritjeve, nomenklaturës ndërkombëtare të definimit të regjionit urban, dokumenteve strategjike për zhvillimin e saj drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.*

*Qyteti i Prishtinës – duke qenë qytet në tranzicion, has në sfida të shumta drejt rrugëtimit për Zhvillim të Bazuar në Njohuri – zhvillim ky urban i qëndrueshëm në shek. XXI.*

*Faktet e favorshme - Pozita e saj qendrore në Kosovë- si kryeqytet, pozitë gjeografike qendrore në rajon e Ballkanit perëndimor, rol të rëndësishëm ekonomik dhe politik gjatë historisë në rajon; rol ekonomik si qendër e “Portës së Kosovës”<sup>1</sup>, popullatë e re studentore në shumicë, qytet atraktiv e dinamik, qytet diplomatik dhe funksione tjera të cilat e bëjnë Prishtinën, e bëjnë Prishtinën të jetë e vëmendshme për zhvillimet e saj të ardhshme urbane e hapsinore.*

*Faktet e disfavorshme – Resurset kapitale infrastrukurore jashtë komunës, si Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës i cili gjendet në Lipjan dhe Stacioni Qendror Hekurudhor i Kosovës*

---

<sup>1</sup> Plani Hapsinor i Kosovës 2010 – 2020+, Prishtina në qendër të Hapsirës së kaltër – Portës së Kosovës

*në Fushë Kosovë, vështirësojnë ndonëse pamundësojnë në aspekt ingerencash pjesëmarrjen në vendimmarrje direkte të Prishtinës, për harmonizim zhvillimesh rreth këtyre resurseve gjigante infrastrukturore, duke marrë parasysh se Qasshmëria është ndër kriteret kryesore në dobi të zhvillimit të Prishtinës drejt Zhvillimit të bazuar në Njohuri.*

*Qyteti i Prishtinës deri para vitit '99, zhvillohej në aspekt urban dhe hapsinor bazuar në plane urbanistike, të cilat parashikonin zhvillim monocentrik. Ky lloj zhvillimi monocentrik, parashihej dhe me planin e fundit urbanistik të para '99: "Planin Gjeneral Urbanistik të parashikuar deri në vitin 2000", me të cilën parashikohej të zhvillohej në mënyrë monocentrike rreth qendrës së Vjetër të Prishtinës, zhvillim ky i cili vazhdoi deri në aprovim të Planit Strategjik Zhvillimor për periudhën 2004-2020+.*

*Me Planin Strategjik Zhvillimor për periudhën 2004-2020+.qyteti i Prishtinës tentoi të udhëhiqte zhvillimet urbane në baza ditore, porse hasi në shumë probleme administrative.*

*Meqë dokumenti i Planit Strategjik Zhvillimor për periudhën 2004 – 2020, si tillë nuk përkonte plotësisht me Ligjin për Planifikim Hapsinor të vitit 2003, nëse ishte zhvillimor komunal apo urban, kjo kishte për pasojë zhvillimet hapsinore të cilat ndiqnin Planin Strategjik të Prishtinës për një zhvillim policentrik porse kjo nuk ndiqej nga ana e investimeve kapitale publike, pra punohej për një Prishtinë monocentrike nga ana infrastrukturore, duke e përmendur Prishtinën e Re vetëm si nocion dhe jo si një realitet tanimë.*

*Prishtina si qendër policentrike, filloi të bëhet realitet prej vitit 2013, kur dhe u aprovuan dy dokumentet zhvillimore komunale dhe urbane - me zhvillim policentrik, dokumente tanimë sipas Ligjit të RI për Planifikim Hapsinor të aprovuar në vitin 2013.*

*Prishtina si regjion urban metropolitan është parashikuar dhe orientuar të jetë i tillë sipas dokumentit strategjik hapsinor kombëtar të Kosovës PHK 2010 – 2025+, priturjeve dhe orientimeve zhvillimore për të ardhmen e saj, duke marrë parasysh dhe faktin sipas statistikave me të reja të trendit të migrimit ditor të punëtorëve në qytet, dhe faktit se numri i rritjes së popullatës së Prishtinës gjatë ditës është 35%.*

*Sipas nomenklaturës së OECD për definim regjionesh urbane, dhe trendeve aktuale në Evropë dhe botë të bashkëpunimeve të shumta ndërkomunale, do të duhej që Prishtina të definohej si Regjion Urban Metropolitan.*

*Qyteti i Prishtinës në rast të definimit, organizimit dhe funksionimit të saj si regjion urban metropolitan, do të jetë i krahasueshëm në aspekt ndërkombëtar ndërmjet regjioneve urbane në botë, i hapur dhe me mundësi zhvillimore të mëtutjeshme sipas mbështetjes së organizmave*





*kornizës teorike, indikatorë sipas të cilëve do të vlerësohen skenarët e zhvillimeve urbane të Prishtinës.*

*Kaptina e katërt – Trajton përfundimet e kontekstit për definim të Hipotezës-ave, pyetjeve të hulumtimit dhe qëllimit të gjithëmbarsuem të studimit.*

*Kaptina e pestë – Do të bëjë vlerësimin e skenarëve zhvillimorë të qytetit të Prishtinës: a)Skenarit të zhvillimit monocentrik –sipas trendeve aktuale zhvillimore në qytet; b)Skenarit – të zhvillimit policentrik të planifikuar sipas planeve zhvillimore të Prishtinës, Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban në kontekst të përmbushjes së kriterëve të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe c)Skenarit të zhvillimit të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës me komuna fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë).*

*Kaptina e gjashtë – Do të meret me elaborimin e rezultateve, konkluzioneve nga analizat e tri skenarëve zhvillimor të qytetit të Prishtinës drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, rekomandimeve dhe sugjerimeve.*

## **KAPTINA I- KONTEKSTI/PRISHTINA SI REGJION URBAN**

---

*Në këtë kaptinë analizohet problematika e qytetit të Prishtinës- në kontekst të pozitës së saj gjeostrategjike, ekonomike e politike, shtrirjes së resurseve infrastrukturore, trendeve të migrimit ditor për punë në qytet të Prishtinës, pritjeve për zhvillim urban të dala nga dokumenti strategjik kombëtar i Kosovës, si regjion urban metropolitan sikurse dhe sipas OECD - nomenklaturës evropjane për definim regjionesh urbane. Kjo kaptinë do t'i ketë katër nëngrupe ku do të analizohen:*

*I)Pozita gjeografike e qytetit të Prishtinës; roli historik, politik e ekonomik; profili urban, profili ekonomik, historiku i zhvillimit urban, profili i shtrirjes dhe zhvillimit të resurseve kapitale infrastrukturore (Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, HK-Stacionit Qendror të Hekurudhave të Kosovës) në komunë dhe në zonë më të gjërë urbane- komunat fqinje;*

*II) Trendet aktuale sipas statistikave të dala të vitit 2013 për migrimin ditor të punëtorëve në qytetin e Prishtinës nga regjioni i ngushtë, rritjes së popullatës së Prishtinës gjatë ditës;*

*III)Pritjet për zhvillim të saj urban e hapsinor si qytet global e konkurent sipas dokumentit strategjik hapsinor kombëtar të Kosovës – PHK 2010 – 2025+;*

*IV)Definimit sipas OECD të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës, nomenklaturës dhe trendeve aktuale në Evropë dhe botë të qyteteve – regjione urbane.*

*Këto analiza të nëngrupeve për një kontekst të Prishtinës drejt një hipoteze – problematikë të studimit, do të rezultojnë me konstatime të përcjellura me paraqitje skematike dhe arësytetime për hipoteza dhe pyetje të hulumtimit.*

*Hipotezat e dala nga një shtjellim konteksti të Prishtinës si qytet me nevoja të shumta sipas trendve, pritjeve, nevojave zhvillimore, së bashku me pyetjet e hulumtimit, përmes metodologjisë në këtë studim, do të vërtetohen dhe do të përgjigjen e arësytohen në kaptinën e analizave – vlerësime të skenarëve zhvillimorë urban të Prishtinës.*

*Koncepti I ri për të cilin ka nevojë qyteti I Prishtinës është- koncepti për funksionim dhe bashkëpunim me komunat fqinje si regjion urban metropolitan I Prishtinës, drejt zhvillimit të bazuar në njohuri.*

## I.I. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË PRISHTINËS

**P**rishtina si kryeqytet i Kosovës sot, përballet me tranzicione të shumta zhvillimore që nga viti 1999. Këto tranzicione nuk i atribuohen vetëm Prishtinës, porse të cilat transformime më së shumti reflektohen në sfidat zhvillimore me të cilat përballet ajo në përditshmëri, pritjeve të shumta nga ajo. Transformimet e sotme, kanë të bëjnë me transformime të shumta politike, sociale dhe ekonomike, sfidave zhvillimore të natyrave të ndryshme krahas ristrukturimit politik dhe të qeverisjes, shkallës së hershme të demokracisë, joefikasitetit apo menaxhimit të varfër të qeverisë lokale, tentimeve për rimëkëmbje ekonomike lokale, krahas shkatërrimit të industrisë, zgjatjeve në proces të privatizimit, papunësisë së lartë, avansimeve graduale të arsimit dhe ngritjeve profesionale, mungesës së koncepteve të reja në planifikim dhe zhvillimit urban sikurse dhe shumë të tjerave të cilat e bëjnë shumë më të vështirë zhvillimin urban të qëndrueshëm, të bazuar në njohuri.

Prishtina sot si kryeqytet i Kosovës, mban gjithë barrën e zhvillimit ekonomik të vendit, gjithë barrën e të qenit kryeqytet i një shteti të posaçëformuar, barrën e përfaqësimit të denjë diplomatik e politik, regjional e ndërkombëtar. Qenësorja e cila nuk duhet harruar është se qytetet duhet të jenë dhe mbeten, avansojnë në kuptim të ngritjes së kualitetit të jetës, të jetueshëm, ofrueshëm, atraktiv, të cilësisë për banorin e saj, vizitorin e shumë në të.

Sot, zhvillimi urban i Prishtinës, parapërcaktohet fillimisht nga Plani Hapësinor I Kosovës 2010-2020+ porse dhe nga planet zhvillimore për të: Planit Zhvillimor Komunal dhe urban, tanimë të

aprovuara në vitin 2013, të bazuara në parime Evropjane për qytetet e qëndrueshme, zhvillim hapësinor të qëndrueshëm.

### I.I.I. PRISHTINA NË KONTEKST HISTORIK

Gjurmët e banimit në rajonin më të gjerë të Prishtinës mund të përcillen që nga vendbanimet parahistorike për të cilat dëshmojnë shumë lokalitete arkeologjike. Vendbanimi autokton, është 7 km larg Prishtinës së sotme, e cila në kohën e sundimit të perandorit romak Trajan (98-117 p.e.r.), ngritet në rangun e municipiumit dhe merr emrin Ulpiana për nder të tij.



*Fig. 1. Figura e Hyjneshtës në fron*

Prishtina, si vendbanim përmendet për herë të parë në shek. XIII. Merita të veçanta për zhvillimin e tregtisë në periudhën XIV e XV e kanë dubrovnikasit, të cilët në Prishtinë e formuan edhe koloninë e parë, më të madhen prej katër kolonive që kishin në atë kohë në Ballkan. Në këtë kohë, Prishtina ishte qendër e fuqishme tregtare dhe financiare, e cila tërhoqte tregtarët nga Gjenova, Verona, Mantova dhe Firenca.

Në kohën e Perandorisë Romake, Prishtina ishte një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme që lidhnin Evropën Qendrore me Ballkanin jugor, jug lindor dhe jug perëndimor.

Ashtu si qendra të tjera urbane të Perandorisë Romake, Prishtina kishte një infrastrukturë urbane, sistem të ujësjellësit, kanalizimit, infrastrukturë rrugore, sheshe, monumente, teatër, basilika, etj.

Gjatë sundimit të perandorisë Otomane<sup>5</sup>, thuhet se “Qyteti I Prishtinës kishte 2060 shtëpi të ndërtuara me material të fortë dhe të mbuluara me qeramikë, shtëpi të mëdha me oborre, vreshta dhe dru frutor”.

Prishtina shënon një rritje domethënëse në shekullin e XIX kur kishte 12,000 banorë dhe krahasohej me banorët e tjerë në rajon. Zhvillimet vazhduan edhe në gjysmën e dytë të shekullit XIX, pavarësisht nga zjarret apo lufta kundër perandorisë Otomane (1877-78).

Fundi i shekullit XIX shënoi një zhvillim të veçantë ku erdhi influenca e kulturës Evropiane, kryesisht nga Italia dhe Austria. Hekurudha, shtypshkronja, dhe aktivitete të tjera sociale e

<sup>5</sup> Evlia Çelebiu, 1660

ekonomike e bënë Prishtinën një qytet të rëndësishëm në Kosovë dhe rajon, edhe në fillim të shekullit XX.

Ndryshimet politike dhe administrative pas Luftës së Dytë Botërore krijuan një bazë solide për zhvillimet sociale e ekonomike që u reflektua në përkufizimin urban të Prishtinës. Zhvillimet e viteve të 50-ta e 60-ta u bazuan në paradigmen e rritjes së diferencës rurale-urbane, që shkaktoi migrim domethënës të popullsisë nga zonat rurale dhe qytetet e tjera të Kosovës në Prishtinë. Ky proces pothuajse kurrë nuk ndaloi, duke u intensifikuar pas luftës së viteve 1998-99.

- Më 1486/87 Prishtina kishte 392 shtëpi në 10 lagje, me "nahinë" prej 51 fshatrave;
- Më 1569/70 Prishtina kishte 629 shtëpi në 29 lagje;
- Më 1660 Prishtina kishte 2060 shtëpi;
- Më 1685 kishte 3000 shtëpi;
- Më 1689 - 4000 shtëpi;
- Më 1811, Prishtina kishte 12000 banorë;
- Më 1991, Prishtina vlerësohet me 150.000 banorë;
- Më 1999, Prishtina vlerësohet me 338.000 banorë;
- Më 2000, sipas OSCE komuna e Prishtinës vlerësohet me 545,477 banorë;
- Më 2003, Prishtina vlerësohet me 315.000 – 420.000 banorë;
- Më 2011, Prishtina sipas regjistrimit zyrtar ka 198 897 banorë si komunë, ndërsa 149.250 banorë si qytet

*Tab. 1. Numri I banorëve në Prishtinë gjatë historisë*

Zhvillimi ekonomik, industria bazike dhe ajo përpunuese (energji elektrike, gërmimet, industria e tekstilit, përpunimi i ushqimit, etj.) dhe zhvillimet e përgjithshme socio-ekonomike e pozicionuan Prishtinën mes qendrave më të rëndësishme në Kosovë dhe pothuajse në çdo aspekt duke e kthyer atë në një vend tërheqës dhe dinamik për të jetuar e punuar, jo vetëm për kosovarët por edhe për njerëzit e tjerë në rajon.

Nëpër qytetin e Prishtinës kanë kaluar rrugë të rëndësishme që vinin nga Bosna, rruga Naissus-




Lissus, nga Scupi etj. Prishtina përmendet nga kontaktet e para raguziane në fund të viteve të shtatëdhjeta të shekullit XIII, përdërisa gjatë mesjetës u bë seli e rëndësishme.

*Fig. 2 Prishtina në fillim të shek XX*

Para betejës së Kosovës ishte kryeqytet i provincës, ndërsa në vitin 1426 Prishtina kishte dhe konsullatën dubrovnikase. Në shekujt XIV dhe XV, vepronin një numër i madh i tregtarëve dubrovnikas, të cilët bënë tregti me qytetet më të zhvilluara në rajon.

Prishtina<sup>6</sup> ishte një ndër qytetet kryesore të Kosovës, qendër administrative e xehtarisë së krahinës së Artanës (Novobërdës).

Në vitin 1689 e dobësuar nga lufta Austro-turke, ishte qendër e shtabit të gjeneralit austriak Pikolominit, përderisa që më 1812, Prishtina kishte dy panaire, të vjeshtës dhe të pranverës, ku



merrnin pjesë shumë tregtarë nga lindja dhe perëndimi.

Që në vitin 1892, periudhë e reformave të perandorisë otomane, komisioni i ri i reformave përbëhej nga persona të njohur dhe të respektuar me përkatësi shqiptare, siq ishte dhe Danish Beu i cili më vonë u bë dhe ministër i punëve të brendshme të Perandorisë.

**Fig. 3** Pamje e bërthamës historike të Prishtinës në fillim të shek. XX

Prishtina u bë qendër administrative e Krahinës Autonome të Kosovës, pjesë e Federatës së Jugosllavisë në vitin 1947. Në Prishtinë, pas Luftës së Dytë Botërore, filloi të ndërtohet infrastruktura institucionale dhe urbane, me moton e ndërtimit të një qyteti me pamje urbane.

Me planin urban të qytetit të vitit 1953, u rrënuan lagje të tëra së bashku me çarshinë e vjetër, duke e shkatërruar arkitekturën popullore shqiptare të periudhës turke. Prishtina, pas Luftës së Dytë Botërore, e fitoi funksionin e qytetit të rëndësishëm ekonomik dhe administrativo-politik, që i krijuan bazë materiale solide. Madhësia e qytetit matej me shkallën e inkuadrimit, numrin e kuadrove, specialistëve, shkencëtarëve, politikanëve dhe profesioneve të lira intelektuale.

Pas vitit 1999 zhvillimet në qytetin e Prishtinës ndikuan në mënyrë qenësore në strukturën urbane. Mbi 70% e strukturës urbane u transformua, si pasojë e mungesës së fuqizimit të ligjeve dhe të standardeve të nevojshme të planifikimit dhe ndërtimit.<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Shtjefën Gaspërit 1671

<sup>7</sup> PZHUP 2013-2025

### I.I.II. PROFILI URBAN I PRISHTINËS

Qyteti i Prishtinës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 523 km<sup>2</sup>. Prishtina ka shtrirje gjeografike prej gjërësisë 42°40'00'' dhe gjatësisë prej 21°20'15'', me pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik.

Prishtina sipas regjistrimit të fundit të vitit 2011, ka 149 000<sup>8</sup> banorë në zonën urbane përderisa 205000 në tërësi si komunë. Është qyteti më i populluar në Kosovë, me dendësi banimore prej 284 banorë/km<sup>2</sup>, qytet ku gërshetohen aktivitete dhe funksione të ndryshme si ato qeveritare, diplomatike e konsulare, të arsimit të lartë, institucioneve kulturore, shkencore e shëndetësore.

Komuna e Prishtinës rrethohet me komuna tjera: me Podujevën në veri, me Kastriotin në perëndim, Fushë Kosovën në pjesën jug-perëndimore, Graçanicën dhe Lipjanin në jug, Në pjesën veri-lindore Komuna e Prishtinës kufizohet me Republikën e Serbisë në një gjatësi kufiri prej rreth 12km.

Relievin e Prishtinës e përbëjnë terrenet e ngritura me lartësi mbidetare prej 535-730m. Qyteti rrethohet prej shpatijeve në të trija anët, duke krijuar një situatë topografike amfiteatrale. Në veri dhe në lindje, pylli i Gërmisë arrin lartësinë prej 1100 m. Në perëndim, Prishtina kufizohet me shpatijet e Arbërisë (ish-Dragodanit), në veri me kodrën e Pozderkës, në lindje me pyllin e Gërmisë duke vazhduar më tej me vargun e bjeshkës së Butovcit (malet e Prugovcit dhe Grashticës), dhe në jug e juglindje me vargun e maleve të Veternikut dhe me vendbanimin e Matit.




Fig. 4 Prishtina dhe komunat fqinje – shtrirja hapësinore

<sup>8</sup> Agjensioni i statistikave të Kosovës 2012

- Në Veri qyteti kufizohet me zonat kadastrale Bërnice e epërme, Bernice e poshtme dhe Llukar;
- Në Lindje qyteti kufizohet me z. kadastrale Makoc, Mramor, Novosellë;
- Në Jug qyteti kufizohet me z. kadastrale Graçanicë;
- Në Perëndim qyteti kufizohet me z. kadastrale të Fushë Kosovës dhe Shkabajve.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur dhe paraqitur përprësitë dhe dobësitë, bazuar në pozitën e qytetit të Prishtinës karshi zhvillimeve të qëndrueshme urbane bazuar në njohuri.

### I.I.III. PROFILI EKONOMIK I PRISHTINËS

Përveç se një qendër administrative e Kosovës, Prishtina mbetet qendra e biznesit më e fuqishme e Kosovës, me 24.6% të bizneseve të regjistruara. Në 2011, komuna e Prishtinës kishte rreth 28.000 biznese të regjistruara, që tregon një shpirt domethënës të ndërmarrësisë.

Si rezultat i vonesës gjatë tranzicionit, edhe Prishtina është përballur me fenomenin e de-industrializimit. Në periudhën e pas luftës, si rezultat i vonesës në privatizimin e këtyre kompanive shoqërore, shumica e tyre pësuan humbje të tregjeve dhe zvogëlim të punësimit ose bankrotim total. Aktualisht, tek bizneset e regjistruara ka një pjesëmarrje të vogël të kompanive nga sektori i industrisë së prodhimit (9.1% deri në 7.1%). Pjesëmarrja e bujqësisë është 1.2%, gjë që është e ulët duke pasur parasysh pyjet dhe potencialin rural dhe të tokës që ka komuna.

Kemi rreth 7% punë kërkuar në Prishtinë (përqindje e ngjajshme me atë të nivelit Kosovar), përderisa 60% të papunëve janë të moshës 25-39 vjeçar. Niveli i varfërisë në Prishtinë është

21.8% me varfëri ekstreme 9% (përqindje e ngjajshme me atë të nivelit të Kosovës).

Tregëtia me

shumicë dhe pakicë zë pjesë me 53%, transporti dhe magazina 17%, Hotele dhe restorante 9%.

Vit	Kosova	Komuna e Prishtinës	% e Prishtinës
2008		17.4	
2009	400	20.8	5.0
2010	455	28.9	6.4
2011	572	31.2	5.4
2012	587	29.9	5.1
2013	605	35.0	5.8

*Fig. 5 Investimet publike ne mil. Euro*

Në periudhën 2008 – 2012, të hyrat buxhetore të komunës së Prishtinës kanë treguar tendencë të rritjes së vazhduar për 61.7 %. Një tendencë e kësaj pjesëmarrje do të ruhet kryesisht edhe në periudhën e ardhshme.

Të hyrat buxhetore për qytetin e Prishtinës 61.7 % janë grant qeveritar përderisa të hyrat vetanake janë 1/3 e të hyrave totale. Buxheti ka rritje prej 3.8 % (2009) në 4.6 % (2011) në të hyrat buxhetore në nivel të vendit, rritje kjo e pjesëmarrjes që tregon për fuqinë biznesore, investuese dhe konsumuese të komunës së Prishtinës në raport me vendin.




Fig. 6 Arësyt kryesore për migrim jashtë vendit 9

Në Prishtinë janë të regjistruara gjithsej 24.458 biznese: 10.249- Sektor të tregtisë dhe të shërbimeve; 2.653- Menaxhim të patundshmërive, qiradhënie dhe aktivitete biznesore; 2.815 - Transport, depo dhe telekomunikacion; 2.496 - Hotele dhe restorante; 1.743 - Industri përpunuese;.

Nga tabela e mëposhtme shihet se numri i vizitorëve në Prishtinë dhe Lipjan është më i madh në krahasim me tri komunat tjera. Lipjani ka 1/3 e vizitorëve të Prishtinës, përderisa supozohet se kjo do të duhej të jetë për shkak të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Viti	2008	2009	2010	2011
Fushë Kosovë	2,318	1,800	2770	Fushë Kosovë
Lipjan	13,534	10,024	11188	Lipjan
Obiliq	1,271	1,374	327	Obiliq
Podujevë	-	-	-	Podujevë
Prishtinë	40,168	35,671	32245	Prishtinë
<b>GJITHSEJ</b>	<b>88,949</b>	<b>79,045</b>	<b>72393</b>	<b>TOTAL</b>


Tab. 2 Numri I vizitorëve ne vit sipas komunave

<sup>9</sup> Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë 2012-



Në figurën e mëposhtme shihet ndarja e buxhetit të Kosovës për vitin 2013, sipas sektorëve.<sup>10</sup>, prej nga shihet se investimet më të mëdha shkojnë në rrugë, e cila pason me të tjera, arsim dhe shkencë, shërbime sociale, rend dhe siguri, shëndetësi e të tjera.

Prishtina, është qendër e ofrimit të shërbimeve për hapjen e ndërmarjeve të reja (Agjencia për standardizim e Kosovës) e cila funksionon që nga viti 2005 në kuadër të Ministrisë së infrastrukturës dhe tregtisë..



Poashtu Agjencia Kosovare për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndodhet në Prishtinë. Është e krijuar nga sektori privat në Kosovë me qëllim të mbështetjes dhe zhvillimit të bizneseve të forta me aftësi të larta konkurruese, në tregun e brendshëm dhe në atë rajonal.

Fig. 7. Buxheti I Kosovës – shpërndarja sipas sektorëve

Me përbërjen e saj me divizione për analiza, strategji dhe politika të sektorit privat - si strukturë politik-bërëse dhe përkrahje të ndërmarrjeve dhe zhvillimit regional – ofron ombrellë për programe dhe projekte të ndryshme.

Me këtë kontribuohet në krijimin e njohurive dhe rrjetëzimeve të reja, për ndërmarrësi të suksesshme, bazë ekonomike për Zhvillim të Bazuar në Njohuri.

#### I.I.IV. ARSIMI, SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA

Prishtina ka një rrjet të zhvilluar të institucioneve arsimore, parashkollore, të arsimit të ulët dhe të mesëm, përderisa ka një koncentrim të madh të Universiteteve private karshi atij të vetmit publik, Universitetit të Prishtinës.

Në Komunën e Prishtinës jetojnë më shumë se 30,000 banorë të komunave të tjera që punojnë në institucione publike, ku shumica e tyre banojnë në Prishtinë së paku gjatë ditëve të punës dhe si rezultat krijojnë ngarkesë në shërbimet publike të Prishtinës. Fëmijët e tyre ndjekin shkollat e Prishtinës. Gjithashtu, qendrat e mjekësisë familjare ofrojnë shërbimet primare shëndetësore.

<sup>10</sup> Instituti GAP, Buxheti i Kosovës - transparenca dhe format e raportimit buxhetor, 2013

Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme- Në Prishtinë ekzistojnë 8 inst. publike parashkollore, 1 publiko-private përderisa 40 janë institucione parashkollore private të pa licensuara. Në Prishtinë ekzistojnë 43 shkolla amë fillore dhe 18 paralele të ndara fizike, pra gjithsej 61 objekte shkollore fillore. Shkolla të mesme të larta dhe gjimnaze janë gjithsej 12 me hapësirë të ndërtesave prej 42.679 m<sup>2</sup> dhe hapësirë të përgjithshme të oborrit prej 45.560 m<sup>2</sup>. Numri i nxënësve të shkollave të mesme është 15.217.

Shkollat në Prishtinë pranojnë edhe një numër të madh të nxënësve nga komunat e tjera për shkak të mungesës së profileve të ndryshme në shkollat e komunave të tyre. Megjithatë, shkollat në qytet përballen me ngarkesa më të mëdha të nxënësve se sa në zonat rurale dhe për këtë mësimi organizohet në dy ndërrime, përderisa vetëm në një shkollë fillore punon ende në ndërrimin e tretë.

*Njohja e gjuhëve të huaja është mjaft e përhapur te popullsia në Kosovë: në përgjithësi 44.25% mund të flasin të paktën një gjuhë tjetër nga ajo që e flasin në shtëpi.*

*Ka shumë më tepër poliglotë në radhët e meshkujve pasi që ata janë shkolluar më shumë dhe kanë qenë më mobil në aspektin gjeografik.*

**Tab. 3. Citat nga raporti I Institutit GAP, për njohjen e gjuhëve të huaja në Kosovë**

Komuna e Prishtinës ka bërë përpjekje që rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të organizohen në atë mënyrë që nxënësit të kenë shkollën sa më afër shtëpisë. Momentalisht, për secilin nxënës janë në dispozicion 3.15 m<sup>2</sup> të hapësirës shkollore, ndërsa brenda kufijve të qytetit kjo hapësirë është më e vogël, 2.66 m<sup>2</sup> për nxënës.<sup>11</sup>

Universiteti i Prishtinës është pikë fokale (vatër) e arsimit dhe kulturës në Kosovë me 42.759 studentë aktualisht<sup>12</sup>, përderisa në Prishtinë ka rreth 30 Universitete dhe kolegje private.

#### I. I.V. PROFILI I INFRASTRUKTURËS DHE RRJETIT TË TRANSPORTIT

Prishtina ka rrjet të dobët të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, përderisa rrugët kryesore që shpiejnë për në Ferizaj-Shkup, Gjilan, Leskovc, Podujevë-Nish, Mitrovicë-Beograd, Pejë dhe Prizren-Tiranë kalojnë nëpër Prishtinë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës gjendet rreth 25 km nga qendra e Prishtinës, tanimë të privatizuar dhe në avansim e sipër, me investime të reja për shërbime më cilësore, terminal të ripër ofrim shërbimesh deri në 5 milion udhëtarë në vit. Rruga që lidh aeroportin me qytetin ka

<sup>11</sup> PZHK e Prishtinës 2013-2022

<sup>12</sup>

standard të ulët në kuptim të kohës së arritjes, shenjzimeve, shërbimeve të transportit publik etj, të cilat janë minimale.

Sot në qytetin e Prishtinës kemi trafik të densifikuar në pjesët e hyrjes nga rrugët kryesore, kombëtare, rajonale dhe rrugët e tjera lokale. Kohëve të fundit, zhvillimet ndodhin përgjatë koridoreve rrugore, të përqendruar kryesisht në rrugët kryesore që drejtojnë për në Prishtinë, përderisa ndërtimet e objekteve janë kryesisht komerciale, për biznese të vogla ose banesore. Zhvillimi dhe rritja e përqendrimit të këtyre objekteve si dhe rritja e shpejtë e zhvillimeve të ndryshme ka bërë që gjendja momentale e trafikut të jetë e ngarkuar, sidomos përgjatë rrjetit kryesor të rrugëve.

Transporti rrugor - e ka rolin kryesor në transportin e pasagjerëve dhe të mallrave prej dhe për në Prishtinë, përmes linjave ndër -urbane, por edhe linjave ndërkombëtare. Të gjitha këto linja të transportit urban, ndërurban dhe ndërkombëtar, kanë nisjen nga stacioni qendror- Stacioni i Autobusëve të Prishtinës.

Siguria në trafik pranë rrugëve magjistrale nuk është në nivelin e duhur për shkak të përqendrimit të lartë të banesave pranë këtyre rrugëve. Qasjet e njëjësive të banimit direkt në rrugët kryesore dhe rrugët apo fshatrat që i afrohet përgjatë këtyre akseve janë të shpeshta. Edhe në segmente të caktuara të rrugëve kryesore, intensiteti i mjeteve të trafikut dhe këmbësorët është mbi nivelin ekzistues të kapaciteteve të rrugëve, edhe pse në disa segmente janë bërë përmirësime.

Gjithsej janë 34 linja të transportit ndërurban, 10 linja të transportit urban dhe 24 linja që lidhin me periferinë apo fshatrat e Prishtinës.

Transport hekurudhor - Rrjeti i hekurudhës vepron nga stacioni kryesor në Fushë Kosovë në dy shtete fqinje (Maqedoni dhe Serbi). Linjat hekurudhore janë rreth 333 km pa përfshirë linjat industriale që janë gjithsej 103 km. Këto linja, lokomotivat dhe vagonat e tyre nuk janë në kushte të mira dhe kërkojnë investime të mëdha. Transporti hekurudhor vetëm për mallra dhe pasagjerë është funksional që nga viti 2007 dhe atë me shumë pak linja udhëtimi: Prishtinë – Pejë - Prishtinë dhe Prishtinë – Hani i Elezit – Prishtinë, përderisa përtej kufijve kalon vetëm treni për Shkup.

Transporti jomotorizuar- Prishtina është në fazë shumë të hershme të vetëdijes për rëndësinë e transportit të jomotorizuar karshi zhvillimit të qëndrueshëm urban. Ende rrugët shihen vetëm për transport të motorizuar, rrugët janë të pasigurta për bicikleta, nuk ka linjë të posacme për to. Sistemi i sinjalizimit të rrugëve nuk është i harmonizuar me standarte evropiane, përderisa dhe shtigjet e veçanta për këmbësorë nëse ekzistojnë, janë të uzurpuara nga parkimi I veturave të

shumta. Shkollat të cilat janë të vendosura në afërsi të rrugëve kryesore përdorin anët e rrugëve në mungesë të trotuareve në disa pjesë të rrugës, pa mbrojtje të rrugës dhe të pasigurta. Duke konsideruar sigurinë e lëvizjes së këmbësorëve ndihet mungesa e nënkalimeve për këmbësorë dhe mbikalimeve, në lidhje me kërkesat e rrugëve kryesore të kalimit nga njëra anë në tjetrën. Edhe në ato zona ku gjenden, disa prej tyre nuk janë të arritshme për shkak të mos-pajtueshmërisë nga këmbësorët vetë dhe niveli i pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e tyre nga organet kompetente.

*Transporti ajror* - Aeroporti Ndërkombëtar I Prishtinës është jashtë territorit të Prishtinës dhe lidhet nëpërmjet Fushë Kosovës dhe Lipjanit me kryeqytetin në një distancë prej 25 km. Sa I përket qasjes prej dhe deri në aeroport, ka mangësi të mëdha, si psh transporti publik I rregullt nuk është I organizuar, përderisa para viteve '99 ka ekzistuar nga qendra e qytetit të Prishtinës, shenjëzimet janë të pakta dhe jo shumë të dukshme, hyrje daljet në vendparkim të ANP janë të disorganizuara etj.

#### I. I.VI. HISTORIKU I PLANIFIKIMIT HAPSINOR DHE URBAN PËR PRISHTINËN

Dokumentet me të cilat dëshmohet se për Prishtinën dhe rregullimin e saj urban është planifikuar datojnë që nga viti 1937, përderisa ato të periudhës së mëhershme nuk janë të dokumentuara. Në vijim do të paraqiten dokumentet e planifikimit dhe rangu I tyre:

- *Plani i Rregullimit të Prishtinës – I hartuar më 1937,*
- *Plani i dytë i Rregullimit – I hartuar më 1948;*
- *Më 1950, hartimi I Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës – përfundoi në vitin 1953. Planifikohej për deri në vitin 1980- për 50.000 banorë/950 ha.*
- *Më 1965 u mor vendimi për zgjërimin e kufijve të rajonit ndërtimor të qytetit në 1950 ha (Shënimi nga "Programi urbanistik" i vitit 1970). Planifikohej për deri në vitin 1980- për 107.000 banorë/1950 ha.*
- *Më '1965, filloi hartimi i "Planit 'direktiv të trafikut dhe dedikimit të sipërfaqeve të qytetit", i cili përfundoi dhe u aprovua më 1967. Planifikohej për 100.000 banorë/1950 ha (Nga dokumentacioni ka mbetur vetem shtojca grafike e dedikimit të sipërfaqeve)*
- *Më 1969 - Vendimi me të cilin "Plani direktiv i trafikut dhe dedikimit të sipërfaqeve të qytetit" zevendësohet me Planin e Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës, PPU i vitit 1953 hiqet nga fuqia.*
- *Më 1970 – Hartohet Programi Urbanistik i qytetit të Prishtinës. Planifikohej për 16.000 banorëve/192 ha ,*
- *Më 1970, Enti për Zhvillim Ekonomik dhe Shoqëror të Prishtinës hartoi, "Programin Urbanistik të qytetit të Prishtinës dhe të vendbanimeve periferike".*
- *Më 1975, u aprovua "Projekti I Detyrës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës" dhe u mor vendimi për fillimin e hartimit të PPU-së ((Fletorja zyrtare e KSAK" , nr"51/75)*
- *Më 1988, është aprovuar Plani I Përgjithshëm i Prishtinës për periudhën deri në vitin 2000, për 225000 banorë/4335Ha.*
- *Më 2004 është aprovuar Plani Strategjik I Prishtinës për periudhën deri më 2020, për numër të banorëve 650.000/4335 Ha.*
- *Më 2013 është aprovuar Plani Zhvillimor komunal 2013 – 2022 dhe Plani Zhvillimor Urban 2013 - 2025*



Fig. 8. Kronologjia e planifikimit urban të qytetit të Prishtinës




Fig. 9 Plani I Përgjithshëm I Prishtinës deri më 2000



Fig. 10 Plani strategjik i Prishtinës 2004-2020

Koncepti i dokumentit të aprovuar me modelin e procesit të hartimit të PPU-së, kishte për qëllim të vendosë bazat për fillimin e planifikimit dhe rregullimit të vazhdueshëm, të hapësirës së

Prishtinës.

Në skemën e mëposhtme paraqitet grafikisht rritja urbane e Prishtinës, me dy parametra, në një rën anë sipërfaqja apo madhësia e shprehur në hektarë, prej 1980 -2020 .<sup>13</sup>




Fig. 11 Rritja urbane e Prishtinës

<sup>13</sup> Sipas PHK 2010-2025+

## I.II. ANALIZA E TRENDIT SIPAS STATISTIKAVE TË MIGRIMIT DITOR NË PRISHTINË

Në këtë seksion do të elaborohen të dhënat statistikore të vitit 2011, numri i popullatës në qytet të Prishtinës porse dhe në regjionin e ngushtë urban të saj të përbërë nga katër komuna (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë), trendin e tregut të punës, migrimin ditor të tyre drejt Prishtinës si kryeqendër. Të dhënat janë sipas Agjensisë së Statistikave të Kosovës, sipas regjistrimit të vitit 2011.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 del se komuna e Prishtinës I ka 198.897 banorë, përderisa regjioni urban në këtë studim, i përbërë nga pesë komuna përfshirë dhe Prishtinën i ka përmbi 405.899 banorë (Shih Tab.4.).

Sipas vlerësimeve të fundit të ekonomive familjare sipas rajoneve të Kosovës, del se numri i popullsisë në rajonin e Prishtinës është 531.602 banorë, dhe numri I ekonomive familjare në

Komuna	Numri I banorëve
Prishtinë	198.897
Lipjan	58.909
Fushë Kosovë	36.897
Obiliq/Kastriot	22.011
Podujevë	89.185
Gjithsejt	405.899

rajonin e Prishtinës është 87.045, me përfaqësim në nivel vendi me 28.1%, ku në pjesën urbane kemi 46.133 apo 53 % ndërsa në ato rurale 47% (Shih Tab.5.)

Tab.4. Numri I banorëve të Regjionit Urban të Prishtinës

Regjion	Totali			Urbane			Rurale	
	NR. QR	NR. EKONOMIVE FAMILJARE	% EKONOMIVE FAMILJARE TOTALE SIPAS RAJONIT	NR. QR	NR. EKONOMIVE FAMILJARE	% EKONOMIVE FAMILJARE URBANE NË RAJON	NR. QR	NR. I EKONOMIVE FAMILJARE
Gjakova	461	31,416	10.2%	123	11,879	37.8%	338	19,537
Gjilan	540	33,082	10.7%	125	13,139	39.7%	415	19,943
Mitrovica	748	43,981	14.2%	202	20,089	45.7%	546	23,892
Peja	458	30,356	9.8%	120	12,458	41.0%	338	17,898
Prizreni	732	52,436	16.9%	196	20,172	38.5%	536	32,264
Prishtina	1,208	87,045	28.1%	428	46,133	53.0%	780	40,912
Ferizaj	479	31,095	10.0%	121	11,592	37.3%	358	19,503
<b>Totali</b>	<b>4,626</b>	<b>309,411</b>	<b>100.0%</b>	<b>1,315</b>	<b>135,462</b>	<b>43.8%</b>	<b>3,311</b>	<b>173,949</b>

Tab. 5. Numri I ekonomive familjare sipas rajoneve




Fig.12. Dendësia mesatare e popullatës sipas rajoneve në Kosovë gjatë viteve

Në figurën e mësipërme shihet trendi i dendësimit të rajonit të Prishtinës, komunës së Prishtinës porse dhe të qyteteve fqinje përreth. Sipas regjistrimit të vitit 2011, dendësia banimnore mesatare në regjionin urban të Prishtinës, është mbi 300 banorë/km<sup>2</sup> (Shih fig.12.), porse ajo arrin dhe numrin përmbi 5000 ban/km<sup>2</sup>, në zona të ngushta strikte qendër urbane. (shih Fig.13. )




Fig.13. Dendësia banimnore në Kosovë ban/km<sup>2</sup>




Fig.14. Harta e migrimit të brendshëm në Kosovë

Sipas hartës së migrimit të brendshëm të Kosovës, në nivel vendi për regjion urban të Prishtinës, kemi nivelin më të lartë të ardhjeve në regjion, atë përmbi 100. (Shih fig.14.).





Fig.15. Personat që udhëtojnë rregullisht në Prishtinë

Fig.16. Personat që udhëtojnë rregullisht në Prishtinë

Në hartën e personave që udhëtojnë rregullisht në Prishtinë, për nga numri shihet se e kemi atë të përmbi 1000 personave në ditë, ardhjeve ditore në Prishtinë, nga regjioni I ngushtë urban I saj, përdërisa nga qytetet e tjera shumë më pak. (Shih fig.15.). Në figurën tjetër paraqitet distanca prej nga më së shumti udhëtarët vijnë në Prishtinë, në distancë prej 21-60km- regjioni I ngushtë urban I Prishtinës (Shih Fig.16.)

**Konstatim** - Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, mund të shohim se në Prishtinë kemi migrim ditor të popullsisë prej 35 % më shumë se numri I popullatës së Prishtinës/ në ditë. Ardhjet kryesore janë nga regjioni I ngushtë I saj, komunat fqinje.

### I.III. ANALIZA E PRISHTINËS NË KONTEKST TË PLANIT HAPSINOR TË KOSOVËS 2010 – 2025+

Në këtë pjesë do të elaborohet pozita e Prishtinës në kontekst të Planit Hapsinor të Kosovës 2010 – 2025, për të zbërthyer pritjet dhe orientimet zhvillimore për qytetin e Prishtinës porse dhe të regjionit, të cilës ajo i përket: Hapësirës së kaltërt – Portit të Kosovës. Këto analiza do të bëhen me qëllimin e vetëm, që të argumentohet dhe me një fakt tjetër se qyteti I Prishtinës parashihet të jetë Regjion urban metropolitan për të funksionuar si qytet amë, I një funksioni dhe roli politik, ekonomik e diplomatik, e për më shumë dhe pse jo të një qyteti global.



Prishtina sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010-2025, gjendet në qendër të zonës së “Portit të Kosovës”- Hapësirës së kaltërt, e cila përbëhet nga komuna e Prishtinës, Obiliqit apo Kastriotit, Podujevës, F. Kosovës, Lypjanit, Drenasit dhe Shtimes në qendër me qytetin e Prishtinës.



Fig. 17 Plani Hapsinor I Kosovës 2010-2020+  
*Kaltërt*



Fig. 18 Qyteti I Prishtinës në kontekst të “Hapësirës së Kaltërt”

Prishtina sipas PHK 2010-2025 është bartës kryesor I funksioneve ekonomike, diplomatike, shkencore e kulturore, rreth të cilës dhe sajohet i ashtuquajturit “TZHEK” – trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës”, kurriz i zhvillimit ekonomik të Kosovës. I atribuohen funksionet e ndërlidhjeve të shumta me botën, jo vetëm infrastrukturore ajrore, rrugore e hekurudhore, porse dhe ato institucionale.

Sipas PHK 2010-2025, tërësia e tillë zhvillimore “Porti I Kosovës” i përbërë nga 7 qytete, me Prishtinën në qendër, ka karakteristika “Të rajonit të dendur të qendrave urbane dhe atyre rurale në zhvillim e sipër, tokës bujqësore të kualitetit të lartë, pasurisë nënëntokësore (linjit, Ni, Pb, zink, ari), hapësirave dhe objekteve të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore, hapësirave të lira të gjelbra, ndërsa për nga veprimtaritë ekonomike karakterizohet me ato industriale, tregtare dhe shërbyese, si dhe veprimtaritë administrative, shëndetësore, arsimor dhe shkencore”.

- Prishtina është e rrethuar me komunat si :Lipjani, Fushë Kosova, Kastrioti dhe Podujeva me të cilat ka lidhje shumë të ngushta zhvillimore. Zhvillimi I këtyre komunave është I kushtëzuar me bashkëpunimin mes tyre.



- Prishtina/Qytet i së ardhmes - Për të rinjtë, studentët, fëmijët dhe pleqtë, qytetarët e saj. Me të planifikuarën e kujdesshëm të qytetit PORT, të kaltërt dhe të integruar me botë, me shoqëri të njohurive, me mjedis të pastër dhe të gjelbërt, qytet të larmishëm dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar në të, konkurent në regjion.
- Prishtina/Qytet – metropolë. - Planifikohet me kujdes, duke parasysh të vjetrën e ndritur kulturore dhe historike, identitetin urban të një qyteti tregtar, diplomatik e kulturor, përmes shfrytëzimit racional të hapësirës. Qytet ekonomisht stabil dhe i suksesshëm, qendër i bizneseve të shumta nacionale dhe ndërkombëtare, qendër e rëndësishme logjistike.
- Prishtina/Qytet të Ekonomisë së Njohurive. - Qytet studentor, universitar në zhvillim, qytet në shërbim të bizneseve të teknologjië së lartë, i partneritetesh të ndryshme ndërmjet universitetit, institucioneve shkencore, sektorit privat dhe public, qytet që absorbon fondet ndërkombëtare me kapacitetet njerëzore. Qytet ku Universiteti I Prishtinës së bashku me universitetet private, me hapësirat e tyre ofrojnë mbajtjen e konferencave ndërkombëtare, duke mbështetur kështu turizmin konferenciar.
- Prishtina/Qytet -incubator I cili ofron infrastrukturën, platformën “Si - të dish” dhe financat për të mbështetur këto biznese, qofshin ato të dala apo të ofruara nga universiteti, apo nga firmat nacionale ekzistuese. Qytet që mbështet zhvillimet e reja jo vetëm me hotele për të mbështetur komunitetin e biznesit ndërkombëtar, porse dhe hapësira tjera përcjellëse.
- Prishtina/Qytet– gjenerator I zhvillimit ekonomik– Me Plan Zhvillimor Urban planifikohet me kujdes për sigurimin e kushteve për zhvillim ekonomik local, joshur dhe mbajtur ndërmarrjet active në qytet, ofrimin e hapësirave kulturore, tregtare dhe rekreimit e pushimit. Qytet I cili siguron klasës së re profesionale të Kosovës, komunitetit të kthyer kosovar të interesuar për ofrimin e formave të reja për turizëm kulturor.
- Prishtina/Qytet i artit - Që ofron dhe kultivon art të shumëllojshëm, qendër me hapësira të distrikteve të artit – përderisa objektiv ka riparimet/adaptimet modeste të objekteve të vjetra ekzistuese, për artistë dhe dizajnerë. “Hapësirat e imagjinatës” do jenë ato të cilat do inkurajnë aktivitetet avangarde dhe kulturore.

Tab. 6. Orientimet zhvillimore për Prishtinën sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010- 2020+

### I.III.I. PRISHTINA NË KONTEKST REGJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Prishtina si kryeqytet i Kosovës gjendet në qendër të Evropës Juglindore dhe historikisht pohohet të ketë qenë udhëkryq i rëndësishëm i Gadishullit Ballkanik. Profili fizik i saj mundëson lidhje substanciale me shtetet fqinje të rajonit.

Qyteti i Prishtinës, gjatë historisë ka dëshmuar se kishte rol gjeostrategjik për shkak të pozitës së saj, rolit gjeopolitik në shumë periudha të kohës. Këto bashkëpunime me qytetet e shumta në regjion ishin kryesisht në kuptim të shkëmbimit tregtar, që prej kohës së venedikasve apo raguzianëve porse dhe me tregtimin e xeheve nga Novobërda, në të cilin aktivitet Prishtina kishte një rol shumë të madh.

Tani me pozitën e saj strategjike si kryeqytet i Kosovës, roli i saj vetëm sa vjen e shtohet.



Fig. 21. Prishtina/Kosova në kontekst rajonal dhe Evropjan

Lidhjet me kryeqytetet e vendeve të tjera fqinje, mund të përmirësohen duke vendosur standarde më të mira të rrjetit rrugor, hekurudhor, ajror e të teknologjisë informative, sikurse dhe atë institucional apo të shërbimeve. Në këtë kontekst, kyçja në rrjetin e trafikut rajonal dhe ndërkombëtar paraqet një nga qëllimet kryesore të strategjisë zhvillimore për qytetin e Prishtinës.

Prishtina si qendër destinimi ndërkombëtar i transportit ajror për Kosovë, shërben si trajektore drejt qendrave tjera turistike në Kosovë dhe më gjërë. Kjo për vendatraksionet natyrore, me vlera dhe potenciale të mëdha për rihvillim të industrisë së turizmit dimëror dhe kulturor (Prizreni, Gjakova, Peja) etj.

Rrjetëzimet me dekada të tëra që më parë të krijuara janë vlerë e shtuar e qytetit të Prishtinës, prose duke i shtuar dhe rrjetëzimet e krijuara së voni janë për më shumë, mudnësi që i shtojnë vlerën dhe potencialet zhvillimore. Shumë nga rrjetëzimet tanimë dhe janë zbehur e humbur, të cilat do të duhej të sendërtohen me kohë, prose synimet do të duhej të jenë të qarta dhe veprimet

e kalkuluara mirë dhe drejt përmbushjes së synimit. Këto bashkëpunime ishin me Tetovë e Shkup, Tiranë e Ulqin, porse dhe më tej regjionit të ngushtë.

Pas përfundimit të luftës (viti 1999), prezenca e fuqishme ndërkombëtare në Kosovë, i dha këtij territori e sidomos Prishtinës, një veçori ndërkombëtare. Angazhimi ndërkombëtar mund të ndryshojë në të ardhmen, porse Kosova më tej do të ketë lidhje të shumta dhe do të ketë rast që në të ardhmen të bëhet bazë e komunitetit ndërkombëtar në Ballkan.

+ Përparësitë	- Dobësitë
<i>Pozitë qendrorë në Evropë juglindore</i>	<i>Standard i ulët i rrugëve dhe hekurudhës.</i>
<i>Lidhjet e mira ndërkombëtare ajrore;</i>	<i>Lidhjet e pamjaftueshme me rrjetin e trafikut evropian</i>
<i>Vullneti dhe aftësitë për TIK</i>	<i>Probleme te TIK</i>

Me realizimin e autostradës së planifikuar Durrës- Kukës, Prishtinë-Merdar, Prishtina do të fitojë lidhje direkte me Nishin e Sofjen dhe kështu një pjesë e trafikut ndërkombëtar nga Evropa Lindore mund të ridrejtohet kah Kosova për në limanet e bregdetit Adriatik.

Qyteti i Prishtinës apo dhe bashkëpunimi me qytetet tjera në rajon janë kusht i domosdoshëm për ngritje ekonomike në sferën e ekonomisë së njohurive, sipas parimeve të ESDP – apo Programit Evropjan për Zhvillim Hapsinor; Agjenda së Lisbonës duke promovuar kohezionin territorial, ekonomik dhe social në territorin e Evropës; Programit Evropjan për Observim Territorial të zhvillimeve dhe kohezionit – ESPON.

Parimet dhe parametrat e zhvillimit urban të qytetit të Prishtinës përmes Zhvillimit të Bazuar në Njohuri tanime monitorohen dhe nga Banka Botërore, përmes “Indeksit të Ekonomisë së Njohurive”- dhe e cila bën rangimin e qyteteve në botë;

Tendenca e Prishtinës është që të josh sa më tepër studentë dhe ndërkombëtarë dhe të cilët do të jenë shtytja kryesore e ekonomisë lokale. Kjo dhe në vijë me trendin e qyteteve në rajon dhe në Evropë dhe i cili trend tanimë me parametrat matës se sa një qytet ju ka ofruar Ekonomive të njohurive, matet dhe raportohet nga secili qytet që tenton këtë llojë zhvillimi.

Me realizimin e autostradës së planifikuar Durrës- Prishtinë-Merdar, Prishtina do të fitojë lidhje direkte me qytetet e tangjentuara sikurse që një pjesë e trafikut ndërkombëtar nga Evropa Lindore mund të ridrejtohet përmes Prishtinës për në limanin e Durrësit dhe të Shëngjinit për të vazhduar më tej.

Prej vitit 1999, prezenca e fuqishme ndërkombëtare në Kosovë, i dha qytetit të Prishtinës, një veçori ndërkombëtare, orientime zhvillimore të reja të adaptuara kohës.

#### I.IV. ANALIZA E QYTETIT TË PRISHTINËS DHE DEFINIMI I ZONËS FUNKSIONALE URBANE TË SAJ SIPAS OECD


Në këtë pjesë do të argumentohet definimi i qytetit të Prishtinës dhe zonës më të gjërë urbane të saj (me katër komunat fqinje, Lipjan, Fushë Kosovë dhe Podujevë) si Zonë Urbane Funktionale<sup>14</sup>,” sipas OECD- Organizatës Evropjane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.

Identifikimi i zonës së gjërë urbane ditore të Prishtinës, shërben për krahasueshmëri me zonat e tjera funksionale urbane të Evropës e të botës, bashkërendim me zonat e tjera urbane funksionale të Evropës, e gatshme për raportim dhe monitorim, bazuar në të dhëna statistikore regjionale.<sup>15</sup>

OECD, në bashkëpunim me Komisionin Evropjan dhe Entin e Statistikave Evropjane - Eurostat, ka zhvilluar një qasje të re për klasifikimin e zonave urbane me qëllim të monitorimit më të mirë të zhvillimeve urbane midis vendeve.

Sipas klasifikimit, identifikohen zonat funksionale urbane përtej kufijve të qytetit, për të pasqyruar realitetin – gjeografik dhe ekonomik ku njerëzit jetojnë dhe punojnë, njësitë funksionale ekonomike, udhërrëfyese për prioritetet e qeverive, planifikimin e qyteteve, transportit, banimit, shkollave, hapësirave për kulturë dhe rekreacion.

Planifikimi i përmirësuar do të bëjë që këto zona urbane, të jenë më konkurruese për të mbështetur krijimin e vendeve të punës dhe më shumë tërheqëse për banorët e saj. Një



përkufizim i tillë është aplikuar për 28 vende të OECD dhe i identifikon 1148 zonat urbane me të paktën 50 000 banorë.

Fig.22. Përqindja e popullatës urbane sipas qyteteve (2008)

<sup>14</sup> FUA – “Functional Urban Zone, (“Redefining urban”, Department for Communities and Local Government, United Kingdom, 2012) ;

<sup>15</sup> <http://ëëë.oecd.org/regional/redefiniqurbananeëëaytomeasuremetropolitanareas.htm>

Dy të tretat e popullsisë në vendet e OECD jetojnë në zonat urbane, porse përvojat e tyre urbane janë të ndryshme.

50.000 – 200.000 banorë – Qytet - Qendër urbane e vogël  
200.000 – 500.000 banorë – Qytet – Qendër urbane e madhësisë së mesme  
500.000 – 1.000.000 banorë - - Qytet- Qendër Urbane metropolitane  
>1.000.000 banorë – Qytet – Qendër Urbane metropolitane e madhe

*Tab.7. Definimi i madhësisë së qyteteve sipas OECD*

Sipas definicionit të OECD, Prishtina me rreth 200.000 banorë në komunën e saj dhe me 148.000 në zonën e saj urbane, paraqet 74% të popullsisë urbane. Sipas përkufizimeve të OECD – Qyteti i Prishtinës do të mund të kategorizohet si Qytet - Qendër Urbane e madhësisë së mesme me 200 000 banorë (pa zonë me katër komunat fqinje), përderisa poashtu do të ishte e madhësisë së mesme urbane me 405.000 banorë (me katër komunat fqinje).

Identifikimi i Zonës së Migrimit Ditor të Regjionit sipas OECD, është bërë përmes argumentimit të përmbushjes së kriterit se mbi 15% të punëtorëve ditorë vijnë nga një qendër tjetër urbane fqinje, përderisa punojnë në qendrën tjetër urbane me më shumë se 500000 banorë. Bazuar në këtë kriter, në rastin e Prishtinës kemi sipas statistikave të fundit të vitit 2011 sipas Entit të Statistikave të Kosovës, ardhje ditore të punëtorëve në Prishtinë përmbi 35 %. Ky është niveli i migrimit ditor, i cili vie nga komunat fqinje: (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë), në qendrën urbane të Prishtinës e cila i ka përmbi 50000 banorë. Zona e migrimit ditor të Prishtinës paraqet regjionin e Prishtinës me katër komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë).

Në skemën e mëposhtme është paraqitur Konteksti I qytetit të Prishtinës, me të cilën konstatojmë se ekziston nevoja e organizimit/funksionimit si regjion urban përmes bashkëpunimit regional me komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë).




Fig. 23. Skema e kontekstit të regjionit urban të Prishtinës

## KAPTINA II. PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE TË QYTETEVE – METROPOLITANE-REGJIONEVE URBANE METROPOLITANE DREJT ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI

Në këtë pjesë do të paraqiten disa raste të qyteteve të suksesshme, të cilat ngjasojnë me rastin e Prishtinës, për nga madhësia, rëndësia, numri i banorëve apo dhe orientimet zhvillimore që kanë. Është ky qyteti Aachen – në Gjermani në kufi me Holandën dhe Belgjikën.

### II.I. BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL – RASTI I QYTETIT AACHEN, QYTETIT TË LJUBLJANËS

Aachen ka rreth 250 000 banorë dhe për dallim me qytetet e tjera të zonës Ruhr, popullata në Aachen po rritet. Regjioni Aachen konsiston në nënregjionet Aachen, Dueren, Euskirchen, Heinsberg dhe qytetin e Aachen-it. Në këtë regjion jetojnë për më shumë se 1.3 milion banorë. (2007). Në aspekt administrativ, të pesë nënregjionet e Regjionit të Aachen janë pjesë të Shtetit Federal të Rajnës veriore -Ëestphalia (NRË) dhe për të qenë më specifik, pjesë të distriktit të Kolonjës (një ndër 5 distriktet e NRË).



Për më shumë, “Regjioni Aachen” si i tillë nuk ekziston ne terme politike dhe administrative, sido që të jetë, shumë nga institucionet publike që operojnë janë të vendosura në regjionin Aachen, ndër to dhe Oda Ekonomike e Aachen (IHK) sikurse dhe Agjencia Zhvillimore e Aachen (AGIT).

10.7 përqind e popullatës në regjionin Aachen mbajnë pasaportë të huaj, ku shumica e të huajve jetojnë në pjesë tjera aglomerimesh urbane. Shumica e punëtorëve në të kaluarën mbanin nacionalitet gjerman përderisa shume studentë vijnë nga pjesët tjera të Gjermanisë. Afërsia me kufirin e Holandës sikurse dhe me të Belgjikës rrit llojllojshmërinë dhe më tepër – Aachen është joshës dhe destinim për shopping nga fqinjët.(Maks 2002). Regjioni Aachen është shtëpi e një numri të madh emigrantësh apo “punëtorëve mysafirë”, shumica e të cilëve të paarsimuar dhe të cilët vijnë nga Turqia që nga vitet e ‘60ta, përderisa dhe nga Bashkimi Sovjetik poashtu.

Aachen është vërtet qytet i studentëve – 40.000 nga 250.000 banorë janë studentë. Në krahasim me qytetet tjera të regjionit të Ruhr, popullata e Aachen është në rritje. Sido që të jetë, shumë nga studentët e Universitetit të Aachen nuk qëndrojnë në qytet pas diplomimit –dhe tentativat janë për të lëvizur në Gjermaninë jugore. Regjioni Aachen është i karakterizuar me kompani të vogla dhe të mesme. Kompanitë në regjionin Aachen janë – konkurentë në Gjermani, përderisa ballafaqohen me vështirësi të shumta për të joshur inxhenjerët më të mirë.

Pozita konkurruese e regjionit është gjithashtu e mbështetur me infrastrukturë e që është duke u përmirësuar përmes rrugës Aachen-Keln dhe përmes përmirësimit të lidhjes së trenit të shpejtë. (EU High Speed Train). Për momentin HST shkon për Keln dhe Bruksel dhe jo në afërsi të qytetit të Aachen-it, përderisa Aeroporti Ndërkombëtar i Dyseldorfit mund të arrihet shumë lehtë përmes autostradës- për 85 km. Për më tepër pranë janë dy aeroporte ndërkombëtare vetëm përgjatë kufirit, në Liege dhe Maastricht, sikurse dhe porti më i madh në Evropë, i locuar në Liege (EURICUR, 2007).

Aachen është e vendosur në një afërsi me kufirin belg dhe holandez, me lidhje të mira me aglomerimet e rëndësishme në dy shtete (qytet belg Liege larg 40 km dhe Maastricht – 30 km vijë ajrore).

Rast të ngjashëm për krahasim kemi dhe qytetin e Aarnheim-it ne Holande, Hermanas në Spanjë, Nijmegen – Holande etj .

Si shembull i një qyteti – regjion për krahasim në këtë studim kemi regjionin e Ljublanës, regjion ky i cili duke përfshirë kryeqytetin e Lubjanës, bashkon 26 autoritete lokale me rreth 500.000 banorë, si pjesën më të populluar /dendur të Sllovenisë. Për më shumë, ajo gjithashtu ka



- Në Gjermani “metropolis-i” është qytet I madh dhe me rëndësi. Rëndësia e qytetit është e matshme, me tri grupe indikatorësh, funksione metropolitane: Vendimmarrje, Funksion të kontrollit, inovacionet dhe funksioni i konkurrencës. Këto funksione shihen si predominante për regjione metropolitane në mbrojtjen dhe zhvillimin e performancës.

## II.II. TRANZICIONI DREJT EKONOMISË SË NJOHURIVE TË QYTETEVE EVROPJANE

Qytetet e shumta e të suksesshme në Evropën Perëndimore kanë përkrahur zhvillimin e bazuar në njohuri apo të ashtuquajturën Ekonomi të Njohurive si strategji zhvillimore, zhvillim me të cilin qytetet përfitojnë me joshjen e klasës kreative, artit dhe shkencës, ndërmarrësisë, vendosjen e kompanive të shumta, ngritjen e ekonomive lokale, kultivimin e identiteteve të tyre, porse duke pasur vëmendje të posacme në rritjen e kualitetit të jetës, si qëllim parësor.

Shumë qytete të Evropës Juglindore tanimë synojnë dhe planifikojnë Zhvillimin e Bazuar në Njohuri apo Ekonomitë e Njohurive, përderisa në përmbushjen e kriterëve të duhura, përmbushen objektiva të shumta drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Ekonomia e Njohurive si qëllim apo zhvillim i qyteteve ka një ndikim të fortë në qytetet e Evropës, përderisa kërkon veprime dhe përgjegje të politikave specifike. Udhëheqësit në Evropë kanë paraqitur nevojën për të forcuar intensitetin e qyteteve me ekonomi të njohurive (“Agjenda e Lisbonës”), përderisa është e njohur se qytetet luajnë rol madhor në arritjen e këtij qëllimi (Van den Berg et al, 2004).

Forcë fundamentale e restrukturimit të qyteteve, është rritja e rëndësisë së njohurive në krijim të të mirave materiale dhe implikimet në zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë kontekst mund të thuhet se Zhvillimi i Bazuar në Njohuri, transformimi i resurseve të njohurive në zhvillim lokal mund të ofrojë BAZË për Zhvillim të qëndrueshëm.

Urbanizimi i shpejtë i botës është në rritje e sipër, e cila në vecanti u jep qyteteve të mëdha përgjegjësi më të mëdha për të shërbyer më shumë banorë – qytetarë, rol ky i cili i bën dhe përgjegjës të të qenit akselerator të zhvillimit ekonomik për vete dhe për vendet të cilave ju takojnë.

Nuk është lehtë të definohet se cilat qytete janë të suksesshme në ekonominë e njohurive. Mund të thuhet se të gjitha ekonomitë kapitaliste janë sot në ekonominë e njohurive, sepse sot, deri në një shkallë, sistemet e prodhimit i kanë dematerializuar proceset e tyre, duke potencuar informatën si vlerë të shtuar (psh. Logjistika, ëeb shërbimet, e kultura, TIK, etj) dhe duke u varur nga njohuritë si një e hyrë e rëndësishme. (EURICUR, 2007)

Sipas Stiglitz (1999), “njohuritë dhe infomata prodhohen sot sikurse veturat dhe çeliku që janë prodhuar njëqind vjet më parë. Ata të cilët dinë më mirë se si të prodhohet njohuria dhe informata, grabisin shpërblimin...”. Rritja e klasës së “punëtorëve të njohurisë” nuk do të nënkuptojë prodhimin e asnjë produkti, por në vazhdimësi transformon njohurinë dhe informatën në njohuri dhe informata për të cilat ka treg. Kjo ka të bëjë me shumicën e vendeve me ekonomi të zhvilluar. Reich (1991) zbuloi fjalën për këtë kategori të njerëzve: analistë simbolik. Këta njerëz janë mirë të arsimuar; fitojnë rroga të mëdha dhe ndërkohë kanë kërkesa të mëdha në kualitetin e mjedisit të tyre jetësor.

Për shkak të globalizimit dhe TIK të ri, shpërndarja e shpejtë e informatës dhe njohurive është rritur dramatikisht. Njohuritë e reja dhe inovacionet të cilat më parë morën muaj të tëra për t’u shpërndarë në aspekt global, tani ajo arrihet për disa sekonda. Kjo shpejton gjithë procesin e krijimit të njohurive të reja. Gjithashtu, për shkak se shumë nga informatat dhe njohuritë janë të qasshme, duke kthyer ato në aktivitete profitabile (Castells, 2000, Hoëells, 2002)

Zhvillimet e shpejta në njohuri dhe informim, don të thotë që asnjë person i i vetëm apo dhe kompani nuk mund të menaxhojë të gjitha disiplinat, apo dhe monitorojë të gjitha zhvillimet. Për kompanitë, është shumë e rëndësishme të angazhohen në rrjeta strategjike për t’u kyqur si resurs i njohurisë, në mënyrë fleksibile. Rrjetëzimi mundëson që të korespondohet më shpejtë në tregje dhe teknologji shume shpejtë të ndryshueshme, të favorshme për kreativitet, prodhimin e kombinimeve të reja. Çdo “pikë” ( e cila mund të jetë kompani, person por edhe qytet) në rrjetën e njohurive duhet të zhvillojë specializimin e tij vetanak (Castells, 2000).

Nuk ka një mënyrë të vetme për qytete për të bërë tranzicionin në ekonomi të njohurive. Qytete të ndryshme, me traditat e tyre të shumta, kulturën dhe historinë e shumtë, kanë kaluar rrugë të ndryshme, sipas Castells dhe Himanen (2002).

### II.III. TRANZICIONI DREJT BASHKËPUNIMEVE REGJIONALE

“Qytetet dhe regjionet garojnë me njëra tjetrën për të joshur kompanitë, njerëzit e kualifikuar dhe resurset e tjera të cilat janë të rëndësishme për ekonominë e njohurive. Në anën tjetër, është duke u qartësuar cdo herë e më shumë se strategjitë konkurruese mund të përfshijnë më shumë kooperim me qytete të tjera, psh joshjen e kompanive. Në rast të zgjedhjes së lokacionit, kompanitë nuk janë të interesuar në kufinj komunal dhe ato të rajonit të ngushtë, por në ofertat e resurseve strategjike (njerëz të aftë, lokacione të biznesit, ekspertizë teknologjike, laboratore, furnizues, klientë, etj) në distancë të arësyeshme.

Në shumë aspekte, kooperimi inter-urban mund të përmirësojë atraktivitetin e regjionit më të gjërë si të tërë, për përfitime të të gjithëve”. (Euricur, 2007).

Bashkëpunimi regjional përmes krijimit të Regjionit Urban Metropolitan do të ishte zgjidhje në përmbushjen e kriterit për madhësi të qytetit. Përderisa ndryshimet e kufijve nuk janë të mundshme dhe nuk janë zgjidhje, përgjigja është në bashkëpunimin ndërkomunal, regjional apo dhe ndërkufitar.

Duke vazhduar sipas studimit të Euricur, 2007, në Evropë është në rritje numri i rasteve dhe iniciativave për bashkëpunime regjionale drejt ekonomisë së bazuar në njohuri. Kemi psh rastin në regjionin Oresund, ku Kopenhaga dhe Malmo u bashkuan për të zhvilluar “grupëzimet” e bazuara në njohuri (“Medicon Ëalley”).

Qytetet luajnë rol të madh në partneritete strategjike, përderisa sfida konsiston në pyetjen se si të krijohen partneritetet e tilla që përnjemend funksionojnë: si të kooperohet, me kë, në çfarë forme dhe me çfarë akterësh.

Raste të tilla bashkëpunimi, dhe qeverisjeje për më shumë të llojit metropolitane kemi në shumë regjione metropolitane tanimë në Evropë.<sup>17</sup>

#### II.IV.ROLI I QYTETEVE

Qytetet janë pika fokale të ekonomisë së njohurive, për shkak se kryesisht në qytete prodhohet njohuria, është e procesuar, e shkëmbyer dhe e tregëtuar. Qytetet janë më së miri të furnizuar me infrastrukturë të njohurisë (universitetet, institutet tjera arsimore, etj); ato tentojnë të kenë më shumë njerëz mirë të shkolluar; ato janë mirë të furnizuara me infrastrukturë elektronike, ato janë mirë të lidhura me ekonominë globale përmes aeroporteve; ato e kanë rolin si vende për shkëmbimin e njohurive dhe si çerdhe për talentë të rinj dhe kombinime të reja. Për këtë arsye nuk është koincidençë që qytetet e mëdha kanë përparim të madh në vitet e ’90 ta. (Van den Berg, 2006)

Krijimi i njohurive të reja kryesisht zë vend në qytete. Qytetet me bazë të fortë të njohurive duket se fitojnë në ekonomi të njohurive. Ekonomia urbane e njohurive lulëzon nga njerëzit e talentuar të cilët krijojnë njohuri dhe ide të reja. Nga kjo perspektivë, Florida (2000) i studjon vendin e shkathtësive të “talentit”. Përkrah gjërave të tjera, ai gjen se kualiteti i jetës në një vend është determinantë kyqe për të joshur dhe mbajtur këta njerëz.

---

<sup>17</sup> *Regjionet metropolitane janë regjione NUTS-3 që përfaqësojnë aglomerime urbane më shumë se 250 000 banorë. (EUROSTAT)*

“Njerëzit e talentuar thjeshtë nuk e zgjedhin vendin e punës bazuar në pagesën e lartë, ata zakonisht janë të interesuar se çka ju ofron vendi apo në karakteristikat e vendit”. Florida (2000) në aspekt empirik ka gjetur se aktivitetet kulturore sikurse dhe objektet e tilla janë përherë e më shumë të rëndësishme për konkurrencë urbane. Njerëzit e talentuar janë të joshur me vendet ku ata kënaqen me jetën. Kjo ka dhe një efekt kumulativ: sikurse që Florida thotë “.....talenti tenton të joshë talentin”.

Van den Berg (1987) gjithashtu gjen se kualiteti i jetës në zona urbane është faktor i vendit të cilit i rritet rëndësia: njerëzit me kualifikime të larta do të jetojnë në qytete të cilat ofrojnë kualitet të lartë të jetës, përderisa kompanitë i përcjellin.




Fig. 25. Niveli i arsimimit tek qytetet e mesme dhe të mëdha mes 50000 dhe 250000 banorë në shtete e BE-së, viti 2001<sup>18</sup>

Në ekonominë e njohurive, madhësia e qytetit luan një rol për shkak të faktorit joshës për kompanitë dhe punëtorët e njohurive. Për kompanitë, në qytete të mëdha është më lehtë të gjendet staf i specializuar. Për punëtorët e njohurive, të qenit në një zonë të madhe metropolitane rrit llojllojshmërinë e vendeve të punës. Qytetet e mëdha tentojnë të kenë aeroporte më të mëdha dhe shumë prej tyre janë pika të rrjetit të trenit të shpejtë, përderisa zonat e mëdha metropolitane janë relativisht atraktive për investime.


<sup>18</sup> Euricur, 2007

## II. V. QYTETI DHE ZONA E SAJ E GJËRË E MIGRIMIT DITOR

Është koncept rreth të cilit Bashkimi Evropjan bën shumë studime për të ardhur tek politikat zhvillimore dhe mbështetja e tyre në vendet anëtare. Definicioni I ri I qytetit bazohet sipas Eurostat-it në katër hapa, të bazuar në prezencën e një qendre urbane, koncepti të ri hapsinor, të bazuar në dendësinë e popullatës. Kategorizimi si tillë është I domosdoshëm për qytete të shumta në Evropë bazuar fillimisht në numër të popullatës, porse dhe sipas indikatorit të shpërndarjes hapsinore.

Karakteristika të shumta miren si parametër të ndarjes apo kategorizimeve të qyteteve, duke nisur prej i) Hapit të parë – dendësia mbi 1500 banorë/km<sup>2</sup>, ii) Hapit të dytë – grupimi i numrit të popullatës në tërësi prej 50 000 banorëve - si një qendër urbane; iii) Hapi i tretë - rasti i së paku gjysmës së popullatës brenda zonës urbane<sup>19</sup> për të qenë pjesë e qytetit; dhe iv) Hapi I katërt, atëherë kur qyteti paraqet qendër me ndërlidhje të nivelit politik me së paku 50% të popullatës që jeton në qendër urbane.

Karakteristika tjetër e qyteteve metropolitane është zona e migrimit ditor e cila ndikon që ajo



zonë të quhet pjesë urbane e qytetit, përdorërisa 15 % e të punësuarve që jetojnë në qytet tjetër punon në qytet tjetër; (Shih fig.26 - rast i qytetit të Gjenovës – Itali).

Fig. 26 Qyteti i Gjenova's në Itali dhe pjesët e saj të migrimit ditor.<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Njësi lokale administrative të shkallës së dytë (LAU 2)

<sup>20</sup> Directorate-General for Regional and Urban Policy

### **KAPTINA III. ANALIZA E TEORIVE PËR REGJIONE URBANE METROPOLITANE ME ZHVILLIM TË BAZUAR NË NJOHURI**

---

Kjo kaptinë paraqet shqyrtimin e literaturës në kontekst të I)Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të II)Kapaciteteve Organizative, koncepteve dhe definicioneve, kornizës teorike dhe analitike për këtë hulumtim, sikurse dhe definicioneve të shumta nga III)Karta e Leipcigut<sup>21</sup> ; IV) Traktati i Lisbonës për kohezion territorial (2007);

#### **III.I. TEORIA E ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI - ROLI I QYTETIT SI DETERMINANT SUKSESI**

---

Ky seksion paraqet konceptet dhe definicionet e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative të nxjerrë nga literatura, në kontekst të rëndësisë për zhvillim të qyteteve.

Në mënyrë që të kuptojmë konceptet e tilla, duhet fillimisht t'i sqarojmë disa pyetje si psh: i) Cka është Ekonomia e Njohurive dhe cilat janë forcat shtytëse? ii) Cili është roli i qyteteve në Ekonominë e Njohurive dhe cka e determinon suksesin e tyre? Iii) Cili është roli i diversitetit dhe të kulturës së qytetit në Zhvillimit të Bazuar në Njohuri? dhe iv) Cila është rëndësia e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri për qytete, cilat janë implikimet në politika urbane dhe në planifikim hapsinor.

Fillimisht mund të thuhet se Ekonomia e Njohurive njihet dhe si Zhvillim i bazuar në Njohuri, kur flitet për zhvillime të qyteteve. Janë shumë pikëvështrime lidhur me atë se cka është Zhvillimi I Bazuar në Njohuri. Disa e përshkruajnë si ekonomi ku njohuritë janë më me rëndësi dhe kanë rol predominant në krijimin e pasurisë dhe mirëqenies ekonomike e sociale, të karakterizuar me pohimin e njohurive si burim të konkurrencës, me rol të madh të shkencës, hulumtimeve, teknologjisë dhe inovacioneve me vlerë të bazuar në ide të reja, softëare, shërbime.

Sipas Van den Berg, 2004, njohuritë dhe informacionet janë kryesoret për qytete me synim të zhvillimit të bazuar në njohuri. Nuk ekziston një mënyrë e vetme për qytetet të cilat synojnë këtë lloj zhvillimi, përderisa shumë qytete me m

ënyrën e tyre tradicionale, kulturën dhe historinë arritën në mënyra të ndryshme.

Sipas Skyrme, 2004 janë tri forca shtytëse: a) Globalizimi aty ku shumë kompani vendosen në vende tjera për prodhim përderisa qendrat e tyre janë në distancë tjetër; b) Informata/Intensiteti i



Njohurive dhe ku prodhimi bazohet në informatë - aty ku punëtorët përdorin më shumë kokat e tyre se duart e tyre; c) Rrjetëzimi dhe Lidhmëria është shumë e rëndësishme, aty ku zhvillimi varet shumë prej internetit i cili sjell "fshatin global" dhe më afër.

Qytetet janë fokus kryesor në Zhvillim të Bazuar në Njohuri, për shkak se kryesisht në qytete prodhohet njohuria e cila pastaj procesohet, shkëmbehet dhe shitet. Qytetet janë më së miri të furnizuara me infrastrukturë të njohurive (universitete, institucione tjera arsimore, shkencore, hulumtuese dhe zhvillimore etj.). Qytetet kanë numër më të madh të njerëzve të arsimuar "Klasë kreative" (Florida, 2002) apo "analistë simbolikë" (Van den Berg et al., 2004).

Në këto qytete punëtorët janë më së miri të furnizuar me infrastrukturë elektronike, të lidhur mirë me ekonominë globale përmes aeroporteve, si vende ku njohuritë shkëmbehen. Krijimi i njohurive të reja kryesisht zë vend në qytete me bazë të fortë të njohurive.

Ekonomia Urbane e Njohurive bazohet në njerëz të talentuar të cilët krijojnë njohuri dhe ide të reja, përderisa klasa kreative konsiston në njerëzit "kreativë", përfshirë muzicentët, artistët, shkencëtarët, mësuesit, dhe të profesioneve tjera.

#### **ROLI I DIVERSITETIT DHE KULTURËS SË QYTETEVE – METROPOLITANE DREJT ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI**

---

Kultura e qyteteve ndaraz nga ekonomia e qytetit, kontribon në ditët e sotme në joshje më të madhe dhe konkurentshmëri për qytetin. Puna kulturore ka një rol më të madh ekonomik se që mund të kenë parasysh punëtorët e kulturës. Sa i përket shkëmbimit të ideve në ditët e sotme, ajo e cila ndodh është nëpër muzeume, butiqe, restorante dhe vende tjera të specializuara për të krijuar vende për shkëmbimin e ideve në të cilat bazohen shumë biznese (Zukin, 1995). Sipas përvojës ndërkombëtare të qyteteve të njohurive, sa më shumë llojllojshmëri në vetë qytetin, aq më atraktiv është vetë qyteti.

#### **RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË BAZUAR NË NJOHURI PËR QYTETET METROPOLITANE IMPLIKIMET NË POLITIKA DHE PLANIFIKIM**

---

Zhvillimi i bazuar në Njohuri është relevant për çdo qytet në botë. Politikat të cilat inkurajojnë zhvillimin e tillë, do të ndihmojnë nëse për asgjë tjetër, sikurse është rritja ekonomike, për të përmirësuar kushtet e jetës dhe punës së qytetarëve, (Knight, 1994).

Në promovimin e ZHBNJ duhet të potencohet se ekziston një ndërvarshmëri ndërmjet veprimeve locale, regjionale dhe nacionale. Në të njëjtën kohë, politikat e qyteteve duhet të merren me përmirësimet kualitative të Mjedisit urban si pikë fillestare drejt ZHBNJ të qytetit.

Regjionet e suksesshme kanë qytete të suksesshme në zemër të tyre. (Dahlman, 2004), përderisa zhvillimi urban i qëndrueshëm kërkon qasje strategjike, me focus në aspekt social, ekonomik dhe mjedisor të bazuar në qeverisje dhe menaxhim të mirë urban.

Metodat e reja të planifikimit strategjik urban, marin në konsideratë mendimin e njerëzve, të rejtat dhe idetë e shprehura lirshëm dhe në mënyrë kreative, duke mundësuar rezultate të suksesshme.




Fig. 27. Themelet dhe aktivitetet e Ekonomisë së Njohurive (Van den Berg et al, 2004)

Karakteristikat e qytetit me Zhvillim të Bazuar në Njohuri janë: i) Themelet e zhvillimit të bazuar në njohuri dhe ii) Aktivitetet e Zhvillimit të bazuar në njohuri.

Sipas Van den Berg et al., 2004, shtatë kritere të ashtuquajtura “gurët:”, janë të nevojshëm që të jenë të përmbushura për themelet e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

**Baza e Njohurive** - Guri i parë për ZHBNJ është baza e njohurive, me të cilën nënkuptojmë; cilësinë, sasinë, diversitetin e universiteteve dhe të institucioneve tjera për hulumtim dhe zhvillim. Qyteti mund të ketë bazë të njohurive, ku prezenca e Klasës Kreative (artizanale, dizajn, muzikë, teatro, film, etj) mundësojnë për të qenë i llojllojshëm dhe atraktiv, për qytetarët dhe vizitorët.

- *Shkencë dhe teknologji (përfshirë Universitetet publike dhe private);*
- *Ndërmarrësitë, bankat, sigurimet;*
- *Industritë dhe prodhim të metodës “Të dish – Si”;*
- *Administratë dhe diplomaci (nacionale dhe internacionale);*
- *Art dhe kulturë.*

Tab.8. Ndarja e Njohurive (Knight, 1994)

**Baza ekonomike** – Gurri i dytë është baza ekonomike. Nënkupton krijimin e pasurisë për qytetin, kryesisht të bazuar në përparësi konkurruese. Qytetet me ekonomi të llojllojshme janë më pak të varura nga kushtet e ndryshueshme ekonomike, mund të jenë vende inkubatori për zhvillime të reja dhe inovacione ekonomike. Konkurenca e qytetit mund të matet me indikatorët si BPV për kokë banori, prodhimi apo dhe shkallë të papunësisë. Këta indikatorë janë shumë të dobishëm për të përshkruar performancën e qytetit në raport me regjionin.

**Kualiteti i jetës** – Është determinantë kryesore për të joshur dhe mbajtur punëtorët e njohurisë, Klasën Kreative në qytete me Zhvillim të Bazuar në Njohuri. Në këtë kuptim është shumë me rëndësi mjedisi i ndërtuar, objektet e cilësisë së lartë të banimit; parqet atraktive të qytetit, mjedisi i hapur i lirë rrethues, sikurse dhe institucionet e shumta kulturore. Për më shumë, duhet të ekzistojnë objekte cilësore publike si spitale dhe shkolla të shumta (vendore dhe ndërkombëtare). Për të siguruar kualitet të lartë të jetës, sistemet e trafikut –sikurse janë autostradat dhe aeroportet – nuk guxojnë të prodhojnë ndotje (ajrit, zhurmës, etj).

**Qasshmëria** – Bazuar në faktin se Zhvillimi i Bazuar në Njohuri është ekonomi e rrjetëzimeve, ndërlidhjet e mira ndërkombëtare, regjionale dhe qasja multinodale është shumë me rëndësi për qytete të njohurive. Ato do të duhej të kenë qasje të mirë dhe të shpejtë në aeroporte ndërkombëtare dhe Trena të shpejtë- HST, porse dhe lidhje të mira me qendrat tjera urbane të njohurive (në vecanti përmes rrugës dhe trenit),

Natyrisht, qytetet e njohurive kanë infrastrukturë elektronike për komunikim të shpejtë dhe të sigurtë.

**Diversiteti Urban** – Diversiteti Urban paraqet qytetin e llojllojshëm, si njërin ndër determinantët apo celësat kyq për REGJION URBAN METROPOLITAN të suksesshëm në aspekt socio - ekonomik, porse në anën tjetër burim të problemeve dhe tensioneve të grupeve të ndryshme të banorëve. Vendet janë të cmuara për autenticitetin, përderisa autenticiteti vie nga trashëgimia historike – arkitekturore, organizimi i lagjeve, skenave unike të muzikës apo dhe attributeve tjera kulturore. Bazohet në organizimin urban dhe strukturor të vetë qytetit përkrah objekteve të renovuara, koekzistencës së të resë përbri asaj historike dhe të trashëguar e të vjetër në aspekt të ndërtimit, karaktereve të shumta e të llojllojshme afatgjate të mahallave, modeleve dhe frymës e cila ekziston për më tepër.

Një vend autentik ofron përvoja unike dhe origjinale. Për më tepër, një vend me mega dyqane zingjirore, restoraneshe dhe klubeve të natës nuk është autentike. Qytetet e mëdha tentojnë të jenë

më të larmishme; ka një korespondencë të dobët ndërmjet specifikacionit të qytetit si identitet dhe madhësisë së qytetit. Rritjet urbane kryesisht varen nga specializimi I qyteteve, llojllojshmëria apo diversiteti sikurse dhe lokacioni, përderisa shumë nga inovacionet zënë vend kryesisht në qytete me diversitet. (Florida, 2002; Duranton et al, Puga, 1999)

**Shkalla urbane** – Aktivitetet intensive të njohurive zënë vend në vecanti në qytete të mesme dhe të mëdha. Qytetet e mëdha kanë tregje më të mëdha për shërbime të specializuara dhe është një vendgrumbullim i Klasës Kreative. Qytetet e mëdha kanë infrastrukturë të transportit ndërkombëtar dhe të cilët ofrojnë subkultura ndërkombëtare në të gjitha hapësirat ndërkombëtare multifunkionale. (Van den Berg, 2006)

**Barazia sociale** – Synimet për rritjen urbane të qëndrueshme është e rëndësishme për redukimin e varfërisë dhe pabarazisë. Kjo konsiderohet si parakusht fundamental për qytete të njohurive, për të prevenuar tensionet ndërmjet grupeve që “kanë” dhe “nuk kanë”.(Van den Berg, 2006).

Shumë nga aktivitetet e njohurive të përshkruar si më poshtë, duhet të zhvillohen në qytete të njohurive:

**Joshja dhe mbajtja e punëtorëve të njohurive** – Është e rëndësishme për të joshur dhe mbajtur “Klasën Kreative” apo punëtorët e njohurive të cilët me kreativitetin e tyre kontribuojnë në pasurimin e qytetit, bazës ekonomike, porse në të njëjtën kohë kërkesat e tyre janë më të mëdha përherë e më shumë për kualitet më të madh të jetesës dhe barazisë sociale. ”.(Van den Berg, 2006).

**Krijimi i njohurive të reja** – Baza më e rëndësishme për krijim të njohurive të reja është baza e njohurive. Sa më e mirë që është infrastruktura institucionale për prodhim, procesim dhe shkëmbim të njohurive, aq më i suksesshëm është aktiviteti për të krijuar njohuri. ”.(Van den Berg, 2006).

**Aplikimi i njohurive të reja dhe kombinimet e reja** – Faktorë të rëndësishëm janë baza e njohurive dhe baza ekonomike, përderisa përkthimi I njohurive në biznes është shumë me rëndësi, i cili kërkon rrjete të mira, në mes të institucioneve të njohurive dhe komunitetit të biznesit. ”.(Van den Berg, 2006).

### III.II. TEORIA E KAPACITETEVE ORGANIZATIVE

Sipas Van den Berg et al, 2004, krijimi i kapaciteteve organizative mund të konsiderohet si instrument strategjik për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm drejt zhvillimit të bazuar në njohuri, përmes zhvillimeve dhe bashkëpunimeve të ngushta regjionale.

Kapacitetet organizative janë të definuara si aftësi për të listuar tërë akterët e involvuar dhe të cilat ndihmojnë në zhvillimin e politikave, krijimit të kushteve për rrieje ekonomike të qëndrueshme. Kapacitetet organizative i referohen procesit të tërësishëm të identifikimit të nevojave specifike, përmes zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive dhe politikave.

Komponentat kryesore për kapacitetet organizative janë: Vizioni, rrjetat strategjike, lidershipi, mbështetja politike, ndikimi social dhe komunikimi.




Fig. 28. Korniza teorike e Kapaciteteve organizative (Van den Berg 1997)

Kapacitetet organizative fillojnë prej kornizës formale institucionale të qeverive lokale dhe dëshirës së tyre për bashkëpunim si parakusht të performancës së një regjioni të urbanizuar.

**Lidershipi** – Ka të bëjë me kompetenca formale dhe praktike, suksesi i të cilit garanton dhe ndihmon zbatimin e marëveshjes apo projektit.

**Mbështetja politike** – Ka të bëjë me mbështetjen e vendimmarrësve për aprovim, zbatim të projekteve zhvillimore, dokumenteve strategjike zhvillimore. (Van den Dool, 2004)

**Mbështetja sociale** – Ka të bëjë me mbështetjen e shoqërisë në marrjen e vendimit për zhvillime të reja, në këtë rast në ZHBNJ është me rëndësi. (Van den Dool, 2004)

**Vizioni dhe strategjia** – Ka të bëjë me ekzistencën fizike dhe ideologjike të dokumenteve strategjike, politika, zhvillime dhe objektiva të tyre. (Van den Dool, 2004)

**Partneriteti publik-privat** – Ka të bëjë me mënyrat e mobilizimit të resurseve publike dhe private në partneritet. Sfida kyqe për menaxhim urban është mobilizimi i këtyre resurseve dhe komunitetin e biznesit në mënyra të reja. (Van den Dool, 2004)

### III.III. ZHVILLIMI I QYTETEVE –REGJIONE DHE KOHEZIONI TERITORIAL

---

Qytetet janë me cilësi unike kulturore dhe arkitektonike, të përfshirjes sociale dhe me mundësi për zhvillim ekonomik. Ato janë qendra të njohurive dhe burimeve të rritjes dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë, qytetet kanë probleme demografike, pabarazisë sociale, mungesës së strehimit të përshtatshëm e të përballueshëm, problemeve mjedisore.

Qytetet në konceptet e Bashkimit Evropian janë shumë të rëndësishëm për të definuar politikat zhvillimore, kohezionin territorial, kontrollin sikurse dhe parashikimet për zhvillimet e mëvonshme.

Deri para pak kohe, nuk ekzistonte një definicion i harmonizuar për “Qytet” nga BE sikurse dhe nga OECD – Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik. Kjo, për shkaqe të analizave krahasuese në mes të qyteteve, përderisa definicioni për qytet dhe zonën e saj migruese është zhvilluar në vitin 2011 nga OECD dhe BE.

Sipas definicionit të OECD-BE, janë identifikuar 828 qytete me qendër urbane me së paku 50.000 banorë, (OECD 2012). Gjysma e këtyre qyteteve janë relativisht të vogla (ndërmjet 50.000 – 100000 banorë), përderisa vetëm Londra dhe Parisi konsiderohen qytete globale dhe që akomodojnë 40% të popullatës së BE-së.

Cdo qytet është pjesë e zonës së migrimit të vet apo zonë migruese policentrike duke mbuluar më shumë qytete. Këto zona me zonat migruese së bashku akomodojnë së bashku (Zonat më të mëdha Urbane) 60% të popullatës së BE-së. Që nga viti 1986, qëllimi I politikave për kohezion territorial ishte për të forcuar kohezionin social dhe ekonomik.

Traktati I Lisbonës dhe Strategjia e lartë e BE-së (Europe 2020), na flasin për një dimension të ri të tretë: kohezionin territorial<sup>22</sup>. Kjo temë është diskutuar që nga vitet e hershme të '90-ta sikurse me cdo shtet që inkuadrohej në BE, territori i të cilave ishte i ndjeshëm ndaj zhvillimeve të reja në BE, përderisa zhvillimet brenda një territori të caktuar të një qyteti.

Në politikat regjionale të Bashkimit Evropian, të përmbledhura në dokumentin strategjik ( [Europe 2020 strategy](#)) kemi këto qëllime kryesore për qytete – regjione për vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet që tentojnë adherimin në BE:

---

<sup>22</sup> [http://ec.europa.eu/regional\\_policy/ehat/cohesion/index\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/regional_policy/ehat/cohesion/index_en.cfm)

- *Menaxhim të koncentrimit*– Të popullsisë dhe të zhvillimeve, marrë parasysh nevojën për shtim të inovacioneve dhe të prodhimit nëpër qytete, me primesa të demonstrimit të menaxhimit të ndotjes dhe ndasive sociale.
- *Territore më mirë të lidhura* – Njerëzit do të duhej të jenë të aftë dhe të lirë të jetojnë ku të duan, me qasje në shërbime publike, transport efikas, rrjetë të besueshme energjetike dhe internet përgjatë gjithë territorit;
- *Zhvillim të bashkëpunimit* – Efekti i ndryshimeve klimatike dhe sfidave të trafikut nuk ndalojnë në kufij administrativ, për këtë arsye format e reja të bashkëpunimit janë të nevojshme ndërmjet qyteteve, regjioneve e shteteve.
- *Mbështetje për ndërlidhjen urbano rurale* – Sipas “Letrës së Gjelbërt për kohezion territorial” (2008), kohezioni territorial do të jetë pjesë integrale e politikave të kohezionit prej vitit 2013. Me këtë vihet në pyetje nëse politikat e kohezionit të BE-së do të përmirësojnë kohezionin territorial në të ardhmen, me promovimin e qasjes funksionale për një zhvillim të integruar të territoreve të hapësirave ku njerëzit jetojnë, përmes mbështetjes dhe koordinimit të politikave ndërsektorale në nivele të ndryshme të qeverisjes duke nisur nga ato lokale e deri tek ato ndërshtetërore.

Në përgjithësi, politikat për kohezion territorial, të reformuara për periudhën kohore prej 2014 – 2020, do të jenë afrom 370 mld euro, për të investuar në regjionet evropjane, qytetet dhe ekonominë reale. Do të jetë ky një mjet investimi i BE-së për të arritur qëllimet e BE-së: krijimin e vendeve të punës, mbështetur ndryshimet klimatike dhe varshmërinë energjetike, redukimin e varfërisë dhe ndasitë sociale.

## **KAPTINA IV. QËLLIMI, HIPOTEZAT DHE PYETJET E HULUMTIMIT**

---

Në këtë kaptinë do të paraqitet arësyeshmëria dhe bazueshmëria e hulumtimit objektivat, pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe metodologjia e punës, korniza teorike për këtë hulumtim. Kjo kaptinë përbëhet prej katër seksioneve.

### **IV.I. QËLLIMI I STUDIMIT**

---

Qëllimi i këtij studimi është definimi i potencialeve zhvillimore të qytetit të Prishtinës drejt të qenit metropolë – regjion urban metropolitan I Prishtinës me Zhvillim të Bazuar në Njohuri. Me këtë rast të studimit tentohet të analizohen potenciale ekzistuese dhe ato të projektuara që dalin nga dokumentet strategjike kombëtare dhe ato komunale e urbane të qytetit të Prishtinës, porse dhe të komunave fqinje në rast të një funksionimi të tillë të qytetit metropolë të Prishtinës - Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës.

Studimi i potencialeve të mundshme drejt një qëllimi të tillë të synuar të rastit të studimit të qytetit të Prishtinës, do bëhet përmes një metodologjie pune e cila analizon, teston, definon, konkludon dhe rekomandon masat dhe veprimet sikurse dhe strategjinë drejt zhvillimit të tillë urban.

Për më tepër, do të identifikohen sfidat dhe kushtet për tu përmbushur, promovuar bashkëpunimi ndërkufitar me qytete të tjera; përpilohet një pasqyrë e bashkëpunimeve/partneriteteve dhe listuar rekomandimet.

### **IV.II. HIPOTEZA DHE PYETJET E HULUMTIMIT**

---

Bazuar në analizën e kontekstit të qytetit të Prishtinës – nga perspektiva e të qenit qytet - metropolitan me parametra të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, si nevojë të kohës dhe trendit të zhvillimeve urbane të qyteteve të suksesshme evropjane dhe më gjërë, do dalim tek konstatimet për hipoteza dhe pyetje të pyetje të hulumtimit. Kjo për më shumë në detaje bazohet në: i) Potenciale ekzistuese, resurse kryesore infrastrukturore jashtë komunës; ii) Potenciale të ardhshme, të projektuara e të planifikuara të qytetit të Prishtinës; iii) Trendeve aktuale lokale të migrimit ditor të popullatës nga regjioni i Prishtinës sipas statistikave të fundit të vitit 2011 dhe së fundmi iv) Trendit evropjan sipas nomenklaturës zyrtare të Eurostat për definim të Regjioneve Urbane Metropolitane. Hipotezat dhe pyetjet e hulumtimit janë si vijojnë:

1. *Qyteti i Prishtinës nuk është dhe nuk do të mund të jetë metropolitane - drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, pa bashkëpunim të ngushtë urbano – rural brenda komunë së saj porse*



dhe me komunat fqinje përreth. Kjo bazuar në pozitën dhe potencialet e saj ekzistuese, trendin e migrimit ditor të punës nga regjion dhe trendit të zhvillimit urban në botë. Zhvillimi i saj fizik aktual monocentrik me primesa të zhvillimeve korridorale përgjatë rrugëve kryesore nacionale, me mospërfshirjen e gjërë të fshatrave të komunës në zhvillim të tërësishëm urban, porse dhe të komunave fqinje nuk është i favorshëm për zhvillim kompakt metropolitan drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

***Pyetja 1 - A do të mund qyteti i Prishtinës me trendin e saj zhvillimor aktual, pa përfshirjen dhe bashkëpunim e ngushtë të fshatrave dhe komunave përreth të përmbushë kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri?***

***2. Qyteti i Prishtinës në rast organizimi dhe funksionimi si Regjion Urban Metropolitan, mund të përmbushë kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Zhvillimi i saj si regjion urban në bashkëpunim me komunat fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Podujevë), do sjell sinergji reciproke, regjionit dhe qytetit të Prishtinës, regjionit më të gjërë, duke e bërë regjionin dhe jo vetëm Prishtinën, konkurente në aspekt global, rekomandim ky sipas dokumentit strategjik të Planifikimit hapsinor kombëtar të Kosovës dhe OECD – Organizatës Evropjane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, për definim regjionesh urbane.***

***Pyetja 2 - A do të mund qyteti i Prishtinës – si Regjion Urban Metropolitan sipas pritjeve zhvillimore për të, Planifikimit Hapsinor Kombëtar të Kosovës dhe sipas nomenklaturës së OECD të përmbush kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri? Cilat do të mund të ishin format dhe potencialet e bashkëpunimit regional, lokal dhe ndërkuftar (qëllimi i të cilave është promovimi i zhvillimit të bazuar në njohuri)?***

#### IV.III. QASJA DHE METODOLOGJIA

Studimi është kualitativ dhe përshkrues, i bazuar në të dhëna kualitative parësore dhe dytësore. Analizat e tilla rezultojnë në përshkrime kualitative porse që pastaj kuantifikohen dhe krahasohen, për të ardhur deri tek rezultatet, konkluzionet, rekomandimet e sugjerimet. Teoritë që do të përdoren janë: Teoria e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Teoria e Kapaciteteve Organizative. Konteksti i analizuar i Prishtinës do të jetë sipas: Pozitës, trendeve më të reja zhvillimore, pritjeve sipas dokumenteve strategjike dhe trendeve ndërkombëtare, të cilat do të rezultojnë me hipotezë dhe pyetje të hulumtimit, përdëerisa analizat e mëtutjeshme do të jenë sipas kornizës teorike.

*Pjesa e parë e analizave të kontekstit të studimit: Trajtimi i qytetit të Prishtinës në kontekst të: 1) Pozitës gjeografike të qytetit të Prishtinës; rolit historik dhe politik; Shtrirjes së resurseve kapitale infrastrukurore (Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës, HK-Stationit Qendror të Hekurudhave të Kosovës) në komunë dhe në zonë- komunat fqinje;*

*II)Pritjeve për zhvillim të saj urban e hapsinor si qytet global e konkurent sipas dokumentit strategjik hapsinor kombëtar të Kosovës – PHK 2010 – 2025+;*

*III)Trendeve aktuale të migrimit ditor të punëtorëve në qytet dhe rritjes së popullatës së Prishtinës gjatë ditës për 35%;*

*IV)Definimit sipas OECD të Regjionit Urban Metropolitan, nomenklaturës dhe trendeve aktuale në Evropë dhe botë, përdërisa*

*Pjesa e dytë e analizave I bëhet\_ vlerësimit të skenarëve zhvillimorë të qytetit të Prishtinës:*

*I)Skenarit të zhvillimit urban monocentrik –sipas trendeve aktuale zhvillimore në qytet;*

*II)Skenarit të zhvillimit urban policentrik të planifikuar sipas planeve zhvillimore të Prishtinës, Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban në kontekst të përmbushjes së kritereve të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe*

*III)Skenarit të zhvillimit të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës me komuna fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë).*

Me sintezën e analizave do të përmbliidhen rezultatet, në kuptim të definimit të konkluzioneve dhe të rekomandimeve për politika urbane dhe përmbushje masash e veprimesh të planifikimit hapsinor, për të mundësuar shkallën e nevojshme të Zhvillimit të bazuar në Njohuri të RUM të Prishtinës.

*Burimi I të dhënave* – Të dhënat janë teorike dhe empirike. Të dhënat teorike të përdora gjatë këtij studimi janë të dhënat në kuptim të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri të qyteteve të suksesshme në Evropë, parametrave të plotësuar dhe përvojave të tyre zhvillimore; Forcat shtytëse dhe faktorët zhvillimorë dhe proceset të cilat do të duhej të adresohen nga qytetet, politikave urbane për zhvillim të qyteteve.

Të dhënat empirike të studimit janë: i) Të dhënat për gjendjen ekzistuese dhe potenciale të Prishtinës dhe të qyteteve fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë). të RUM të Prishtinës; ii) Strategjive zhvillimore, objektive të parapara drejt ZHBNJ të qyteteve përkatëse të RUM të Prishtinës;

Në skemën e mëposhtme paraqitet korniza analitike e studimit, sipas hapave:




Fig. 29. Korniza analitike e studimit

## **KAPTINA V. VLERËSIM I SKENARËVE POTENCIAL TË ZHVILLIMEVE URBANE TË PRISHTINËS**

---

Në këtë kaptinë do të elaborohen dhe vlerësohen tre skenarët kryesorë të zhvillimit hapësinor e urban të qytetit të Prishtinës: Skenari i parë - i)Qyteti i Prishtinës me zhvillim urban monocentrik; Skenari i dytë ii)Qyteti i Prishtinës me zhvillim policentrik dhe Skenari i tretë iii)Qyteti i Prishtinës – me zhvillim si RUM-Regjion Urban Metropolitan së bashku me katër komunat e tjera fqinje.

Këta tre skenarë do të analizohen në mënyrë kualitative, do të krahasohen mëpastaj të paraqitura dhe shprehura në mënyrë kuantitative, për të ardhur deri tek vlerësimi krahasues i tyre sipas kriterëve të teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative.

Analiza do të përfundojë me listën e kriterëve të dala nga krahasimi i tri skenarëve, për të parë, justifikuar dhe gjetur nëse kriteret përmbushin në njërin apo skenarin tjetër qenësoret për një qytet funksional – konkurent metropolitan drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

Kjo analizë dhe vlerësim krahasues do të bëhet bazuar në kornizën teorike të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative, kriteret e të cilëve do të vlerësohen në mënyrë kualitative dhe pasqyruar mëpastaj në mënyrë kuantitative.

Kaptina do të ketë tri seksione të analizave dhe përfundimin e kaptinës së pestë.

### **V.I. – SKENARI I. - PRISHTINA - ME ZHVILLIM URBAN MONOCENTRIK**

Skenari I. - sipas së cilit qyteti I Prishtinës do të zhvillohej me zonat e saja të funksioneve të ndryshme, në mënyrë gravituese rreth qendrës së qytetit – bërthamës së saj, do të paraqiste skenarin e zhvillimit monocentrik, siq ishte rasti me zhvillimin e shumë qyteteve në Ballkan deri në shek. XX e posaqërisht me qytetet balkanike, unike, me traditë, imazh specifik, të qasshëm nga cdo cep dhe në këmbë.

Zgjërimi i qytetit të Prishtinës, sikurse dhe i cdo qyteti tjetër monocentrik është sfidë në vete, apo zhvillimet e reja me këtë rast do të ishin të matshme nga qendra e saj, porse duke mos racionalizuar apo shpërndarë funksionet e tërësishtme administrative dhe komerciale apo dhe funksionet e tjera arsimore e shkencore nëpër pjesët e tjera të qytetit.

Ky zhvillim monocentrik është duke ndodhur në realitet porse në mënyrë thuajse të pandjeshme meqë sipas planeve tentohet policentriciteti në Prishtinë.

Zhvillimi monocentrik i Prishtinës do i shkojë në favor ruajtjes së tokës bujqësore, porse poashtu në të njëjtën kohë është duke ndodhur ajo që konsiderohet pasojë e zhvillimit monocentrik, shpërndarja e banimit jashtë zonës urbane nga klasa me të ardhura më të larta, e cila sjell për pasojë uzurpimin e saj, shndërrimin e saj nga toka bujqësore në atë ndërtimore duke marrë parasysh kriterin e vetëm, atë të largësisë nga qendra e qytetit, faktor ky në favor të industrisë së ndërtimeve.

Funksionet e shumta të qytetit të Prishtinës që tani parashihen të disperzohen porse në realitet ndodh që trendet të mos ndiqen si relae, zhvillimet janë korridorale, si zhvillimi më i padëshiruar urban. Dendeësimi i qendrës sa vie e shtohet, porse duke mos e përcjellë dhe me infrastrukturë teknike të transportit dhe të shërbimeve, me cka ulet kualiteti i jetës.

Planifikimi për një poliëndër të re të Prishtinës, na mbete vetëm në plane dhe jo në realitet, apo dhe do jetë vetëm pjesë e banimit meqë varet nga partenri privat dhe jo nga investimet me mëdha teknike e infrasrukturore sociale. Një gjë e tillë në realitet është dhe duke ndodhur përderisa parashihet shpërndarja e funksioneve dhe në Prishtinën e Re.

Zhvillimi i qytetit të Prishtinës sipas parametrave të një qyteti monocentrik, do të ketë vështirësi dhe sfida zhvillimore sikurse fizike dhe ato të natyrës së infrastrukturës së transportit.

Qytetet monocentrike sipas (O'Sullivan, 2003) kanë i) Pikën qendrore të transportit (terminalin e trenit apo stacionin); ii) Distriktin Qendror të Biznesit (CBD).

Qendra e Qytetit – DQB. Sipas Kraus, 1990 në qytetet monocentrike cdo gjë vlerësohet në varshmëri nga distanca prej DQB- Distriktit Qendror të Biznesit të qytetit. Cmimi i parcelës për ndërtim qoftë për banim apo biznes, cmimit të huamarrjes apo qirave etj., është në varshmëri nga distanca prej qendrës së qytetit ku dhe zakonisht është DQB. Bizneset zakonisht janë të koncentruar DQB, përderisa ato biznese prodhuese tentojnë që të jenë sa më afër qendrave të komunikacionit -stacionit të trenit kryesisht, për shkakë cmimi në transport të mallrave.

Dallimi i zhvillimeve - Duke vazhduar sipas Kraus, 1990, në qytetet monocentrike dhe poashtu dhe sipas Muth (1969), mund të thuhet se në qytetet monocentrike, klasat me më pak të ardhura jetojnë shumë e më shumë në qendër të qytetit, përderisa, klasat me të ardhura më të larta, anojnë të jetojnë në paralagjet jashtë qytetit, sa më larg qendrës. Ndërtesat e banimit në të shumtën e rasteve tentojnë të rriten në lartësi në qendër të qytetit përderisa sa më larg saj, kemi ndërtesa më të ulëta banimi, kryesisht kemi shtëpi individuale.

Mbingarkesa në trafik – Komunikimi apo transporti në rast të qyteteve monocentrike, është i komplikuar në kuptim të lidhjeve ndërrbane apo dhe nevojave të migrimit ditor të punëtorëve, meqë cdo gjë është e koncentruar. (Solow (1972).

**Tab.30. Definicionet për qytetin monocentrik sipas autorëve të ndryshëm**

Qyteti i Prishtinës, fillimisht meqë nuk ka stacion hekurudhor brenda qytetit- qendrës së saj porse është në komunën tjetër për më shumë dhe atë është jashtë funksionit më se një dekadë nuk i ndihmon dhe e përkeqëson zhvillimin e saj të kompaktësuar. Kjo, detyron që bizneset prodhuese të shpërqëndrohen më tutje në drejtime të ndryshme nga qendra e Prishtinës, kryesisht në breze rrugore për shkak të transportit dhe për shkak të cmimeve të tokës dhe qirasë më të ulët.

Qendra e qytetit do të ketë tendenca dhe kërkesa për rritje të lartësisë së ndërtimit, me cka do të ketë dendësim të qendrës. Në të njëjtën kohë do të ketë tendenca që të iket nga qendra për shkaqe banimi nga klasa me të ardhura të larta e shoqërisë, duke u shpërndarë dhe ndërtuar në lagje monofunksionale të banimit jashtë zonës urbane, në zona të getoizuara në paralagjet e qytetit, me cka uzurpohet toka e punëshme dhe të shfrytëzohet në mënyrë joracionale, duke e shëndërruar atë në tokë ndërtimore.

Transporti i vetëm publik dhe i mundshëm është ai rrugor i motorizuar në rastin e Prishtinës, me cka humbet në kualitet të mjedisit urban e jetësor, kërcënim humbjeje të trashëgimisë kulturore e të imazhit historik në qendër të saj.

Në foton e mëposhtme shihen distriktet e qytetit të Prishtinës dhe qendra e saj urbane rreth së cilës determinohet zhvillimi i mundshëm i ardhshëm monocentrik. Me shigjeta paraqiten migrimet ditore të punëtorëve si sfida e ditës, përderisa trendi i punës dhe i gravitimit është në juglindje të zonës urbane në drejtim të Fushë Kosovës

Shihet se lidhjet rrugore ndërmjet fshatrave janë të limituara dhe ndonëse të gjitha rrugët apo dhe transporti bëhet përmes rrugëve magjistrale. Kjo, vështirëson dhe ngarkon rrugët si të tilla, i bën ato më të ngarkuar të pakalueshme, më të paqasshme për këmbësorin apo për investitorin potencial të cilët kërkojnë transport efikas, të mallrave apo dhe të komunikimit. . Ndonëse qyteti i Prishtinës nuk ka transport hekurudhor ende dhe pas një dekade e sa, kjo e përkeqëson dhe më shumë situatën e lëvizjes në qytet, rëndon komunikimin, limiton lëvizjen e lirë të qytetarve – këmbësorë në mënyrë të shpejtë brenda përbrenda qytetit apo dhe ndërmjet komunës/distrikteve të saj.

Sipas PZHK 2013 posaqërisht, parashihet qendra multinodale të jetë larg qendrës apo CBD – DQQ – Distrit qendror të qytetit të Prishtinës, me cka do të rëndojë dhe për më shumë trafikun brenda qendrës për të mbërrirë pikat kyqe të qytetit.




Fig.31. Paraqitja e qytetit të Prishtinës, qendrës dhe distrikteve të saj

Në vazhdim do të paraqitet tabela e vlerësimit të skenarit të parë sipas parametrave të Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative, të cilat do të vlerësohen dhe krahasohen në fund të kaptinës së analizave të skenarëve.

Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative	SKENARI I	
	Prishtina – me zhvillim urban MONOCENTRIK	
	Përshkrim i situatës në rast skenari 1	Vlerësimi
Baza e Njohurive	Kualiteti në fakultete dhe shkolla të larta do të kenë të njëjtin nivel, përpos së rritja e tyre është i limituar në aspekt hapsinor	(+)

<b>Baza ekonomike</b>	Zhvillimi ekonomik në rast të zhvillimit monocentrik do vuajë për shkak të lëvizshmërisë dhe jo konektivitetit infrastruktural ndërrurban apo dhe ndërshtetëror	<b>(-)</b>
<b>Kualiteti i jetes</b>	Kualiteti i jetës do të jetë më i limituar për shkak të dendësisë në process, hapësirave të lira të limituara për sport dhe rekreacion	<b>(+)</b>
<b>Qasshmeria</b>	Lidhjet dhe komunikimi intraurban do të jetë në rregull porse përderisa ai ndërrurban pa transport tjetër përpos atij rrugor është i vështirësuar dhe jo efikas	<b>(--)</b>
<b>Shkalla urbane</b>	Zhvillimi monocentrik nuk i shkon në favor aspektit të madhësisë së qytetit, të Prishtinës, shkallës urbane	<b>(--)</b>
<b>Barazia sociale</b>	Meqë nuk kemi korespondencë më të madhe me zonat rurale, nuk i shkon për favor barazisë sociale, meqë do të ekzistojnë disproporcione të cmimit të tregut të punës dhe të patundshmërive. Diversiteti kulturor	<b>(o)</b>
<b>Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”- Klasës kreative</b>	Klasa kreative kërkon për më shumë bazë ekonomike të lartë dhe kualitet të jetës, dhe këto të dyja nëse nuk qëndrojnë rëndojnë përmbushjen e këtij kriteri, sidomos me dendësimin e qytetit sit ë tillë, me cka humbet kualiteti i jetës.	<b>(+)</b>
<b>Krijimi i njohurive të reja; Zhvillimi i “grupimeve” të reja</b>	Njohuritë e reja janë të mundshme në një qytet monocentrik; Grupimet e reja janë të pamundshme në rast të jo zgjerimit të qytetit në format e tjera përpos atij monocentrik	<b>(+)</b>
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Monocentriciteti nuk është pjesë e vizionit të qytetit të Prishtinës, edhe pse flitet dhe parashihen objektivë për mbrojtjen e tokës, të hapësirës etj.	<b>(--)</b>
<b>Udhëheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udhëheqja dhe mbështetja politike është më se e paimformuar për avantazhet dhe disavantazhet e skenarit të tillë. Mbështetja shoqërore do të ishte shumë më e shprehur në rast të informimit të drejtë të vizionit dhe caqeve zhvillimore	<b>(0)</b>

--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor

**Tab.9. Tabela e vlerësimeve të skenarit I – Zhvillimi monocentrik aktual i Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO**

*Përfundime për Skenarin I – Zhvillimi monocentrik i Prishtinës*

*Zhvillimi urban dhe hapsinor monocentrike për Prishtinën është më se i dëshiruar. Kjo, për shkak të shumë arsyeve – historike, kulturore, lëvizshmërisë së mallrave dhe të njerëzve, ruajtjes së tokës së punueshme, ruajtjes apo shfrytëzimit më racional të hapësirës, natyrës. imazhit shekullor.*

*Ky lloj zhvillimi has në shumë sfida në kohën e sotme bashkëkohore, kur planifikohet dhe është nevoja që qyteti të zgjerohet, kohën kur ka kërkesa të përditshme për zgjerim dhe me të të lëvizjeve të shumta ndërmjet vendbanimeve.*



*Në rastin tonë Prishtina ka disavantazh, qasjen shumë të dobët ndërmjet fshatrave të cilat vetëm kanë drejtimin qytet – Prishtinë.*

*Nevoja e investitorëve dhe nevojat ekonomike të kohës, erës bashkëkohore sikurse dhe konkurrencës në tregun ndërkombëtar, na detyrojnë që të kemi opsione të lëvizjeve shumë të favorshme urbano – rurale dhe sidomos urbano-urbane, duke marrë parasysh se qytete janë gjeneratorë të të mirave ekonomike në botën e zhvilluar.*

*Sipas vlerësimit të bërë sipas parametrave të teorive të ZHBNJ dhe KO, na del se opcioni i zhvillimit monocentrik për qëllim aruitjeje të qytetit metropolitan të orientuar kah ZHBNJ, është në disfavor, përderisa pikat më të dobëta të dala nga ky vlerësim janë ato të :Qasshmërisë, Shkallës Urbane dhe të rrjetëzimeve të reja të grupuara të bizneseve të reja, rrjetëzimeve të reja.*

## V.II. – SKENARI II. PRISHTINA - ME ZHVILLIM URBAN POLICENTRIK

Në këtë pjesë do të analizohet skenari i dytë i zhvillimit hapsinor të Prishtinës, skenari i zhvillimit policentrik, në kuptim të përmbushjes së parametrave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, sipas: i)Planit Zhvillimor komunal të Prishtinës 2013 – 2022 dhe ii)Planit Zhvillimor Urban 2013 – 2025, që të dyja të adoptuara nga asambleja komunale e Prishtinës në gusht të vitit 2011.

Secila nga to do të elaborohet dhe vlerësohet vecmas, përderisa secili parametër do të përshkruhet në formën e gjetjeve, dhe në fund do të rezultojë analiza me tabelën e gjetjeve pjesore të skenarit për zhvillim policentrik drejt zhvillimit të bazuar në njohuri.

Fillimisht do të përshkruhen karakteristikat kryesore zhvillimore sipas të dyja planeve për të vazhduar me skanimin e përmbushjeve të objektivave, sipas parametrave të ZHBNJ dhe KO. Vlerësimet do të analizohen dhe përshkruhen, përdeërisa dhe do të kuantifikohen në shkallën prej: (--shumë të disfavorshme, - të disfavorshme, 0 - neutrale, + - të favorshme dhe ++shumë të favorshme), në kuptim të përmbushjes së parametrave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

Me të dyja planet, Prishtina do të ketë dy poliçendra, Prishtinën e re dhe Prishtinën e vjetër, dy njësi madhore të qytetit me mundësi zhvillimi për secilën nga to (PZHK, 2013). Funkcionet parashihen të shpërndahen si në kuptim të shërbimeve dhe infrastrukturës fizike, poashtu dhe me të tentohet të mbrohet në vazhdimësi parimi i dëndësimit dhe kompaktësimit të qytetit, në favor të ruajtjes së hapësirës apo dhe tokës bujqësore (PHK, 2011).

### V.II.I. SKENARI II - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2013 - 2022

Sipas Planit Zhvillimor komunal të Prishtinës, për të ardhmen është planifikuar bazuar në potencialet ekzistuese dhe ato të pashfrytëzuara, me të rinjtë si protagonistë të zhvillimit dhe të aktivitetëve socio – ekonomike të komunës së Prishtinës.

Është potencuar potenciali i diversitetit socio-ekonomik, kulturor, etnik dhe i gjeneratave të reja të Prishtinës, si faktor i cili duhet të përdoret si burim i inovacionit. Qyteti i Prishtinës në këtë rast, është parë si një vend i përshtatshëm për të gjithë - të moshuar dhe familjarë, vend tolerance dhe respekti.

Në dokumentin zhvillimor, objektivat e specifikuara nuk janë të matshme dhe janë për më shumë deklarative, porse si të tilla të shprehura, jo të mjaftueshme si hapa konkret apo plan veprimi!

Sipas PZHK 2013 "zhvillimi policentrik i qytetit të Prishtinës është i propozuar dhe do të bazohet në strukturën ekzistuese dhe shpërndarjen e vendbanimeve", përderisa për më shumë do të kemi migrim nga qendra më të mëdha të Kosovës si (Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj) për në Prishtinë.

Ky migrim, do të vazhdojë, përderisa zhvillimi i këtyre qendrave do të sigurojë ofrimin e mundësive për punësim dhe zhvillim, sikurse dhe ofrimin e shërbimeve publike efikase, përderisa banorët do të jenë të joshur më shumë në vendbanimet e tjera përpos Prishtinës, vendbanimeve të mesme (10.000 - 20.000 banorë) dhe atyre të vogla (nën 10,000 dhe fshatrat).

Përmes këtij koncepti do të ketë këto zhvillime:

- Krijim të dy qendrave të qytetit të Prishtinës, qendrën e vjetër dhe qendrën e re;
- Zhvillim të balancuar në mes të qendrës së vjetër dhe të re të Prishtinës;
- Vendbanime kompakte dhe funksionale;
- Administratë efikase dhe të decentralizuar;
- Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë;
- Mundësi zhvillimi të ekonomisë së dekoncentruar;
- Mbrojtje efikase të tokës bujqësore;
- Zhvillim kompakt dhe dendësim të ndërtimeve;
- Zvogëlim të distancave brenda vendbanimeve.

Sikurse me zhvillime aktuale dhe reale dhe ato të planifikuara, nuk është prioritet ndërlidhshmëria urbano- rurale ndërmjet vetë qyteti të Prishtinës, apo dhe ndërlidhshmëria urbano- urbane me qytetet e tjera, ndër çështjet kyqe të zhvillimit të qëndrueshëm të një qyteti.

Sikurse sipas PZHK dhe PZHU, ku paraqiten versionet apo modelet e zhvillimit policentrik të qytetit të Prishtinës, nuk kemi të parashikuara në kuptim policentriciteti lidhje të forta të lëvizjes apo të komunikimit ndërmjet vendbanimeve urbane dhe rurale, dhe atyre ndërmjet fshatrave si pika shumë të forta.

Në këtë kontekst që të dyja planet për zhvillimin e Prishtinës të bazuara në zhvillimin policentrik nuk e parashohin modelin policentrik të parë, (shih fig.x.) - versionin urbano-rural porse e kanë të adoptuar modelin policentrik – verzionin e lëvizjeve të rëndomta.



Fig.32. Modeli policentrik-verzioni urbano rural




Fig.33. Modeli policentrik-verzioni i lëvizjeve të rëndomta sipas Bertraud, 2001




Fig.34. Paraqitja e Prishtinës me dy poliçendra sipas PZHK 2013

Në figurën e mësipërme paraqitet skema e Prishtinës me dy poliçendra sipas PZHK 2013, porse në të njëjtën figurë paraqiten dhe trendet e zhvillimit sipas brezave të rrugëve magjistrale dhe nacionale. Lëvizjet urbano – rurale janë të dobëta.

Sipas skemave të mësipërme të paraqitjeve të dy llojeve të policentricitetit të qyteteve sipas Bertraud, 2001., sipas të planifikuarës është duke u zhvilluar si qytet policentrik me lëvizje të lira spontane dhe të rëndomta (shih fig.x.).

Baza ekonomike – Sipas Planit zhvillimor komunal, me skenar të zhvillimit policentrik, pretendohet dhe shprehen objektivat për një rritje ekonomike të qytetit, porse jo në funksion të policentricitetit me fshatrat përreth, regjionit të brendshëm komunal, përderisa poashtu dhe nuk kemi interaқcion në kuptim të bëashkërenditjes ekonomike me komunat fqinje, fakt ky shumë i disfavorshëm për zhvillimin në aspekt ekonomik të Prishtinës. Sipas Planit zhvillimor urba, kjo tendencë e policentricitetit urbano – rural është paksa më i theksuar dhe pozitiv porse përsëri jo e dukshme dhe e prekshme me modelin zhvillimor apo dhe projektet aktuale zhvillimore të ardhshme, infrastrukturore apo dhe ato funksionale.

Qyteti i Prishtinës synon me këtë dokument të ketë “Zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe rritje të punësimit, për një qytet tërheqës dhe kreativ”. Është paraparë vlerësimi i universitetit publik dhe institucioneve të tjera të arsimit për arsye të ndërlidhjeve me sektorin ekonomik, etj; parashihet krijimi i kushteve për të tërheqjen e kapitalit apo investimeve të huaja, themelimi i parqeve të biznesit dhe zonave industriale, hub-eve logjistike; zhvillimin e projekteve të mëdha të investimit nëpërmjet partneriteteve publike-private; “Vlerësimin e trashëgimisë historike dhe promovimit dhe zhvillimit të formave të ndryshme të turizmit kulturor, arkeologjik, turizmit të gjelbër.

Bazat e Njohurive –Sipas strategjisë parashihet vlerësimi i universitetit publik dhe institucioneve të tjera të edukimit publik dhe privat, për t’u ulur distanca në mes trajnimeve profesionale dhe tregut të punës. Parashihet ofrimi i edukimit cilësor dhe gjithë përfshirës, përmes krijimit të një rrjeti të shkollave që i përmbushin nevojat e qytetarëve me qasje të duhur dhe objekte të përshtatshme: laboratorë, salla sporti, rrjet kompjuterik dhe internet, zgjerimit të rrjetit të institucioneve parashkollore dhe shkollave në zonat rurale”.

*Nuk shihet intervenim afatgjatë në ngritjen e cilësisë së arsimit, bazës së njohurive.*


Kualiteti i jetës –Me dokumentin strategjik zhvillimor të komunës së Prishtinës, kemi të paraparë dendësinë banimore në zona urbane, 50 banesa ose 200 banorë / ha, përderisa në rrethinë kemi 8 banesa/ ha. Sa I përket planifikimit për pjesën e pushimit dhe rekreimit, thuhet se do të shkohet drejt : “Zhvillimit të një parku të madh natyror për rekreacion dhe aktivitete për argëtim” , përderisa do të bëhet: “Ruajtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i zonave të gjelbërta”, si faktor stabiliteti dhe qëndrueshmërie urbane. Kualiteti i jetës është ngushtë i lidhur me rritjen ekonomike të paraparë dhe të projektuar porse dhe bazuar në lidhjet dhe parashikimet e mundësitë për qasje të lehtë e të shpejtë. Parametri tjetër është dhe ai i kualitetit të mjedisit me c’rast nëse do kemi trafik të ngarkur rrugor, kjo do të jetë në disfavor të kualitetit jetësor.

Sipas të dyja planeve zhvillimore komunale dhe urbane për Prishtinën, synohet rritje e kualitetit të jetës si objektivë i shprehur, porse bazuar në projekte konkrete të listuara, projekte konkrete për realizim – përderisa në ndërkohë nuk sigurohet gjenerim ekonomik dhe nuk punohë për një qëllim të tillë madhor, nuk do të kemi ngritje substanciale të kualitetit të jetës. Nëse sipas PZHK të Prishtinës, stacioni multinodal i transportit gjendet jashtë qytetit në periferi të saj, kjo do e vështirësojë qasjen dhe me të do të ndikojë negativisht në kualitetin e jetës. Nëse nuk kemi rrjetë të shtrirë të ndërlidhjes urbano-rurale në kontekst të policentricitetit përpos dy poliqendrave të qytetit, kjo ndikon poashtu në mosngritje të kualitetit të jetës, në kuptim të ngarkesës së trafikut në pjesën urbane për të qasur ato rurale përmes saj.

*Nuk flitet për ndikimet klimatike, ndikimet apo ndotje të ajrit nga komunat e tjera, nuk flitet për ofueshmëri ekonomike tek politikat urbane të banimit, nuk flitet për politikat e banimit për studentë, këta si faktor për mirëqenie ekonomike, sociale e kulturore!*

Qasshmëria – Sipas PZHK, parashihet që Prishtina të jetë e lidhur në rrjetet botërore: “Lidhje me korridoret Europiane, duke pasur si qëllim lidhjen veçanërisht me korridoret V, VI, VIII, dhe X; ku: “Zhvillimi i rregullt dhe i besueshëm i linjave të transportit publik, duke përfshirë linja të reja të lehta të transportit hekurudhor dhe modernizimit të mjeteve të transportit publik; Ruajtja dhe forcimi i linjave hekurudhore (apo tramvajeve) me polaritete të ndryshme urbane (aeroporti, stacioni i autobuseve, qendra e qytetit, etj.). Zhvillimi i një rrjeti për shtigjet e biciklistëve, përmirësimin e sigurisë së këmbësorëve dhe rrugëve me pengesë të lirë; Organizimi i transportit të mallrave brenda qytetit”.

Sipas të dyja planeve zhvillimore, për Prishtinën, nuk shohim ndërlidhje të fuqishme urbane-rurale dhe ndërurbane me qendrat tjera. Poashtu nuk kemi prioritet të zhvillimit të transportit



hekurudhor, atij të lehtë publik, porse prioriteti është i zhvillimit të infrastrukturës rrugore kryesisht me primesa të pakta të zhvillimit në gjithë territorin të transportit të lehtë dhe atij të jomotorizuar. Kjo është në disfavor absolut me qëllimin madhor të krijimit të Regjionit Urban të Prishtinës, përderisa dhe të zhvillimit të bazuar në njohuri.

Fig.35. Përmirësimi i qasjes në Prishtinë, sipas PZHK

Disfavori kryesor shkon dhe në drejtim të mosqasjes direkte me ANP – Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe Stacionin Qendror Hekurrudhor e të cilat gjinden jashtë Prishtinës, porse për zonat e zhvillimit rreth tyre, Prishtina nuk merr pjesë – fakt ky i disfavorshëm për zhvillimin e synuar të Prishtinës –Regjion Urban.

*Për më shumë flitet për rrjete të nivelit qendror e regjional e të cilat nuk janë përgjegjësi direkte e komunës së Prishtinës, porse nuk flitet për rrjete regjionale vendore me komunat e tjera, objektiva për të qenë të kapshme dhe të matshme, flitet në mëyrë të përshkruar!. Lidhja ndërmjet komunave as edhe nuk përmendet fare!*

Diversiteti – Komuna/Qyteti i Prishtinës më parë ishte më i diversifikuar në krahasim me ditët e sotme, në kuptim të prezencës së komuniteteve tjera joshqiptare në të, porse pas luftës së vitit 1999, ky diversitet i atribuohet vetëm prezencës së përkohshme të komunitetit të ndërkombëtar, të institucioneve diplomatike etj.

*Platforma dhe politikat për një diversitet kulturor, në komunën e Prishtinës nuk ekziston dhe me këtë nuk promovohet, përderisa dihet se rekomandohet nga Këshilli i Evropës dhe nga përvojat e qyteteve të Zhvilluara me Bazë të Njohurive. Kultivimi dhe zhvillimi i kulturës së diversifikuar është një shtyllë e rëndësishme dhe bazë e zhvillimit ekonomik lokal, forcë shtytëse dhe faktor atraktiviteti për qytetin, regjionin dhe më gjërë.!<sup>23</sup>*

Shkalla urbane –Sipas dokumentit të strategjisë zhvillimore për komunën e Prishtinës, parashihet “Bashkëpunimi me komunat fqinje në kuadër të Hapësirës së kaltër zhvillimore – Portit të Kosovës.”, të bazuar dhe në dokumentin strategjik hapsinor të zhvillimit kombëtar. Ky bashkëpunim ndërkomunal i komunës së Prishtinës me komunat fqinje arësyetohet në resurse infrastrukturore jashtë komunës, porse në Zonën e saj të Gjërë Urbane (TZHEK, ANP, HK - Stacionit hekurudhor);

Me vetë mosndërlidhjen funksionale të fshatrave dhe të dy poliëndrave të ardhshme të Prishtinës, në kuptim të krijimit të një tërësie, do të kemi skenarin e një jokompaktësie urbane në tërë territorin, e që si rezultat nuk mund të flasim për një shkallë të lartë kompakte urbane. Nëse ky parametër nuk përmbushet ose përmbushet pjesërisht, nuk mund të flasim për avantazh apo favor në drejtim të plotësimit të kushtit drejt Zhvillimit Urban të qëndrueshëm bazuar në Njohuri.

<sup>23</sup> “Qyteti interkulturor ka për qëllim arritjen e identitetit pluralist, të bazuar në njohjen eksplicite të resurseve nga diversiteti të cilët zhvillojnë një sërë strukturash të qeverisjes, me adaptimin e politikave dhe veprimeve në cdo fushë relevante që ka nevojë një popullatë e diversifikuar”. [ëë.ec.europa.eu/public\\_opinion/flash/fl\\_217\\_sum\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/flash/fl_217_sum_en.pdf)

*Nuk përmendet kriteri i madhësisë si meritë për një qytet metropolitan, dhe i cili do të kontribonte në Zhvillim ekonomik.*

Barazia sociale – Sipas dokumentit të Planit Zhvillimor të Komunës së Prishtinës, planifikohet ”Ofrimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, me rritjen e kapaciteteve fizike, njerëzore e institucionale, rritjen e numrit të objekteve fizike shëndetësore të spitalit të qytetit dhe rritjen e shërbimeve shëndetësore”; Në Prishtinën e pasluftës, lagjet e tëra të reja janë të ndërtuara për klasën elitare politike<sup>24</sup>, të getoizuara me hyrje dalje të kontrolluara për qytetarë të tjerë.

Vetë dëshira e ndërtuesve e më pas dhe e blerësve potencial ishte që në një mënyrë të distancohen nga popullata e gjërë dhe krijojnë dallime të dukshme në aspekt hapsinor urban, porse dhe atë social. Kjo është dukuri e pasluftës e cila nuk ekzistonte më parë dhe të cilën qytetet e zhvilluara nuk e mbështesin.

Parametri i barazisë sociale është ngushtë i lidhur me rritjen e bazës ekonomike dhe të qasjes së lehtë dhe efikase, rritjes së bazës së njohurive, me c’rast mund të konkludojmë se do të ketë dhe më tej në rastin e analizuar të skenarit, pabarazi sociale, fakt ky i disfavorshëm për zhvillim të bazuar në njohuri.

*Në kuptim të përmbushjes së kriterit hapsinor për sigurim të barazisë sociale në kuadër të Komunës/– nuk flitet në dokument zhvillimor të Prishtinës.*

Aktivitetet e njohurive – Në qytetin e Prishtinës në kohën e fundit sipas statistikave na del se kemi më shumë institucione për kërkim dhe zhvillim (R&D), porse të cilat nuk kanë ndërlidhje të ngushtë dhe direkte me prodhimin aspo sektorin ekonomik të ndërmarrësisë apo dhe të ndërlidhjes së institucioneve të tillë hulumtuese me universitetet dhe me biznese! Në dokumentin strategjik zhvillimor të komunës së prishtinës, nuk njihen dhe si të qena, t aktivitetet kulturore si festivalet e shumta filmike, dokumentare, ato të prodhuesve të ndryshëm e shumëe shumë të tjera, të cilat janë aktovotete të njohurive, meritore për prurje të shumta të vizitorëve të shumtë në Prishtinë, porse dhe mëpastaj prurjeve të shumta në aspekt akomodimi e ushqimi, argëtimi, prurjeve nga trafiku, suvenirat dhe i gjithë zingjiri i përfitimeve ekonomike që sjell një vizitor në Prishtinë etj.

*Në dokumentin zhvillimor të komunës së Prishtinës, nuk potencohet nevoja për bashkërenditje në mes të institucioneve arsimore dhe atyre ekonomike e prodhuese, shkencës e teknologjisë. Për më tepër nuk pranohen si mënyrë dhe si aktivitete të njohurive i gjithë arsenalit i organizimeve të*

*shumta shkencore e kulturore, që zhvillohen tani e sa vite në Prishtinë dhe në qytetet tjera të Kosovës.*

*Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”-Klasës kreative* – Në rast të mosngritjes së kualitetit të jetës në Prishtinë, nuk do të kemi mundësi për mbajtjen e punëtorëve të njohurive në qytet dhe për më shumë të joshjes së klasës kreative që të synojë vendosjen në Prishtinë, përpos për kohë të shkurtër. Ky fakt është i disfavorshëm për synimin e Prishtinës – regjion urban drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

*Krijimi I njohurive te reja; Zhvillimi I “grupimeve” të reja* – Poashtu dhe me këtë parametër, në rast të mos ngritjes së bazës ekonomike dhe mosinterkacionit mes akademisë dhe prodhimit (e cila nuk është përmendur në asnjë nga planet zhvillimore) nuk do të kemi kusht të përmbushur drejt Zhvillimit të synuar të Bazuar në Njohuri të regjionit Urban të Prishtinës.

*Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike* – Parametri i vizionit dhe strategjisë adekuate për rrjetëzime funksionale drejt një organizimi të ri të formës së Regjionit Urban të Prishtinës mungon, kushti është i paplotësuar – papërmbushur.

*Udhëheqja /Mbështetja politike/ Mbështetja shoqërore* – Në dokumentin strategjik komunal për Prishtinën, flitet për zhvillimin institucional dhe organizativ, porse duke mos e parë si njërën ndër shtyllat shumë të rëndësishme të jetësimit të planit drejt zbatimit konkret të hapave. Përkrahja politike dhe sociale janë të rëndësishme madhore për ekzekutim të një vendimi.

Përderisa në dokumente strategjike zhvillimore për Prishtinën, nuk është e shprehur qartë, nevoja për rrjetëzime dhe forma të reja të organizimit funksional dhe institucional të Prishtinës për funksion më të gjërë të konkurrencës regjionale, i organizuar si Regjion Urban Metropolitan i Prishtinës, nuk mund të flasim për mbështetje politike, dhe shoqërore.

*Përkrahja politike dhe sociale nuk shihet si pjesë me rëndësi e zhvillimit institucional, të shumë aktiviteteve shkencore, kulturore e ekonomike. Mungon elaborimi i detajuar i zhvillimit institucional, formave të reja të organizimit apo ristrukturimit, mbështetjes politike, krijimit apo hartimit të politikave urbane për mbështetje sociale e politike.*

---

<sup>24</sup> Lagja Marigona, Fshati Amerikan, Lagja Nici etj



**Pwrfundime**

*Nuk flitet për rrjete regionale, me komunat e tjera, lidhja ndërmjet komunave as edhe nuk përmendet fare!*

*Platforma për diversitet kulturor, në komunën e Prishtinës nuk ekziston;*

*Nuk përmendet kriteri i madhësisë si merit për një qytet metropolitan, dhe i cili do të kontribonte në Zhvillim ekonomik.*


*Nuk përmendet përmbushja e kriterit për siguri të barazisë sociale;*

*Nuk potencohet nevoja për bashkërenditje në mes të institucioneve arsimore dhe atyre ekonomike e prodhuese, shkencës e teknologjisë;*

*Përkrahja politike dhe sociale nuk shihet si pjesë me rëndësi e zhvillimit institucional;*

**V.II.II. SKENARI II - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR URBAN 2013 - 2025**

Në vazhdim do të vlerësohen synimet dhe objektivat e zhvillimit urban të Prishtinës sipas PZHU 2013-2025, në kuptim të përmbushjes së parametrave për ZHBNJ, të cilat që në fund të këtij kapitulli do të përmbledhen në një tabelë vlerësimi, të shprehur në aspekt kualitativ. I gjithë zhvillimi për Prishtinën është parashikuar në synimet: Qytet/Regjion Urban Metropolitan, funksional dhe I integruar; Qytet I ekonomisë së njohurive; Qytet I kulturës, artit, historisë, diplomacisë; Qytet i gjelbërt; Qytet I administruar, me qeverisje të mirë dhe me bashkëpunime të shumta regionale.



*Baza Ekonomike* – Sipas PZHU 2013-2025 për qytetin e Prishtinës parashikohet mbështetja e institucioneve arsimore, edukative me qëllim të arritjes së cilësisë në edukim, shkencë, teknologji, inovacione dhe kombinime të shumta, për të rritur konkurrencën, krahasuar me qendrat tjera për rritjen e bazës ekonomike.

*Fig.36. Korniza e zhvillimit hapsinor të Prishtinës sipas PZHU*

Rekomandohet krijimi i fondit për mbështetje institucioneve edukative, ngritjen e cilësisë së shkollave të ulëta, të mesme sikurse që rekomandohet mbështetja në ofrimin e kushteve fizike për vendosje të studentëve për shkollim të lartë universitar në Prishtinë.

Sipas dokumentit të PZHU për Prishtinën 2013 – 2025, rekomandohet hartimi i dokumentit strategjik për marketing të qytetit të Prishtinës”, në kontekst të konkurimit me qytetet e regjionit.

Kjo për rolin dhe mundësitë e shumta për joshjen e vizitorëve, investitorëve etj. Në këtë kontekst parashikohet: i) Turizmi konferenciar /shkencor e kulturor, shëndetësor e bioznesor, me organizim të ngjarjeve të shumta shkencore, kulturore. Parashikohet rritje e të ardhurave për qytetin e Prishtinës, nga i tërë zingjiri i ofrimit të shërbimeve të tilla, organizimeve të ngjarjeve<sup>25</sup> etj.

Qyteti I Prishtinës, sikurse dhe qytetet në rajon dhe në botë, shërbimet shëndetësore i kombinojnë me turizëm të gjithmbarshëm kulturor e rekreativ dhe si i tillë mund të jetë shumë i favorshëm në aspekt ekonomik.




Fig.37 Ndarja zonale e hapësirës urbane e Prishtinës

Poashtu parashikohet turizmi i arteve aplikative, industrial dhe tregtar, rekreativ e sportiv, përderisa të mbështetur shumë në “Strategjinë e përgatitur për Marketing për qytetin e Prishtinës”. Sipas planit, më tej parashihet që qyteti të shiqohej si një ndërmarrje e cila duhet të shesë prodhimet e saja, përderisa në kuptim të qytetit shihet në kuptim të shërbimeve dhe funksioneve , të cilat i ka për mall. Tregtarët e shumtë për të cilët dhe qyteti i Prishtinës njihet që më parë I tregtonin mallrat dhe përmes marketingut të shumtë e të cilat më parë ishin të formave tjera.

<sup>25</sup> Psh. Diaspora gjatë vizitave në verë bën të gjitha vizitat mjekësore tek stomatologët e Prishtinës.

Marketingu në histori ishte përdorë për të bindur njerëzit e tjerë të tregtisë për të tregtuar. Ky është parimi. Metodatat e marketingut kanë ndryshuar dhe përmirësuar sot.

Prishtina duhet të listojë të gjitha resurset, shërbime që ofron, të gjitha të cilat mund t'i "shesë" në tregun ndërkombëtar. Kjo përmes Strategjisë së mirëfilltë për Marketing e cila për një periudhë dhe do të ishte plan veprimi për KK të Prishtinës. Kjo kërkon transparencë dhe qeverisje të mirë, llogaridhënie dhe bashkëvendimmarje të qytetarëve në gjetjen e zgjidhjeve të shumta.

*Bazat e Njohurive* – Prishtina mendon dhe shpreh tendencën për zhvillim dhe avansim të arsimit, ofrimit të kushteve fizike nëpër objekte porse dhe aktiviteteve arsimore, në Planin Zhvillimor Urban 2013 – 2025.

Me objektivin "Prishtina - portë e NJOHURIVE", shprehet i tërë orientimi drejt rritjes së njohurive si një "Agorë e shkëmbimit vendor dhe ndërkombëtar të njohurive, ideve konkurente të fuqizuara me kapacitetet njerëzore – studentët, të rinjtë me kualifikime dhe vizion të qartë për ekonominë e njohurive, e tregut të lirë, trendit në Evropë dhe botë".

*Bazat e njohurive në Prishtinë, në kuptim të numrit të institucioneve edukative dhe profesionale ekzistojnë, porse për të cilën mund të thuhet se ju mungon cilësia në nivelin e kërkuar, të duhur për të qenë konkurent me rajonin. Në kuptim të edukimit dhe ngritjes profesionale, nuk është e koordinuar kërkesa dhe oferta në prodhim të kuadrove profesionale, përderisa me resurset kryesore industriale dhe zhvillimore, të cilat janë jashtë territorit administrativ të Prishtinës, gjenden kryesisht në komunat e tjera përreth Prishtinës.*

*Institutet për hulumtim dhe zhvillim janë në fillimin e tyre, përderisa numri i tyre shtohet, me mangësi që në start të mosndërlidhjes së aktovotet të tyre me sfidat direkte zhvillimore, nevojës për gjetje të zgjidhjeve alternative në to.*

*Qasshmëria* – Parametri i qasjes si qytet është elaboruar në më shumë objektiva në planin zhvillimor Urban të Prishtinës, si në aspekt fizik, poashtu dhe në atë të shërbimeve. Fillimisht duhet të thuhet se qasja shihet si konditë me prioritet për t'u plotësuar: për të qenë I integruar si qytet në tërësi porse dhe për të qenë pjesë funksionale e regjionit. Disa lloje të transportit janë paraparë e të cilat i paraprijnë synimit madhor të plotësimit të konditave të të qenit I qasshëm, I integruar sikurse janë: Hartimi i MASTER PLANIT për transportin efikas publik në Prishtinë (2014), brenda tërësive të qytetit të Prishtinës, zonave të qytetit të Prishtinës sikurse dhe ridizajnimi i rrugëve për transport efikas publik dhe vetanak duke pasur parasysh ndikimet mjedisore.

Propozimet e shumta për gjetjen e zgjidhjeve në probleme akute të qytetit në kuptim të transportit, siq janë: ngarkimi I rrugëve nga veturat, mosfunksionimi i trotuareve, problemet e parkingjeve etj janë vetëm disa nga problemet në të cilat, propozohen masa dhe veprime për zhvillim urban efikasitet dhe kualitet më të lartë jetese.

Propozimet dhe planet për një qasje më të mirë regjionale, integrim në kuptim funksionimi efikas, shkojnë në drejtim të avansimit të infrastrukturës fizike porse dhe të shërbimeve: Adoptimi i formave për aplikim të PPP-së për investime kapitale në infrastrukturë publike, ndërtim dhe menaxhim të pikave multinodale; Hartimi i Planit për Qendrën Multinodale ATT - Autobus, Tren, Tramvaj.

Masat dhe veprimet tjera për efikasitet brenda përbrenda qytetit në kuptim të transportit, shkojnë në drejtim të ngritjes së kualitetit të jetesës, duke pasur parasysh zvogëlimin e ndotjes mjedisore (*me zvogëlimin e numrit të veturave; zvogëlimin e pronësisë së veturave; futjen si taksë –pagesën zonale për hyrje në qytet, mjete të transportit masiv public jo ndotës elektrik, etj*).

*Qasja prej, drejt dhe nëpër Prishtinë, është çështje shumë e madhe sfiduese e qytetit dhe e rajonit më të gjërë urban të saj. Parametri të jesh prezent në kohë dhe me qasje të lehtë në qytet, nga vetë banorët dhe për më tepër nga vizitorët, është fillimisht çështje e nivelit të infrastrukturës fizike porse dhe e infrastrukturës së shërbimeve. Fillimisht, duke tentuar të jesh sa më I integruar në rajon, nënkupton sfidën e të qenit me kohë prej dhe drejt aeroportit, e cila nga Prishtina dhe qytetet tjera është shumë e vështirë, në kuptim të arritjes në destinim të dëshiruar.*

*Kualiteti i jetës* - Parametri i kualitetit të jetës, për t'u përmbushur sipas standardeve të ZHBNJ, qytetit të Prishtinës I mbetet të zgjidhë në mënyrë efikase problemin e banimit ndër të tjera, mbrojtjes së mjedisit, hapësirave të lira dhe të hapura publike, transportit public, ngrohjes efikase, etj. Kualitetin e jetës fillimisht e vlerësojmë duke u nisur nga objektivi për një banim të ofrueshëm, atraktiv për qytetarët e saj dhe të ardhurit e rinj në qytet, banimit për të qenë konkurent në regjion. Për këtë parametër, sipas dokumentit të planifikimit PZHU 2013 – 2025 parashihen masa dhe veprime në kontekst të avansimit të banimit siq janë psh fillimisht hulumtimet e shumta për mos-banimin e shumtë të apartamenteve në Prishtinë, dukuri kjo e cila ndoshta është indikacion i HIPER prodhimit të ndërtim-banimit, apo ndoshta të trendit të ndërtimeve të pakriter në emër të investimeve në industri të ndërtimeve në emër të kthimit të shpejtë të investimeve, apo ndoshta të zhvendosjes së popullatës apo dhe ndoshta për arsye tjera.

Ndikimet mjedisore dhe ekonomiko-sociale të vendbanimeve të reja në formë të lagjeve në qytetin e Prishtinës janë poashtu temë aktuale dhe e rëndësishme e paraparë me plan zhvillimor,

me të cilën tentohet të evitohen probleme të rritjes së keqe urbane në dëm të uzurpimit të tokës bujqësore, zhvillimeve në dëm të zhvillimeve të komunave tjera fqinje. Fjala është për lagje diskutabile si: Nici, lagjja Marigona, fshati amerikan, të cilat do donin një studim të hollësishëm në kuptim të vlerësimit të arësyeshmërisë së zhvillimeve të tilla, karshi racionalitetit dhe shfrytëzimit të hapësirës, etj.

Mbrojtja e mjedisit është çështje e cila mbetet prioritet për qytetin e Prishtinës, përderisa shumë masa dhe veprime parashihen në drejtim të sigurimit të kualitetit të mjedisit të pandërtuar e të hapur për të qenë i pastërt, miqësor për qytetarët dhe vizitorët e saj. Ky është detyrim për tu përmbushur në mundësimin e frymimit të lirshëm të qytetit; lidhjes këmbësorike përgjatë qytetit me ruajtjen, kultivimin, avansimin dhe krijimin e hapësirave të reja publike, përderisa dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë multifunksionale, duke mundësuar përjetim të hapësirës gjatë cdo sezone, të hijëzuara dhe të përshtatshme në kushte të ndryshme atmosferike, për rekreim dhe shfrytëzim nga pensionistët, fëmijët, nënat me fëmijë, studentët etj;

Çështja tjetër në mbështetje të kualitetit të jetës është promovimi i transportit të jo motorizuar në Prishtinë, kjo me qëllim të promovimit të shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit, joshjes së të rinjve për sport dhe rekreim.

Shumë iniciativa parashihen për promovime të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi porse në vecanti të rritjes së atraktivitetit të qytetit të Prishtinës (shfrytëzim të autostradave nëpër qytet dhe sheshe për rekreime javore e mujore, ridizajnim të shesheve në vend-ekspozime në të hapur të artit e skenës, hapësirës së promovimit dhe stimulimit të krijimtarëve të rinj artistë në sculpture dhe arte tjera aplikative, ridizajnim të rrëpinave dhe deponive të mbeturinave në qytet të Prishtinës në hapësira-parqe të gjelbërta e të përkujdesura (tjegullorja dhe Velania); ridizajnim dhe shfrytëzim tërë sezonal të Liqenit të Gërmisë gjatë tërë sezonave për terrene të skateboard, patinazh, bejzboll dhe sporte tjera.

Kualiteti I jetës është parë kusht shumë me rëndësi menjëherë pas bazës ekonomike, për të tërhequr klasën kreative (Van den Berg 2006). Projekte të shumta parashihen për të rinjë dhe Klasën Kreative në Prishtinë, me qëllim të ofrimit të kushteve konkurruese për jetesë në krahasim me qendrat e tjera të njohurive në rajon më të gjërë.

Parametri tjetër i kualitetit të jetës është dhe shfrytëzimi i energjisë, ngrohjes, për të cilat parashihen masa dhe veprime sikurse dhe investime të formave të ndryshme, me pjesëmarrje të përgjithshme aktive. Poashtu parashihen mbështetje të shumta iniciativave të shumta të

profesionistëve dhe shoqërisë civile në “promovimin dhe shfrytëzimin efikas të energjisë, NEZ-Ndërtesave me Emission Zero”;

*Për kualitetin e jetës në vetë qytetin e Prishtinës, mund të thuhet se është e favorshme për qytetarët, nëse flasim për kushtet elementare infrastrukturore, (mos)ndotje të mjedisit apo dhe prezencën e atraktiviteteve rekreative për klasën creative, që punon dhe jeton në Prishtinë. Mund të thuhet se qyteti i Prishtinës nuk mund të flaes për mos ndotje të mjedisit përderisa nuk është vendimmarëse në fatin e gjigantëve të mëdhenj industrial të cilët janë jashtë zonës urbane të saj, ndotjes nga trafiku i rëndë, masat dhe veprimet që ndërmiren pa pjesëmarrje direkte të komunës së prishtinës. Për çështje të tilla të cilat janë jetike, rekomandohet planifikim në nivel të regjionit urban metropolitan, në këtë rradhë të Prishtinës.*

*Diversiteti* – Sipas Planit Zhvillimor Urban për qytetin e Prishtinës 2013-2025, parashihet mbështetja e grupeve tjera etnike dhe kulturore të cilat kontribuojnë në diversitetin kulturor në Prishtinë; mbështetja e solemniteteve nga grupet etnike kulturore jo shqiptare për promovimin e kulturave tjera në Prishtinë (në aspekt folklori e gastronomie etj). Poashtu si sfida për këtë çështje është paraparë grupëzimi i kulturave të tilla për dhënie të vecantisë në aspekt fizik në qytetin e Prishtinës, përderisa tentohet për qytet- *portë të kulturës, artit e të diplomacisë.*

Në aspekt të detajuar urbanistik më PZHU të Prishtinës është paraparë hartimi dhe zbatimi i Projektkonkursit për mbështetje hapsinore –urbanistike për grupet etnike dhe kulturore, me qëllim të kontribuimit në diversitetin kulturor në Prishtinë;

*Prishtina për të qenë atraktive do të duhej të jetë më e llojlojshme në kuptim të vlerave kulturore, etnike, gastronomike, etj, për të cilën mund të thuhet se pas luftës ky parametër nuk përmbushet në nivel të kënaqshëm nëse flasim për entitete që jetojnë përhershëm. Kjo vetëm se mund të thuhet se është përmbushur me praninë e komunitetit ndërkombëtar present në Kosovë. Kjo mungesë e kulturave të tjera etnike në Prishtinë, mund të zëvendëshet dhe deri në një masë plotësohet me përfaqësimin e më të dukshëm të kulturave të ndryshme të rajonit të RUM në Prishtinë. Kjo përdërisa flasim për komunitetet e entiteteve tjera sikurse janë serbët, kroatët, romët, dhe me prani shumë të vogël të kinezëve të cilët synojnë të mërgojnë për në Evropë perëndimore, porse qëndrojnë në Prishtinë deri në atë moment, të cilët për kur flasim meren kryesisht me tregti, tentojnë të jenë të padukshëm dhe është resurs i cili do të mund të përdorej me shumë zgjuarësi për të rritur atraktivitetin e qytetit të Prishtinës. deri më tani me prezencën e tyre artistike të ndryshme.*

Shkalla urbane – Sipas PZHU të Prishtinës 2013-2025, shkalla urbane si parametër për u përmbushur në kuptim të Zhvillimit të Bazuar bë Njohuri, është ajo e objektivit për Region urban Metropolitan, për qëllime integrimi dinamik, funksionimi efikas. Elaborohet funksionimi për shkaqe zgjidhjeje të transportit ndërurban, transportit të shpejtë drejt Aeroportit, ndërlihdjes me gjingantët industrial, si TC dhe Stacioni hekurudhor.

Ndër objektivat të cilët përmbushin deri në një masë parametrin e shkallës urbane është: “Arritja e marrëveshjes në mes të Prishtinës dhe tri komunave tjera (Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Kastriotit) për planifikim të përbashkët hapësinor, menaxhim efikas të territorit përreth ANP-së dhe zonës përreth saj; hekurudhave të Kosovës dhe Fushës së mihjes së re të TC-së. Në këtë kuptim poashtu rekomandohet dhe hartimi i përbashkët i Planit Hapësinor për menaxhimin e aeroportit, hekurudhave dhe të TC-së, të planifikuar për vitin 2017.

Parametri kryesor I kërkuar për të përmbushur zingjirin e të qenit metropolë është shkalla urbane, me të cilën nënkuptojmë madhësinë e zonës urbane e regjionit urban metropolitan. Kjo në rast të funksionimit të ri të zonës më të gjërë në kuptim të planifikimit për funksionim efikas metropolitan

Barazia sociale Sipas PZHU të Prishtinës 2013-2025, I ipet rëndësi zhvillimit social, përderisa rekomandohet themelimi i Institutit për mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale në qytetin e Prishtinës; iniciativa të shumta dhe project konkurse sikurse ajo për “Mbështetje dhe kultivim të shpirtit dhe kulturës urbane të shoqërisë”; mbështetje në hulumtime lidhur me “Sigurinë e fëmijëve në rrugët e Prishtinës”; Projekt- konkurs për hulumtime lidhur me “Shkaqet dhe nivelin e pasigurisë sociale dhe klasës sociale për mbështetje, sikurse dhe krimin urban në qytetin e Prishtinës”; Projekt konkurs për hulumtimin; “Ndikimi I ndricimit public rrugor dhe kualiteti I jetës - si një nga standardet urbane për siguri”.

*Është evidente se trendi i zhvillimeve të reja sidomos të ndërtimit vetanak të shtëpive individuale, ka tendencë të krijimit të shfaqjes së ndasisë sociale në kuptim të getoizimit dhe limitimit të hyrje daljeve në lagje të tilla luksoze të shtëpive. Lagje këto jashtë zonës urbane të Prishtinës, porse të cilat kanë cmime enorme dhe nuk mund të blihen sipas kushteve të tregjtit.*

Aktivitetet e njohurive – Sipas PZHU të Prishtinës 2013-2025, mbështeten aktivitete të bashkëpunimit ndërmjet instituteve për hulumtime zhvillimore dhe universiteteve, porse dhe të institutive me organizatata prodhuese ekonomike. Me PZHU të Prishtinës mbështeten aktivitetet e ndryshme educative, shkolla verore, kurse profesionale të ndryshme, shkëmbime të shumta

studentore, aktivitete kulturore dhe artistike të shumta në qytet. Të gjitha këto në emër të mbështetjes iniciativave të shumta për përparim të aktiviteteve të njohurive.

*Është evidente se Prishtina ka jetë të gjallë, mbështet aktivitete të shumta në shumë lëmi të shkencës artit dhe kulturës. Në aspekt të mbështetjes së themelimit të institutive të reja për hulumtim dhe zhvillim është domethënëse, prose në kuptim të mbajtjes apo joshjes së ekspertizës së prodhuar dhe të aftë për inovacione të reja, nuk është ende në nivel dhe I duhet kohë dhe mbështetje e shumë dhe financiare. Të tërat ndodhin për më tepër në zonën e ngushtë urbanë të Prishtinës, porse nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me reforma direkte në shumë institucione dhe çështje publike, nuk kanë ndikim dhe nuk inicohen për përparim dhe gjetje të zgjidhjeve afatgjate në probleme aktuale.*

Kapacitetet Organizative- Sipas Planit Zhvillimor Urban 2013-2025 të Prishtinës, parashihen hapa të mëtutjeshme për qeverisje të mirë, sipas parimeve demokratike për qeverisje dhevendimarrje. Parashihet shqyrtimi i përsëritshëm i “Ligjit për Kryeqytet” deri në aprovim final; rekomandohen krijimi i fondit për qeverisje të mirë dhe e-qeverisje; hulumtime të shumta lidhur me reformat në administratë, themelim të institutit për qeverisje të mirë në KK të Prishtinës; mbështetje për organizatat e shoqërisë civile.

*Nuk parashihet vetëdijësim dhe përfaqësim i klasës politike në vendimarrje, formim dhe lobim për reforma dhe jetësim të idesë dhe strukturës e formacionit të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës.*

Në vazhdim do të paraqitet sinteza përmes tabelës së indikatorëve, me të cilën paraqitet vlerësimi i pozitës dhe mundësive potenciale për zhvillim hapsinor të qytetit të Prishtinës drejt një qyteti metropolitan me Zhvillim të Bazuar në Njohuri. Indikatorët përmes përmes vlerësimit kualitativ, paraqiten si të kuantifikuara, prej ku rezultanta kryesore do të duhej të jetë udhërrëfyes drejt zgjidhjeve tjera në favor të qëllimit kryesor për zhvillim hapsinor e urban të qytetit të Prishtinës.

Në vazhdim do të paraqitet tabela e vlerësimit të skenarit të dytë – Zhvillimi policentrik i qytetit të Prishtinës bazuar në Plane Zhvillimore Komunale dhe Urbane sipas parametrave të Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative.

**Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative**

**SKENARI II**

**Prishtina – me zhvillim urban POLICENTRIK, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban 2013 – 2025**



	<b>Përshkrim i situatës në rast skenari 2</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Baza e Njohurive</b>	Kualiteti në fakultete dhe shkolla të larta do të kenë një nivel më të lartë zhvillim për shkaqe përmbushjeje kriteri fizik të shpërndarjes së objekteve të arsimit, përdërisa klasa creative do të jetë më e akomoduar dhe më e joshur në aspekt të kualitetit të jetës	(o)
<b>Baza ekonomike</b>	Zhvillimi ekonomik në rast të zhvillimit policentrik do të jetë më në avantazh, për shkak të shpërndarjes së funksioneve dhe të tregut të punës, në një anë dhe të mosmbajtjes së monopolit të qendrës së vetme në Prishtinës, me tregun e patundshmërive.	(+)
<b>Kualiteti i jetes</b>	Kualiteti i jetës do të jetë më i avansuar me zgjerimin e hapësirave për rekreim e sport, hapësira të lira në kuadër të qytetit, të dekoncentruar nga qendra e qytetit.	(-)
<b>Qasshmeria</b>	Lidhjet dhe komunikimi intraurban do të duhej të jetë më i avansuar në rast të zhvillimit policentrik, përdërisa ai ndërurban pa transport tjetër përpos atij rrugor vazhdon të jetë i vështirë, dhe kërkon zgjidhje efikase.	(-)
<b>Shkalla urbane</b>	Zhvillimi policentrik i shkon në favor aspektit të madhësisë së qytetit të Prishtinës, shkallës urbane, me crast përfiton qyteti me madhësinë e saj të re të krijuar me dekoncentrim të saj, funksioneve të shumta të saj.	0
<b>Barazia sociale</b>	Mundësitë për barazi më të madhe sociale në rast të zhvillimit policentrik janë më të mëdha, meqë cmimi i tokës dhe mundësitë e banimit të ofrueshëm janë më të shumta. Diversiteti kulturor në këtë rast është më i mundshëm me cka kontribuon në qytet të Prishtinës drejt ZHBNJ.	(+)
<b>Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”-Klasës kreative</b>	Klasa kreative ka më shumë mundësi zgjedhjeje për akomodim dhe shpenzim të kohës së lirë, në rast të qyteti më të madh të opsioneve më të shumta të zhvillimit urban dhe hapsinor. Kjo për shkak të opsioni policentrik ofrom mundësi më të mëdha të zhvillimit ekonomik bazës më të lartë ekonomike, kualitet më të lartë të jetës.	(+)
<b>Krijimi i njohurive të reja;Zhvillimi i “grupimeve” të reja</b>	Njohuritë e reja janë shumë më të mundshme me zhvillim hapsinor e urban policentrik. Grupimet e reja janë të mundshme dhe në rast të zgjerimit të qytetit, dekoncentrimit të funksioneve, ofrohen mundësi të reja dhe të ofrueshme për grupime të reja.	0
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Policentriciteti është pjesë e vizionit të qytetit të Prishtinës, me cka kemi të përmbushur kriterin. Rrjete strategjike ende nuk do të mund të jetësohen në rast të këtij zhvillimi, pa primesa ndërlidhjeje ndërurbane, funksionimi si një regjion.	0
<b>Udhëheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udhëheqja dhe mbështetja politike do të duhej të jetë së paku e infrmuar për planet e saja për Prishtinën, për avantazhet dhe disavantazhet e skenarit të qyteti policentrik. Mbështetja shoqërore do të ishte shumë më e shprehur në rast të informimit të drejtë të	(o)

vizionit dhe caqeve zhvillimore për qytetin e Prishtinës.

--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor

Tab.10. Tabela e vlerësimeve të skenarit II – zhvillimit policentrik të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO

*Përfundime për Skenarin 2– Zhvillimi policentrik i Prishtinës*

*Zhvillimi urban dhe hapsinor policentrik për Prishtinën është i paraparë më planet për Prishtinës, Planin Zhvillimor Komunal dhe atë Zhvillimor Urban.*

*Në mënyrë të dukshme zhvillimi policentrik do të kontribuojë në aspekt pozitiv në përmbushjen e parametrave të ZHBNJ dhe KO,,undësitë për zhvillim ekonomik më të larmishëm janë më të mëdha, mundësitë për grupime të reja, rrytëazime, dhe kualitet të jetës janë më të mëdha. Ky është opsioni të cilin Prishtina e ka të planifikuar porse duhet të potencohet se policentriciteti nuk është i parapara në aspekt urban – rural, me cka humbet vlerën e saj të ndërlidhjes dhe funksionimit si një të qytetit.*

*Ndërlidhjet kryesore do të jenë në mes të dy poliqendrave të Prishtinës, përderisa zonat jashtë orbitës së qendrave do të jenë të distancuara dhe në aspekt funksioni më të gjërë.*

*Ky model i zhvillimi urban është më i levërdishëm për investitorët e shumtë të cilëve iu intereson tregu i punës dhe tregu i patundshmërive, apo vlerës së tokës.*

### V.III. SKENARI III. ZHVILLIMI SI REGJION URBAN METROPOLITAN I PRISHTINËS

Në këtë pjesë do të analizohet skenari i tretë i zhvillimit hapsinor të Prishtinës, skenari i zhvillimit si Regjion Urban Metropolitan, në kuptim të përmbushjes së parametrave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, sipas: i)Planit Hapsinor të Kosovës 2010 – 2020 +; dhe Planeve Zhvillimore komunale të komunave: Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë.

Fillimisht do të përshkruhen karakteristikat kryesore zhvillimore sipas planeve, me skanimin e përmbushjeve të objektivave, sipas parametrave të ZHBNJ dhe KO. Vlerësimet do të analizohen dhe përshkruhen, përdeërisa dhe do të kuantifikohen në shkallën prej: (--shumë të disfavorshme, - të disfavorshme, 0 - neitrare, + - të favorshme dhe ++shumë të favorshme), në kuptim të përmbushjes së parametrave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.




Fig.38. Ndarja regionale e Kosovës sipas potencialeve dhe orientimeve zhvillimore

Sipas Planit Hapsinor të Kosovës, Prishtina i takon Hapësirës së Kaltër Zhvillimore – Portës së Kosovës, me të cilin orientim zhvillimor i takon të luajë rolin primar ekonomik për vendin, rolin e qendrës amë diplomatike, arsimore, tregtare, kulturore, joshëse për banorët dhe vizitorët, portë e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave të ndryshme lokale, regjionale dhe ndërkombëtare.

“Tërësia e hapësirës së kaltërt – Portit të Kosovës, e cila gjendet në pjesën verilindore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Lypjani, në qendër me qytetin e Prishtinës, ka karakteristika të rajonit të dendur të qendrave urbane dhe atyre rurale në zhvillim e sipër, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, pasuri nëntokësore (linjtit, Ni, Pb, zink, ari), hapësirave dhe objekteve të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore, hapësirave të lira të gjelbra, ndërsa për nga veprimtaritë ekonomike karakterizohet me ato industriale, tregtare dhe shërbyese, si dhe veprimtaritë administrative, shëndetësore, arsimor dhe shkencore”.

Në kontekst të analizës sonë të skenarit të III në këtë studim, Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës, do i lëmë jashtë qytetet (Drenasin dhe Shtimen) të parapara poashtu në hapësirë e kaltërt për shkakë të jo ndikueshmërisë direkte në Regjionin Urban Metropolitan të Prishtinës.




Fig.39 Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) - administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agroindustriale, turistike – Prishtina

Me këtë dokument strategjik synohet forcimi i identitetit urban, përmirësimi i shërbimeve apo ofrimi i lehtësirave të ndryshme (administrative, edukative, shëndetësore, sportive, kulturore,

etj.), duke siguruar një shpërndarje të përshtatshme, duke e bërë transportin (publik dhe privat) më efikas dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar në përgjithësi jetueshmërinë në këtë qytet.

Për më tepër, që të trija këto dokumente strategjike që flasin për Prishtinën, e shohin atë në rolin e “Kryeqytetit”, me të cilin thuhet se: “Është e nevojshme të rritet qasja dhe atraktiviteti i territorit; shtimi i marrëdhënieve ndërkombëtare nëpërmjet zbatimit të rrjeteve materiale, infrastrukturës së transportit dhe të komunikimit, rrjeteve të bashkëpunimit mes qyteteve, duke përmirësuar “imazhin” e qytetit të prezantuar në botën e jashtme. “

### ***Sfidat kryesore të zhvillimit hapsinor të Prishtinës***

- Përfaqësimi i një shteti të ri, përmes identitetit të krijuar ndër shekuj, përmes imazhit, vlerave të trashëgimisë kulturore e historike, përmbushjes së funksioneve diplomatike, konsulare, kulturore, shkencore, qeveritare etj;
- Kontributi për një shtet të ri si kurriz I zhvillimit ekonomik, me përpresi konkurrese dhe kontribut për transformim në një qytet ndërkombëtar, atraktiv, të jetueshëm, të afërt për studentin, për qytetarin, për vizitorin e rastit porse dhe i një qyteti – destinim i posaqëm;
- Përfaqësimi i një shteti të ri, me një qasje të re bashkëpunuese dhe lidhjeve me rrjetet botërore në shumë aspekte, porse të trendeve të reja inovative !

### **V.III. I. – SKENARI III - SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR TË LIPJANIT**

Në këtë pjesë do të elaborohet pozita e komunave fqinje karshi kontributit për një Prishtinë – regjion urban, bazuar në analizën e Planeve Zhvillimore Komunale të tyre sipas parametrave të Teorisë së Bazuar në Njohuri, përkatësisht objektivat e tyre zhvillimore karshi ZHBNJ. . Planet zhvillimore që do elaborohen do të jenë: Plani Zhvillimor komunal I Lipjanit, Fushë Kosovës, Kastriotit dhe Podujevës. Kjo do të na shërbejë që në fund të bëjmë përfundimin për skenarin e tretë zhvillimor karshi orientimit zhvillimor të Prishtinës – Regjion Urban.

Në këtë pjesë elaborohen projeksionet për zhvillimin e qytetit të Lipjanit, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të vitit 2004. Këto analiza do të jenë të natyrës krahasuese, në baza të parametrave të teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Me këtë rast identifikohen qëllimet dhe objektivat kryesore që mbështesin regjion urban metropolitan të Prishtinës drejt Zhvillimit të bazuar në njohuri.

Në fund ipen dhe rekomandimet e pjesshme për këtë pjesë të analizës, për bashkëpunim dhe zhvillim koherent për një regjion urban të Prishtinës drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Në vazhdim kemi analizat sipas parametrave të ZHBNJ:

Baza ekonomike - Që në fillim duhet të thuhet se Lipjani gjendet në pjesën jugore të Prishtinës, përdërisa roli kyq i saj në aspekt të regjionit urban të gjërë të Prishtinës i atribuohet prezencës së ANP – Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe migrimit ditor që vënie nga Prishtinë nga fuqia punëtore. Në fig.x. shohim se sipas PZHK të Lipjanit, është parë roli i Lipjanit në kontekst regional dhe në kontekst vendi.

Që nga viti 1999, kushtet zhvillimore për komunën e Lipjanit kanë ndryshuar rrënjësisht. Lipjani sot ka rastin të shfrytëzojë me kapacitet të plotë të gjitha mundësitë që dalin nga pozita e saj gjeografike dhe infrastruktura e saj e cila është më afër qytetit të Prishtinës, lokacionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.




Fig.40. Pozita e Lipjanit karshi Regjionit Urban të Prishtinës




Fig.41. Rritja e hapësirave sipas kategorive zhvillimore në qytetin e Lipjanit sipas PZHK

Lipjani ka kërkesa të shumta për rritje të qytetit: tokë industriale, komerciale dhe banimi , përdërisa nga grafiku shihet se sipas Planit Zhvillimor Komunal, qyteti i Lipjanit do të rritet prej 35% - me sipërfaqe për zona industriale.

Nga analiza e vendosjes së hapësirave industriale dhe tregtare në të ardhmen e qytetit të Lipjanit në aspekt hapsinor, konkludojmë se ato janë të disfavourshme në kontekstin e regjionit urban për shkak se ndodhen:

- Jashtë kontekstit të lidhjes direkte dhe të afërt fizike me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe jashtë linjës hekurudhore, me cka do të rritet kostoja e transportit dhe do kemi transport rrugor të shtuar;

- Kemi shpërndarje hapsinore të zonave industriale dhe tregtare në qytet të Lipjanit me cka kemi shfrytëzim joracional të tokës.

Në fig.x. shohim se zona industriale dhe tragtare është në largësi të ANP dhe atë e ndarë në dy hapësira të ndara në qytet, fakt i disfavorshëm për arsye ekonomike të cmimit të transportit të mallrave të prodhuar,

Në fig.x. shohim se ANP nuk është e specifikuar për t'u rezervuar për aktivitete ekonomike, e disfavorshme në rastin e Regjionit Urban të Prishtinës.





Fig.42. Pozita e zonave industriale dhe tregtare në raport me ANP Lipjanit

Fig.43 Modeli i zhvillimit hapsinor të




Fig.44. Paraqitja e zonës industriale dhe tregtare

Fig.45 Paraqitja e zonës së ANP

Baza e Njohurive - Kjo ndërlikohje e mundshme e hapsirave industriale në mes të Prishtinës dhe Lipjanit do të mund të bashkërenditej në përvoja të njohurive, shkëmbime të shumta shkencore dhe praktike në kontekst regjioni porse dhe më gjërë.




Fig.46. Skenarët zhvillimorë të Lipjanit

Qasshmëria – Parametri I qasjes është ndër më të rëndësishmit për zhvillime regjionale në rastin e Prishtinës.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Lipjanit, rrjeti i infrastrukturës rrugore është në favor të ndërlidhjes me regjionin urban të Prishtinës.

Zona industriale dhe tregtare është planifikuar në të jetë në udhëkryq të rrugëve nacionale porse cka nuk mund të thuhet për rrjetet hekurudhor dhe posaqërisht për ndërlidhje dhe bashkërendim me Aeroport Ndërkombëtar të Prishtinës.

Në secilin nga sekenarët e zhvillimit të Lipjanit nuk parashihet lidhje direkte me Prishtinën në funksion të ANP, përderisa e gjithë komuna do të duhej t'i shërbejë kryesisht ANP-së dhe aktiviteteve në të, turistike, hoteljere, shërbyese, tregtare etj, zonë e cila do të duhej të planifikohej të shfrytëzohet për qëllime aeroporti.

Në anën tjetër në asnjë skenar nuk është paraparë zhvillimi i Lipjanit në funksion të përbashkët me Prishtinën si regjion urban.

Kualiteti i jetës - Me investime të shumta infrastrukturore e të shërbimeve të shumta, mundësive të shumta të bashkëpunimeve si regjion, do të rritej shtojë kualiteti i jetës, parametër ky në favor të Regjionit urban të Prishtinës.

Diversiteti – Me funksionimin si regjion urban i Prishtinës së bashku me Lipjanin– do të sjell më shumë laramani kulturore, psh. me mbështetjen e komunitetit kroat në Janjevë me c'rast do të ishte vlerë e shtuar për regjionin urban të Prishtinës drejt ZHBNJ.

Shkalla urbane – Sipas PZHK të Lipjanit nuk shohim tendencë praktike në projekte dhe programe për zhvillime të përbashkëta me regjionin e Prishtinës.

Aktivitetet e njohurive – Sipas PZHK të Lipjanit nuk shohim tendencë praktike në projekte dhe programe për zhvillime të përbashkëta në aspekt bashkëpunimesh dhe rrjetëzimesh të aktovoteveve arsimore e shkencore mes akademisë/shkencës/hulumtimit e prodhimit për të qenë në favor të regjionit urban të Prishtinës.

Kapacitetet Organizative- Sipas PZHK të Lipjanit nuk mund të thuhet se udhëheqja e Lipjanit shpreh dhe paraqet gadishmëri për forma të reja bashkëpunimi dhe bashkërendimi për zhvillime të ardhshme në kontekst të regjionit urban të Prishtinës.

Përfundim - Lipjani – Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Lipjanit bazuar në Planin zhvillimor komunal në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:



- Në përgjithësi synimet e komunës së Lipjanit bazuar në Planin zhvillimor të saj janë për një domosadoshmëri zhvillimesh si regjion i përbashkët, i dalë nga PHK i Kosovës, porse në vecanti kjo nuk shihet përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara.
- Lidhjet urbanp-rurale si poliqendra interne për Lipjanin, të cilat do të kontribonin për regjionin Urban të Prishtinës mungojnë.
- ANP nuk është parë si një aset për komunën, rreth së cilës do të duhej të zhvillohej e tërë komuna e Lipjanit porse dhe specifikat për ta parë atë si vlerë nuk dalin nga PZHK. Ajo është lënë si e vecantë dhe jo integruar në zhvillime;
- Infstruktura rrugore është ajo më e potencuara dhe për më shumë e paraparë për t'u zhvilluar në të ardhmen, kjo jo shumë e favorshme për Regjionin Urban të Prishtinës

Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative	SKENARI III Komuna e Lipjanit - Konteksti i Regjionit Urban të Prishtinës	
	Përshkrimi	Vlerësimi
<b>Baza e Njohurive</b>	Bazë solide e njohurive në komunën e Lipjanit. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës.	(+)
<b>Baza ekonomike</b>	Baza ekonomike e Lipjanit është komponentë plotësuese e regjionit urban të Prishtinës në kuptim të ngritjes së përgjithshme ekonomike, sidomos bazuar në resursin e zhvillimit të zonës së aeroportit në dobi të konkurrencës – vendosjes së kompanive multinationale në afërsi dhe shërbim të ANP. Resurset e shumta tregtare e shërbuese për tu alokuar sikurse dhe trendi i zhvillimit të tyre, është në favor të regjionit urban të Prishtinës. Hekurrudhat e Kosovës, lënë mundësi të shumta për zhvillim të bashkërenditur edhe pse në objektiva kjo nuk është e shprehur. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Kualiteti i jetes</b>	Kualiteti i jetës në rast të pjesëmarjes së komunës së Lipjanit do të ishte kontribut i madh në Regjion Urban të Prishtinës. Avansimi i shërbimeve publike, shërbimeve të arsimit e atyre sociale janë synim drejt kualitetit më të lartë, me c' rast do përfitojë regjioni urban në tërësi. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Qasshmeria</b>	Qasjet ndërmjet komunës dhe regjionit vihen vetëm përmes rrugës nacionale dhe jo dhe transportit hekurudhor, duke e ditur se këto dy komuna na fakt funksionojnë si një.	(--)

	Kriter jo I plotësuar në favor të plotë të regjionit urban të Prishtinës	
<b>Shkalla urbane</b>	Shkalla urbane , si parametër është me rëndësi për regjionin, porse me vetë analizat e objektivave zhvillimorë të komunës së Kastriotit, shohim tentative të vakët, drejt bashkërendimit zhvillimor me regjionin e Prishtinës.  Kriter jo I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Barazia sociale</b>	Barazia sociale do të arrihej dhe më shumë me vetë pjesëmarrjen në regjion të komunës së Lipjanit, me rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive.  Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”-Klasës kreative</b>	Me vetë rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive sikurse dhe të kualitetit të jetës, klasa Kreative do të motivohet të mbesë në komunë, regjion .  Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Krijimi I njohurive te reja;Zhvillimi I “grupimeve” të reja</b>	Sipas objektivave zhvillimorë nuk kemi tendenca të bashkëpunimit dhe interakcionit mes akademisë dhe prodhimit, përderisa dhe mungon tendenca për një grupëzim të tillë në aspekt territory apo funksionalizimi.  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Vizioni, strategjitë si dokumenta strategjike sikurse dhe në praktikë nuk shihen dhe krijimi e mbështetja e rrjetëzimeve strategjike. Këto të tërat nuk përcaktojnë komunën e Podujevës si pjesë të regjionit urban të Prishtinës, me një bashkërenditje zhvillimore .  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Udheheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udheheqja dhe spektri politik edhe të papërgatirur pr një formë të re të organizimit të territorit në regjion urban të Prishtinës.  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)

*--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor*

**Tab. 11 Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Lipjanit në Regjion Urban metropolitan të Prishtinës**

### V.III.II. SKENARI III – SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FUSHË KOSOVËS

Në këtë pjesë do të elaborohet pozita e komunës fqinje të Fushë Kosovës karshi kontributit për një Prishtinë – regjion urban, bazuar në analizën e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës sipas parametrave të Teorisë së Bazuar në Njohuri, përkatësisht synimeve e objektivave, orientimeve zhvillimore.

Komuna e Fushë Kosovës gjendet në distancë ajrore prej 6.6 km në të Prishtinës me sipërfaqe prej 85 km<sup>2</sup>, në lartësi mbidetare 500 - 1000m dhe numër të banorëve 3600026 Qyteti i Fushë Kosovës ka:

Rruga regjionale M9 lidh qytetin e Fushë Kosovës me Prishtinën. Fushë Kosova ka lidhje direkte edhe me Lipjan, Kastriot e Drenas. Autostrada e re kalon përmes kësaj komune (Shih fig.x. xxxxxxx). Komuna e Fushë Kosovës ka 14 vendbanime 27.

Fushë Kosova ishte komunë industriale, që nga fillimi i viteve të '70-ta, me kapacitete prodhuese të përpunimit të ushqimit (miellit dhe bukës) dhe të tekstilit. Poashtu në Fushë Kosovë janë të vendosura Hekurudhat e Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës me një pjesë, përdërisa pjesa më e madhe i takon komunës së Lipjanit. Në komunën e Fushë Kosovës shtrihen rezervat e mëdha të qymyrit-linjit që furnizojnë Termocentralet në Kastriot për prodhimin e energjisë elektrike.




Fig. 47 Hapësira e kaltër sipas PHK



Fig. 48 Harta e rrjetit hekurudhor të Kosovës me epiqendrë në Fushë Kosovë

<sup>26</sup> Sipas ESK – Enti I Statistikave të Kosovës, regjistrimit 2012

<sup>27</sup> (Grabovc, Bardhi i Madh, Pomazotin, Bardhi i Vogël, Sllatinë e Vogël, Sllatinë e Madhe, Harilaq, Henc, Vragoli, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Kuzmin, Lismir dhe vetë qyteti Fushë Kosovë).

Mihjet ekzistuese të hapura të linjitet në Bardh dhe Mirash zënë sipërfaqe prej 1.061 ha ose 7 % nga territori i përgjithshëm Fushës së Mihjes së Re, zonës me interes të veçantë ekonomik.

Që nga viti 2006 në pjesën e aktiviteteve të kryera të minierës së Mirashit është ndërtuar deponia rajonale dhe ka filluar të shfrytëzohet hapësira për deponimin të mbeturinave urbane të Komunave të Prishtinës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Podujevës dhe Lipjanit. Në kuadër të këtij aktiviteti nuk bëhet seleksionim dhe riciklimi i materialit të mbeturinave.

Baza ekonomike - Sipas PZHK të Fushë Kosovës, shihet se komunën e saj e definojnë si pjesë të Hapësirës së kaltër të regjionit të Prishtinës (Shih fig.x.). Resurset infrastrukturore të cilat janë në Fushë Kosovë, kërkojnë bashkërendim zhvillimor me Prishtinën të definuara më sponhtë si sfida, porse të cilat kanë domethënie shumë të madhe në sferën ekonomike.

Përderisa kemi në rastin e Fushë Kosovës, përqindje gati të njëjtë të tokës së ndërtuar dhe deponive të hirit, ky është fakt për brengë për zgjidhjen e qëndrueshme të problemit dhe nevojë për një qasje regjionale ndaj saj.

<p><i>Hekurrudhat e Kosovës – zona e zhvillimit përreth Aeroporti Ndërkombëtar I Prishtinës dhe zona e zhvillimit përreth, Mihjet e linjitet në Bardh dhe Mirash dhe zona e zhvillimit përreth, Deponia rajonale e mbetjeve të Prishtinës, Kastriotit dhe Podujevës, Lipjanit</i></p>	<p><b>14.19% - tokë të ndërtuar (urbane),</b>  <b>54.35% tokë bujqësore,</b>                  13.63% - pyje,                  1.6% - djerrinë,                  10.26%, - deponi pasive hiri,                  5.47%- industri,                  0.5%- deponi aktive hiri .</p>
---	---

**Tab.12. Sfidat e përbashkëta të FK dhe Prishtinës dhe ndarja e hapësirës sipas kategorive të shfrytëzimit**

Bazat e Njohurive – Nuk parashihet interakcion me pjesën e shkencës dhe të inovacioneve me institucionet prodhuese dhe shërbyese të Fushë Kosovës, me cka do të arrihej në shumë aspekte, njohuri më të zgjëruara dhe të provuara, punësim më të llojlojshëm, krijim njohurish të reja sikurse dhe aktivitete të njohurive të shumta. Klasa kreative do të ishte më e joshur të qëndrojë në regjion me c’rast dhe cilësia e njohurive do të rritej.

Qasshmëria – Në qytetin e Fushë Kosovës ashtu dhe siq thamë kemi qendrën e hekurudhave të Kosovës, porse ato tanimë nuk janë duke u avansuar për një decadë e gjysmë. Sipas PZHK të Fushë Kosovës, nuk kemi lëvizje në drejtim të transportit të përditshëm të njerëzve, komunikimit intern dhe jashtë komunës. Është në disfavor sa i përket regjionit urban të Prishtinës me vetë faktin se nuk kemi dhe lidhje të shpejtë me transport hekurudhor për në aeroport. Në anën tjetër meqë sipas trendit aktual kemi gati një lidhje të pandarë urbane të zhvillimeve përgjatë rrugës nacionale, kjo i shkon në favor regjionit urban të Prishtinës me cka humbet kufiri qytet – qytet.



Shkalla urbane – Është në favor absolut për regjionin urban të Prishtinës, fakti i të interaktuarit në sfera të ndryshme të Fushë Kosovës me Prishtinën. Funkcionet e përbashkëta implikojnë që këto dy komuna të funksionojnë si një regjion.

Kapacitetet Organizative- Sipas PZHK të Lipjanit nuk mund të thuhet se udhëheqja e Lipjanit shpreh dhe paraqet gadishmëri për forma të reja bashkëpunimi dhe bashkërendimi për zhvillime të ardhshme në kontekst të regjionit urban të Prishtinës.

Përfundim - Fushë Kosova – Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Fushë Kosovës bazuar në Planin zhvillimor komunal dhe në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:

- Në përgjithësi synimet e komunës së Fushë Kosovës bazuar në Planin zhvillimor të saj janë për një domosadoshmëri zhvillimesh si regjion i përbashkët, i dalë nga PHK i Kosovës, porse në vecanti kjo nuk shihet e shprehu përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara.
- Lidhjet urbane-rurale si poliqendra interne për Fushë Kosovën janë të neglizhurara në kutrim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribonin për regjionin Urban të Prishtinës.
- ANP dhe zona përreth nuk është parë si një sfidë reale për komunën, ndoshta dhe aset rreth së cilës do të mund të zhvillohej komuna dhe për të cilën do të mund të punontë për më shumë. Ajo është lënë si e vecantë dhe jo integruar në zhvillimet e ardhshme;
- Infrastruktura hekurudhore e cila e determinon komunën si të tillë, do të duhej të dominonte në objektivat zhvillimore, porse nuk kemi një rast të tillë. Zhvillimi i saj i është lënë nivelit më të lartë apo dhe është neglizhuar për tu marrë niveli lokal me të. Kjo nuk i shkon në favor të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri duke marrë parasysh mundësitë për zhvillim të transportit të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit etj.
- Inftrasruktura rrugore është ajo më e potencuara dhe për më shumë e paraparë për t'u zhvilluar në të ardhmen, kjo jo shumë e favorshme për Regjionin Urban të Prishtinës

<b>Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative</b>	<b>SKENARI III</b>	
	<b>Komuna e Fushë Kosovës</b>	
	<b>Konteksti i Regjionit Urban të Prishtinës</b>	
	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlerësimi</b>

<sup>28</sup> Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

<b>Baza e Njohurive</b>	Bazë solide e njohurive në komunën e Fushë Kosovës. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës.	(+)
<b>Baza ekonomike</b>	Baza ekonomike e Fushë Kosovës është komponentë plotësuese e regjionit urban të Prishtinës në kuptim të ngritjes së përgjithshme ekonomike. Resurset e shumta tregtare e shërbyese të locuara sikurse dh trendi I zhvillimit të tyre, është në favor të regjionit urban të Prishtinës. Hekurrudhat e Kosovës, lënë mundësi të shumta për zhvillim të bashkërenditur edhe pse në objektiva kjo nuk është e shprehur. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Kualiteti I jetes</b>	Kualiteti I jetës në rast të pjesëmarrjes së komunës së Fushë Kosovës do të ishte kontribut I madh në Regjion Urban të Prishtinës. Avansimi I shërbimeve publike, shërbimeve të arsimit e atyre sociale janë synim drejt kualitetit më të lartë, me c’rast do përfitojë regjioni urban në tërësi. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Qasshmeria</b>	Qasjet ndërmjet komunës dhe regjionit vihen vetëm përmes rrugës nacionale dhe jo dhe transportit hekurudhor, duke e ditur se këto dy komuna na fakt funksionojnë si një. Kriter jo I plotësuar në favor të plotë të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Shkalla urbane</b>	Shkalla urbane , si parametër është me rëndësi për regjionin, porse me vetë analizat e objektivave zhvillimorë të komunës së Kastriotit, shohim tentative të vakët, drejt bashkërendimit zhvillimor me regjionin e Prishtinës. Kriter jo I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Barazia sociale</b>	Barazia sociale do të arrihej dhe më shumë me vetë pjesëmarrjen në regjion të komunës së Podujevës, me rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”-Klasës kreative</b>	Me vetë rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive sikurse dhe të kualitetit të jetës, klasa Kreative do të motivohet të mbesë në komunë, regjion . Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Krijimi I njohurive te reja;Zhvillimi I “grupimeve” të reja</b>	Sipas objektivave zhvillimorë nuk kemi tendenca të bashkëpunimit dhe interakcionit mes akademosë dhe prodhimit, përderisa dhe mungon tendenca për një grupëzim të tillë në aspekt territory apo funksionalizimi. Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(+)
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Vizioni, strategjitë si dokumenta strategjike sikurse dhe në praktikë nuk shihen dhe krijimi e mbështetja e rrjetëzimeve strategjike. Këto të tërat nuk përcaktojnë komunën e Podujevës si pjesë të regjionit	(--)

	urban të Prishtinës, me një bashkërenditje zhvillimore . Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	
<b>Udheheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udheheqja dhe spektri politik edhe të papërgatirur pr një formë të re të organizimit të territorit në regjion urban të Prishtinës. Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor		

**Tab. 13. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Fushë Kosovës në Regjion Urban metropolin të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO**

### V.III.III. SKENARI III. SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KASTRIOTIT

Në këtë pjesë do të elaborohet pozita e komunës fqinje të Obiliqit /Kastriotit, karshi kontributit për një Prishtinë – regjion urban, bazuar në analizën e Planit Zhvillimor Komunal, sipas parametrave të Teorisë së Bazuar në Njohuri, përkatësisht synimeve e objektivave, orientimeve zhvillimore. Komuna e Obiliqit (Kastriotit) gjendet vetëm 10 km larg Prishtinës, fakt ky I cili është në favor të Regjionit Urban të Prishtinës. Gjendet në pjesën veriperëndimore të saj me 22000 banorë<sup>29</sup>.

Është komunë agraro-industriale ku bën pjesë dhe gjiganti i KEK-ut, përderisa në të gjenden rezerva të mëdha të thëngjillit, rezerva prej 13 miliarde ton. Kjo e bën komunën e Kastriotit, të jetë një ndër komunat më të ndotura në Kosovë, sfida kryesore mes Prishtinës e Kastriotit drejt ZHBNJ. Sfidat e zhvillimit të Kastriotit në kontekst ekonomik të regjionit urban të Prishtinës do të ishin:

Zona e mihjes së re	4% - tokë të ndërtuar (urbane),
Depopullimi	48% tokë bujqësore,
Menaxhimi I ndotjes	37% - pyje,
Mbrojtja e Mjedisit-ripyllëzimi	4%, - mihje sipërfaqësore
Aktivitetet e njohurive	2%- industri,
	2%- deponi aktive hiri .


**Tab. 14 Sfidat e përbashkëta të Kastriotit në kontekst regjioni të Prishtinës dhe ndarja e hapësirës sipas kategorive të shfrytëzimit**

Zgjidhjet e favorshme për Regjionin do të ishin në favor të drejtpërdrejtë dhe për vetë komunën e Obiliqit/Kastriotit në shumë aspekte. Regjioni Urban I Prishtinës do të përfitojë në mënyrë indirekte nga të qenit pjesë integrale e vendimmarjes në planifikim të komunës së Obiliqit, do

<sup>29</sup> ESK – Enti I statistikave të Kosovës



të ekzistonte mundësia e zgjidhjeve më të shpejta të problemeve, problem I depoipullimit, degradimit të mjedisit, rryllëzimit të deponive të hirit etj.



*Fig.52. Pozita e Kastriotit në kontekst të Kosovës*

*Fig.53 Pozita e Kastriotit në fqinjësi me Prishtinën dhe Podujevën*

Ky bashkërendim në kontekst regjioni do ishte I ndërsjellë, në kuptim të ngritjes së cilësisë së jetës, përmes mbrojtjen e mjedisit dhe shndërrimit të tyre në resurse rekreative e sportive, turistike.

Fakte të rëndësishme janë se Kastrioti ka ekzistuar si vendbanim prej kohës së sundimit turk (nahi), ishte pjesë e komunës së Prishtinës, përderisa sot është komunë në vete. Prej vitit 1873-kishte hekurudhën Shkup-Mitrovicë që kalonte nëpër komunë, dhe administron me 20 vendbanime.<sup>30</sup> Nëpër komunë kalon autostrada Merdare - Prishtinë – Morinë.

Bartësit kryesorë të zhvillimit në komunën e Kastriotit(Obiliqit) sot janë termoelektranat, minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I – IV dhe rruga natyrisht rruga magjistrale M2 ne relacionin Prishtine – Mitrovicë e cila sjell mundësi për tregti përgjatë rrugës, dukuri kjo e pasluftës së vitit '99.

Në komunën e Obiliqit/Kastriotit kemi depopullim. Kjo për shkaqe kryesisht ekonomike, përderisa pas vitit '99, kryesisht është depopulluar nga popullata joshqiptare, dhe tani së fundmi përsëri për shkaqe ekonomike, të papunësisë së lartë dhe kërkimit të gjetjeve alternative porse dhe për shkak të ndotjes enorme të mjedisit.

<sup>30</sup> Obiliq i Ri dhe i Vjeter, Hade, Babimoc, Bakshi, Breznice, Cerkvena Vodice, Dobroselle, Graboc i Eperme, Hamidi, Krusheve, Llazareve, Leshkoshiq, Mazgit, Millosheve, Plemetin, Raskove, Siboc, Shipitulle.




Fig.54 Shfrytëzimi I tokës si destinim




Fig.55 Shfrytëzimi I tokës në përqindje




Fig.56 Modeli I zhvillimit hapsinor të Kastriotit

Nga fig.x. shohim se orientimi zhvillimor I Kastriotit bazohet në kompaktësi të vendbanimeve, përderis nuk kemi interakcion me Prishtinën, përpos përmes një rruge të vetme nacionale.


**Baza ekonomike** - Sipas PZHK të Kastriotit 2009 - 2020, shihet se komunën e saj e definojnë si pjesë të Hapësirës së kaltër të regjionit të Prishtinës, përkatësisht në trekëndëshin e Zhvillimit Ekonomike të Kosovës -TZHEK.

Gjiganti i prodhimit të energjisë elektrike në komunën e Kastriotit, e bën të jetë komuna më e ndotur në vend dhe regjion, fakt ky i disfavorshëm për regjion, porse në rast bashkërendimi zhvillimor me Prishtinën në kuadër të regjionit urban, do të kishim sinergji zhvillimore.

Bazat e Njohurive – Nuk parashihet interakcion me pjesën e shkencës dhe të inovacioneve me institucionet prodhuese dhe shërbyese të Kastriotit, me cka do të arrihej me njohuri më të zgjëruara dhe të provuara dhe inovative, përderisa do të kishte për më tepër, stopim të depopullimit, dukuri kjo e cila ndodh në komunën e Kastriotit.

Për më shumë, në rastin e Regjionit Urban të Prishtinës, do të kemi krijim njohurish të reja, shkëmbim të tyre në sfera të ndryshme, përderisa përsëri klasa kreative do të jetë e joshur të qëndrojnë dhe dëshmojnë njohuritë.

Qasshmëria – Në qytetin e Kastriotit, kemi industrinë gjigante të KEK, përderisa transporti për njerëz është vetëm i infrastrukturës rrugore edhe pse ekziston rrjeti I hekurudhës që më parë për transport të thëngjillit dhe nevoja të KEK.



Kjo, është në disfavor sa i përket regjionit urban të Prishtinës me vetë faktin se nuk kemi lidhje të shpejta me transport hekurudhor për pikat e industrisë eksploatuese apo dhe mënyrën tjetër të transportit të qëndrueshëm. Për shkak të depopullimit, do të ishte e favorshme që Kastrioti të mbulojë dukurinë e till, me popullim migrant ditor, me c’rast do t arrihej barazia dhe do të kishim mbrojtje mjedisore në anën tjetër.

*Fig.57. Rrjeti i komunikacionit në Kastriot*

Kualiteti i jetës - Regjioni Urban i Prishtinës, do të përfitojë me funksionet, shërbimet dhe investimet e reja të komunës, me të cilën pritet të rritet kualiteti i jetës. Ndikimet me zhvillime të reja në bashkëveprim do të jenë sinergjike, përderisa shkalla urbane e Regjionit do të rritet, do të kemi shpërndarje të funksioneve sikurse në aspekt fizik dhe atë funksional. Regjioni Urban i Prishtinës do të jetë në mundësi të reja për banim, punë, pushim dhe rekreim, me krijim të hapësirave dhe qasjeve të reja për aktivitete të reja. Në rast të investimeve në mbrojtjen e mjedisit, sfida kjo e Kastriotit porse dhe e Prishtinës për shkak të deponive të hirit, do i shkojnë në favor zgjidhjeve më të shpejta të problemeve në rast të regjionit urban. Këto probleme do të zgjidhen më parë në rast të bashkëveprimit aktiv në planifikim dhe zbatim programesh drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

Diversiteti /Barazia sociale– Duke marrë parasysh se komunat shumëetnike janë më joshëse në kuptim të diversitetit kulturor, prania e komuniteteve joshqiptare në Kastriot prej 15%, mund të kontribuojë në favor të diversitetit kulturor dhe barazisë sociale në rast të regjionit urban të Prishtinës.

Shkalla urbane – Është në favor absolut për regjionin urban të Prishtinës, fakti i të interaktuarit në sfera të ndryshme të Kastriotit me Prishtinën. Funkcionet e përbashkëta implikojnë që këto dy komuna të funksionojnë si një regjion.

Kapacitetet Organizative- Sipas PZHK të Kastriotit nuk mund të thuhet se udhëheqja e Kastriotit shpreh dhe paraqet gadishmëri për forma të reja bashkëpunimi dhe bashkërendimi për zhvillime të ardhshme në kontekst të regjionit urban të Prishtinës.

Përfundim - Kastrioti – *Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Kastriotit bazuar në Planin zhvillimor komunal dhe në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:*

- *Në përgjithësi synimet e komunës së Kastriotit bazuar në Planin zhvillimor janë për një domosdoshmëri zhvillimesh si regjion i përbashkët, i dalë nga PHK i Kosovës, porse në vecanti nuk shprehet përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara për një organizim të ri në funksion të një Regjioni Urban të Prishtinës.*
- *Do të kishte një sinergji të fortë në rats të organizimit në Regjion Urban të Prishtinës, me c’rast problemet e mëdha mjedisore dhe ato demografike do të mund të zgjidheshin në mënyrë më të qëndrueshme, më të shpejtë dhe më të favorshme për regjionin në tërësi.*
- *Si përgjigje ndaj dukurisë më evidente të depopullimit, organizimi i Kastriotit në mënyrë të Regjionit Urban të Prishtinës do të ishte shpresë dhe masë për zbutjen dhe popullimin gradual dhe të qëndrueshëm.*
- *Aktivitetet e njohurive në rast të organizimit si Regjion Urban të Prishtinës, do të mund të ishin shumë aktive dhe produktive, duke marrë parasysh interakcionin me sfidat e mëdha mjedisore të Kastriotit, duke pasur mudnësi për inovacione apo dhe për zbatim praktikash më të mira në botë për çështje të tilla.*
- *Lidhjet urbane-rurale si poliqendra interne për Kastriotin, nuk janë të vlerësuara në kuptim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribonin për regjionin Urban të Prishtinës.;*
- *Infrastruktura hekurudhore e mundshme për zhvillim trafiku të përditshëm nuk është parë si opsion, porse e cila do të duhej të ishte ndër objektivat zhvillimore në kontekst të lidhjeve me Prishtinën dhe qendrat tjera, si përgjigje për mbrojtjen e mjedisit.*

Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative	SKENARI III Komuna e Kastriotit Konteksti i Regjionit Urban të Prishtinës	
	Përshkrimi	Vlerësimi
<b>Baza e Njohurive</b>	Baza më pak se solide e njohurive në komunën e Kastriotit. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës.	(0)
<b>Baza ekonomike</b>	Baza ekonomike e Podujevës është komponentë plotësuese e regjionit urban të Prishtinës në kuptim të ngritjes së përgjithshme ekonomike. Resurset natyrore në rrezik të humbjes dhe degradimit të tyre, sikurse dhe sfida e planifikimi të gjigantit të prodhimit të energjisë elektrike, në rast të mosbashkërenditjes së parashikuar është në disfavor për regjionin urban të Prishtinës. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Kualiteti i jetës</b>	Kualiteti i jetës në rast të pjesëmarrjes së komunës së Kastriotit do të ishte kontribut i madh në Regjion Urban të Prishtinës. Avansimi i shërbimeve publike, shërbimeve të arsimit e atyre sociale janë synim drejt kualitetit më të lartë, me c’rast do përfitojë regjioni urban në tërësi. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Qasshmeria</b>	Qasjet ndërmjet komunës dhe regjionit vihen vetëm përmes rrugës nacionale dhe jo dhe transportit hekurudhor apo dhe ndërlidhjeve tjera urbano rurale e rurale rurale, rrjetit të gjërë në mes të fshatrave. Ky fakt është shumë i disfavorshëm për regjionin urban të Prishtinës. Kriter jo I plotësuar në favor të plotë të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Shkalla urbane</b>	Shkalla urbane , si parametër është me rëndësi për regjionin, porse me vetë analizat e objektivave zhvillimore të komunës së Kastriotit, shohim tentative të vakët, drejt bashkërendimit zhvillimor me regjionin e Prishtinës. Kriter jo I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(-)
<b>Barazia sociale</b>	Barazia sociale do të arrihej dhe më shumë me vetë pjesëmarrjen në regjion të komunës së Podujevës, me rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive. Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Joshja dhe mbajtja e punëtoreve me “Njohuri”-Klasës kreative</b>	Me vetë rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive sikurse dhe të kualitetit të jetës, klasa Kreative do të motivohet të mbesë në komunë, regjion . Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(-)

<b>Krijimi I njohurive të reja; Zhvillimi I “grupimeve” të reja</b>	Sipas objektivave zhvillimore nuk kemi tendenca të bashkëpunimit dhe interakcionit mes akademisë dhe prodhimit, përdërisa dhe mungon tendenca për një grupëzim të tillë në aspektin territorial apo funksionalizimi.  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Vizioni, strategjitë si dokumenta strategjike sikurse dhe në praktikë nuk shihen dhe krijimi e mbështetja e rrjetëzimeve strategjike. Këto të tëra nuk përcaktojnë komunën e Podujevës si pjesë të regjionit urban të Prishtinës, me një bashkërenditje zhvillimore .  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Udheheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udheheqja dhe spektri politik edhe të papërgatitur pr një formë të re të organizimit të territorit në regjion urban të Prishtinës.  Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor		

**Tab. 15. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Kastriotit në Regjion Urban metropolitan të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO**

#### V.III.IV. SKENARI III – SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË PODUJEVËS

Në këtë pjesë do të elaborohet pozita e komunës fqinje të Podujevës, karshi kontributit për një Prishtinë – regjion urban, bazuar në analizën e Planit Zhvillimor Komunal, sipas parametrave të Teorisë së Bazuar në Njohuri, përkatësisht synimeve e objektivave, orientimeve zhvillimore.

Komuna e Podujevës gjendet në pjesën verilindore të Kosovës, në veriperëndim të komunës së Prishtinës., me 628.7 km<sup>2</sup>./90.000 banorë. E tërë pjesa veriore dhe lindore kufizohet me Republikën e Serbisë. Dendësia banimore varet nga vendbanimi, përdërisa në vetë qytetin kemi 4832 banorë/km<sup>2</sup>. Komunën e përbëjnë gjithsej 78 vendbanime, prej të cilave 1 vendbanim është i karakterit urban (Podujeva) me 43000 banorë, ose 35.5%.



**Fig.58. . Pozita gjeografike e Podujevës**



**Fig.59. Peisazh i Fushëgropës së Llapit**

Baza ekonomike - Përdëerisa komuna e Podujevës është për nga madhësia sa dhe komuna e Prishtinës, me migrim ditor në Prishtinë prej më shumë se >15%, mund të konsiderohet si një regjion urban me Prishtinën. Në aspekt ekonomik kontributi I komunës së Podujevës në Regjion Urban të Prishtinës është I madh, duke marrë parasysh resurset ekonomike që ka në në bujqësi posaqërisht, porse dhe me faktin e prezencës së resurseve të ndryshme kulturore e natyrore, të cilat në bashkëveprim si regjion urban do të mund të avansojnë, në mënyrë sinergjike.

Aktivitetet primare/bujqësia në përgjithësi është veprimtari aktive në Podujevë, përderisa dhe tregtia e disa shërbime tjera luajnë rol të rëndësishëm dhe e mbajnë në jetë ekonominë lokale të komunës së Podujevës. Rreth 55 % apo 34191.38 ha është tokë e punueshme që e përbëjnë arat, kopshtet, livadhet dhe tokat djerrin.




Fig.60. Destinimi I sipërfaqeve




Fig.61. Pjesëmarrja e tokës së punueshme

Në rastin e regjionit urban të Prishtinës, komuna e Podujevës do të kontribuonte me pjesëmarrje aktive me bujqësi, prodhime të shumta vendore, me c’rast tregu për to do të ishte regjioni urban I Prishtinës si shkallë e parë përderisa përmes RUM ato do të lansoheshin dhe më tej. Mund të thuhet se nuk kemi interakcion me institucionet shkencore e hulumtuese për avansim të bujqësisë.

Bazat e Njohurive – Baza e njohurive në komunën e Podujevës ekziston, rrjeti i shkollave është i shtrirë gjithandej nëpër vendbanime dhe do të jetë në favor të Regjionit Urban të Prishtinës. Si regjion Urban i Prishtinës do të mund të krijohej një konglomerat i mirë sa i përket përvojave në komunën e Podujevës dhe njohurive ne Prishtinë. Sipas synimeve dhe objektivave për zhvillim të arsimit, ky sektor do të jetë në avansim e sipër.

Aktivitetet e njohurive do të mund të zhvilloheshin shumë më shumë me mbështetjen e shumë institucioneve shkencore e hukumtuese të cilat do të mund të zhvillojnë dhe më shumë sektorin e ekonomisë primare me aplikimin e përvojave të mira në botë dhe përvojës lokale të shumtë regjion urban të Prishtinës.

**Qasshmëria** – Komuna e Prishtinës dhe ajo e Podujevës është e lidhur me rrjetë të rrugës nacionale dhe me hekurudhë, porse për momentin jofunksional tërësisht. Ky transport I vjetruar dhe I lënë, I përdorë vetëm për transport të mallrave dhe jo edhe për transport të përditshëm dhe efikas dhe të njerëzve, nuk është I favorshëm në këtë gjendje për regjion urban të Prishtinës. Parashihen investime dhe avansime teknologjike e shërbyese porse me të cilat do të rritej cilësia e shërbimeve dhe parametri i qasshmërisë do të ishte në nivel më të lartë. Transporti public si shërbim është ekzistent në 77% të vendbanimeve. Fakti në disfavor është mos pasja si prioritet rrjeti I rrugëve mes fshatrave të komunës të cilat do të shërbenin si poliçendra për shpërndarje funksionesh dhe tregu.




Fig.62. Rrjeti i rrugëve




Fig.63. Qasja në transport publik

**Kualiteti i jetës** - Sipas PZHK të Podujevës është paraparë rritja e cilësisë së jetës, me c' rast do të kontribonte direkt në rritjen e cilësisë së jetës të regjionit urban të Prishtinës. Regjioni Urban i Prishtinës, do të përfitojë me funksionet, shërbimet dhe investimet e reja të komunës, ndikimet e të cilave në bashkëveprim do të jenë sinergjike me rritjen e shkallës urbane të Regjionit urban, ku do të kemi shpërndarje të funksioneve sikurse në aspekt fizik dhe atë funksional.



Regjioni Urban i Prishtinës do të jetë në mundësi të reja për banim, punë, pushim dhe rekreim, me krijim të hapësirave dhe qasjeve të reja për aktivitete të reja. Në rast të investimeve në mbrojtjen e mjedisit trashëgimisë natyrore dhe kulturore, do t'i shkojë në favor zgjidhjeve më të shpejta të problemeve dhe rritjes së atraktivitetit në rast të regjionit urban.

Prezenca e liqenit të Batlavës brenda regjionit urban, kontribon për më shumë në joshjen e vizitorëve dhe të klasës kreative në regjion urban të Prishtinës.

Diversiteti – Duke qenë komunë e Podujevës – komunë me shkallë të lartë urbane, qendër e rëndësishme që prej kohës së Dardanisë e në kohën romake si “Vendenis” (Gllamniku i sotëm), kemi relikte të shumta arkeologjike të cilat vetëm sa e shtojnë diversitetin kulturor dhe arkeologjik të regjionit urban dhe me këtë shtojnë potencialet për investime të shumta në kontekst të avansimit të kulturës.

Këto mbetje arkeologjike janë prezentë në shumë vendbanime të komunës por ato që kanë mbetje



me të theksuar dhe që sot ende ekzistojnë janë në: Gllamnik, Teneshdoll, Surkish, Popovë, Ballofc etj.

*Fig.64 Liqeni i Batlavës<sup>31</sup>*

Në anën tjetër llojlojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik në Komunës së Podujevës, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore që kanë përhapje në territorin e komunës, konsiderohen vlera të një trashëgimie natyrore.

Shkalla urbane – Organizimi në formë të re të Regjionit Urban do të kishte për favor inkuadrimin e komunës së Podujevës në sfera të ndryshme. Në rastin e Podujevës, arsye dominante për yë qenë një regjion urban është numri përmbi 15% e punëtorëve që migrojnë në Prishtinë, dhe duke marrë parasysh se është komunë në kufi me shtetin tjetër, kjo do t'levërdiste dhe komunës së Podujevës duke u integruar në një zonë më të gjërë bashkëpunim regional.

Kapacitetet Organizative- Sipas PZHK të Podujevës, nuk mund të thuhet se udhëheqja e Podujevës shpreh dhe paraqet gadishmëri për forma të reja bashkëpunimi dhe bashkërendimi për zhvillime të ardhshme në kontekst të regjionit urban të Prishtinës.

*Përfundim - Podujeva – Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Podujevës, bazuar në Planin zhvillimor komunal dhe në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:*

- *Synimet e komunës së Podujevës bazuar në Planin zhvillimor nuk paraqesin gadishmëri dhe domosdoshmëri zhvillimesh si regjion urban të përbashkët, me regjionin e Prishtinës, përderisa poashtu kjo komunë orientimet zhvillimore të dala nga PHK 2010 – 2025 e Kosovës i napin detyrë strategjike që të kenë zhvillim koherent dhe në bashkëveprim me regjionin urban të Prishtinës. Në vecanti nuk shprehet përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara për një organizim të ri në funksion të një Regjioni Urban të Prishtinës.*
- *Do të kishte një sinergji të fortë në rast të organizimit në Regjion Urban të Prishtinës, dhe me pjesëmarrjen e komunës së Podujevës, meqenëse problemet dhe sfidat si në infrastrukturë, zhvillim ekonomik e social, zhvillim kulturor të tërëishëm do të ndihmonin njëra tjetrën. Me këtë rast sfidat zhvillimore, mjedisore dhe ato demografike do të mund të zgjidheshin në mënyrë më të qëndrueshme, më të shpejtë dhe më të favorshme.*
- *Aktivitetet e njohurive në rast të organizimit si Regjion Urban të Prishtinës, do të mund të ishin shumë më aktive dhe produktive, duke marrë parasysh interakcionin me zhvillimin e bujqësisë në Podujevë, duke pasur mundësi për inovacione apo dhe për zbatim praktikash më të mira në botë për çështje të tilla.*
- *Lidhjet urbane-rurale si poliqendra interne për Podujevën, nuk janë të parapara dhe vlerësuara në kuptim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribonin për regjionin Urban të Prishtinës.;*
- *Infrastruktura hekurudhore e mundshme për zhvillim trafiku të përditshëm nuk është parë si opsion, porse i cili do të duhej të ishte ndër objektivat zhvillimore në kontekst të lidhjeve me Prishtinën dhe qendrat tjera, si përgjigje për mbrojtjen e mjedisit, nuk kemi një rast të tillë, me cka është në disfavor të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri duke marrë parasysh mundësitë për zhvillim të transportit të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit etj.*

Përfundime për Skenarin 3– Zhvillimi urban i Prishtinës si Regjion Urban Metropolitan sw bashku me komunat e tjera fqinje (Lipjan, Kastriot, Fushw Kosovw dhe Podujevw).

**Përfundim - Fushë Kosova – Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Fushë Kosovës bazuar në Planin zhvillimor komunal dhe në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:**

- Në përgjithësi synimet e komunës së Fushë Kosovës bazuar në Planin zhvillimor të saj janë për një domosadoshmëri zhvillimesh si regjion i përbashkët, i dalë nga PHK i Kosovës, porse në vecanti kjo nuk shihet e shprehu përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara.
- Lidhjet urbane-rurale si poliqendra interne për Fushë Kosovën janë të neglizhurara në kutpim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribonin për regjionin Urban të Prishtinës.
- ANP dhe zona përreth nuk është parë si një sfidë reale për komunën, ndoshta dhe aset rreth së cilës do të mund të zhvillohej komuna dhe për të cilën do të mund të punontë për më shumë. Ajo është lënë si e vecantë dhe jo integruar në zhvillimet e ardhshme;
- Infrastruktura hekurudhore e cila e determinon komunën si të tillë, do të duhej të dominonte në objektivat zhvillimore, porse nuk kemi një rast të tillë. Zhvillimi i saj i është lënë nivelit më të lartë apo dhe është neglizhuar për tu marrë niveli lokal me të. Kjo nuk i shkon në favor të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri duke marrë parasysh mundësitë për zhvillim të transportit të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit etj.
- Infstruktura rrugore është ajo më e potencuara dhe për më shumë e paraparë për t'u zhvilluar në të ardhmen, kjo jo shumë e favorshme për Regjionin Urban të Prishtinës

**Përfundim - Kastrioti – Me këtë analizë të orientimeve zhvillimore të Kastriotit bazuar në Planin zhvillimor komunal dhe në raport me kontributin drejt Regjionit Urban të Prishtinës mund të konkludohet se:**

- Në përgjithësi synimet e komunës së Kastriotit bazuar në Planin zhvillimor janë për një domosadoshmëri zhvillimesh si regjion i përbashkët, i dalë nga PHK i Kosovës, porse në vecanti nuk shprehet përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara për një organizim të ri në funksion të një Regjioni Urban të Prishtinës.
- Do të kishte një sinergji të fortë në rats të organizimit në Regjion Urban të Prishtinës, me c'rast problemet e mëdha mjedisore dhe ato demografike do të mund të zgjidheshin në mënyrë më të qëndrueshme, më të shpejtë dhe më të favorshme për regjioni në tërësi.

- Si përgjigje ndaj dukurisë më evidente të depopullimit, organizimi i Kastriotit në mënyrë të Regjionit Urban të Prishtinës do të ishte shpresë dhe masë për zbutjen dhe popullimin gradual dhe të qëndrueshëm.
- Aktivitetet e njohurive në rast të organizimit si Regjion Urban të Prishtinës, do të mund të ishin shumë aktive dhe produktive, duke marrë parasysh interakcionin me sfidat e mëdha mjedisore të Kastriotit, duke pasur mundësi për inovacione apo dhe për zbatim praktikash më të mira në botë për çështje të tilla.
- Lidhjet urbane-rurale si poliçendra interne për Kastriotin, nuk janë të vlerësuara në kuptim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribuonin për regjionin Urban të Prishtinës.;
- Infrastruktura hekurudhore e mundshme për zhvillim trafiku të përditshëm nuk është parë si opsion, porse e cila do të duhej të ishte ndër objektivat zhvillimore në kontekst të lidhjeve me Prishtinën dhe qendrat tjera, si përgjigje për mbrojtjen e mjedisit.
  
- Synimet e komunës së Podujevës bazuar në Planin zhvillimor nuk paraqesin gadishmëri dhe domosdoshmëri zhvillimesh si regjion urban të përbashkët, me regjionin e Prishtinës, përderisa poashtu kjo komunë orientimet zhvillimore të dala nga PHK 2010 – 2025 e Kosovës i napolin detyrë strategjike që të kenë zhvillim koherent dhe në bashkëveprim me regjionin urban të Prishtinës. Në vecanti nuk shprehet përmes objektivave dhe programeve e projekteve aktuale dhe të parashikuara për një organizim të ri në funksion të një Regjioni Urban të Prishtinës.
- Do të kishte një sinergji të fortë në rast të organizimit në Regjion Urban të Prishtinës, dhe me pjesëmarrjen e komunës së Podujevës, meqenëse problemet dhe sfidat si në infrastrukturë, zhvillim ekonomik e social, zhvillim kulturor të tërëishëm do të ndihmonin njëra tjetrën. Me këtë rast sfidat zhvillimore, mjedisore dhe ato demografike do të mund të zgjidheshin në mënyrë më të qëndrueshme, më të shpejtë dhe më të favorshme.
- Aktivitetet e njohurive në rast të organizimit si Regjion Urban të Prishtinës, do të mund të ishin shumë më aktive dhe produktive, duke marrë parasysh interakcionin me zhvillimin e bujqësisë në Podujevë, duke pasur mundësi për inovacione apo dhe për zbatim praktikash më të mira në botë për çështje të tilla.
- Lidhjet urbane-rurale si poliçendra interne për Podujevën, nuk janë të parapara dhe vlerësuara në kuptim të policentricitetit, porse të cilat do të kontribuonin për regjionin Urban të Prishtinës.;
- Infrastruktura hekurudhore e mundshme për zhvillim trafiku të përditshëm nuk është parë si opsion, porse i cili do të duhej të ishte ndër objektivat zhvillimore në kontekst të lidhjeve me

*Prishtinën dhe qendrat tjera, si përgjigje për mbrojtjen e mjedisit, nuk kemi një rast të tillë, me cka është në disfavor të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri duke marrë parasysh mundësitë për zhvillim të transportit të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit etj.*

Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative	SKENARI III Komuna e Podujevës Konteksti i Regjionit Urban të Prishtinës	
	Përshkrimi	Vlerësimi
<b>Baza e Njohurive</b>	<p>Baza solide e njohurive në komunën e Podujevës sikurse dhe parashikimet për zhvillimin e tyre, janë të favorshme për Regjionin Urban të Prishtinës. Kjo do' l hapë horizontete klasës creative për më shumë diversitet dhe shkëmbime përvojash më këtë komunë, sikurse dhe përmes ngritjes së arsimit të avansojë bazën ekonomike. Objektivat zhvillimorë të komunës janë argumente mbështetëse për konkluzion.</p> <p>Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës</p>	(+)
<b>Baza ekonomike</b>	<p>Baza ekonomike e Podujevës është komponentë plotësuese e regjionit urban të Prishtinës në kuptim të ngritjes së përgjithshme ekonomike. Resurset natyrore, bujqësore dhe ato tregtare janë për t' u cmuar dhe avansuar në kuptim të avansimit dhe të konkurrimit të RUM të Prishtinës në kontekst më të gjërë ndërkombëtar.</p> <p>Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës</p>	(+)
<b>Kualiteti i jetes</b>	<p>Kualiteti i jetës në rast të pjesëmarrjes së komunës së Podujevës do të ishte kontribut i madh në Regjion Urban të Prishtinës. Avansimi i shërbimeve publike, shërbimeve të arsimit e atyre sociale janë synim drejt kualitetit më të lartë, me c' rast do përfitojë regjioni urban në tërësi.</p> <p>Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës</p>	(+)
<b>Qasshmeria</b>	<p>Qasjet ndërmjet komunës dhe regjionit vihen vetëm ëprmes rrugës nacionale dhe jo dhe transportit hekurudhor apo dhe ndërlidhjeve tjera urbano rurale e rurale rurale, rrjetit të gjërë në mes të fshatrave</p> <p>Kriter jo I plotësuar në favor të plotë të regjionit urban të Prishtinës</p>	(-)
<b>Shkalla urbane</b>	<p>Shkalla urbane , si paretmetër është me rëndësi për regjioni, porse me vetë analizat e objektiave zhvillimorë të komunës së Podujevës nuk shohim tentativë drejt bashkërendimit zhvillimor me regjioni e Prishtinës</p> <p>Kriter jo I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës</p>	(-)
<b>Barazia sociale</b>	<p>Barazia sociale do të arrihej dhe më shumë me vetë pjesëmarrjen në regjion të komunës së Podujevës, me rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive.</p> <p>Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës</p>	(+)

<b>Joshja dhe mbajtja e punetoreve me "Njohuri"-Klasës kreative</b>	Me vetë rritjen e bazës ekonomike dhe të njohurive sikurse dhe të kualitetit të jetës, klasa Kreative do të motivohet të mbesë në komunë, regjion . Kriter I plotësuar pjesërisht në favor të regjionit urban të Prishtinës	(0)
<b>Krijimi I njohurive te reja;Zhvillimi I "grupimeve" të reja</b>	Sipas objektivave zhvillimorë nuk kemi tendenca të bashkëpunimit dhe interakcionit mes akademisë dhe prodhimit, përderisa dhe mungon tendenca për një grupëzim të tillë në aspekt territory apo funksionalizimi. Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(-)
<b>Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike</b>	Vizioni, strategjitë si dokumenta strategjikë sikurse dhe në praktikë nuk shihen dhe krijimi e mbështetja e rrjetëzimeve strategjike. Këto të tërat nuk përcaktojnë komunën e Podujevës si pjesë të regjionit urban të Prishtinës, me një bashkërenditje zhvillimore . Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
<b>Udheheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore</b>	Udheheqja dhe spektri politik edhe të papërgatitur pr një formë të re të organizimit të territorit në regjion urban të Prishtinës. Kriter JO I plotësuar në favor të regjionit urban të Prishtinës	(--)
--Shumë në disfavor; - mesatarisht disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor		

Tab. 16. Tabela e vlerësimeve të skenarit III –Kontributit të Podujevës në Regjion Urban metropolitan të Prishtinës sipas teorive të ZHBNJ/KO

## KAPTINA VI. REZULTATET, KONKLuzionET, SUGJERIMET DHE REKOMANDIMET

Në këtë kaptinë do të elaborohen rezultatet nga analizat dhe vlerësimet e bëra në rastin e tri tri skenarëve zhvillimorë të Prishtinës drejt synimit për një Zhvillim të Bazuar në Njohuri.

I) *Skenari I zhvillimit monocentrik* – sipas trendit aktual të zhvillimit të Prishtinës drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri;

II) *Skenari i zhvillimit policentrik* – sipas Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës 2013 – 2023 dhe Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013 – 2025

III) *Skenari I zhvillimit si Regjion Urban Metropolitan I Prishtinës* – sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010 – 2020+ dhe Planeve Zhvillimore Komunale të komunave pjesëmarrëse: Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë.

## VI.I. REZULTATET

Në këtë pjesë do të elaborohen fillimisht përmbledhjet e përfudnimeve përshkruese për cdo skenar zhvillimor, e cila mëpastaj do të pasojë me tabelën e përmbledhur të vlerësimeve kuantitative të skenarëve sipas parametrevë të Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Pas gjithë rezultateve do të vazhdohet me përgjigjet e pyetjeve të hulumtimit dhe vërtetimit të hipotezave, sipas rezultateve të gjetura, për të vazhduar me rekomandime dhe sugjerime në pjesën e fundit të kaptinës së gjashtë.

Kriteret e Teorisë së Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe të Kapaciteteve Organizative	Skenari I- Zhvillimi monocentrik	Skenari II- Zhvillimi policentrik	Skenari III - Zhvillimi si RUM sipas komunave			
			Lipjani	FK	Kastrioti	Podujeva
Baza e njohurive	(+)	(++)	(+)	(+)	0	(+)
Baza ekonomike	(-)	(+)	0	0	(--)	(+)
Kualiteti i jetes	(+)	(++)	(+)	(+)	0	(+)
Qasshmeria	(--)	0	(0)	(0)	(-)	(0)
Shkalla urbane	(--)	(+)	0	(+)	(-)	(-)
Barazia sociale	(o)	(+)	(+)	(+)	0	(+)
Joshja dhe mbajtja e punetoreve me “Njohuri”-Klasës kreative	(+)	(++)	(+)	(+)	(-)	0
Krijimi i njohurive të reja; Zhvillimi I “grupimeve” të reja	(+)	(+)	(+)	(+)	0	(-)
Vizioni dhe strategjia Rrjetet strategjike	(--)	0	(--)	(--)	(--)	(--)
Udheheqja /Mbeshtetja politike/ Mbeshtetja shoqerore	0	0	(--)	(--)	(--)	(--)
--Shumë në disfavor; - mesatarisht në disfavor; 0 – neutral; + në favor; ++ shumë në favor						

**Tab. 17.** Tabela e rezultateve nga të tri skenarët



Në tabelën e mësipërme paraqiten rezultatet nga vlerësimi I skenarëve zhvillimorë të qytetit të Prishtinës në mënyrë aktuale monocentrike, të parashikuar dhe të planifikuar me dokumente strategjikë hapsinorë – skenari policentrik dhe I skenarit të tretë – të zhvillimit të bazuar në regjion urban metropolitan së bashku me katër komunat fqinje, bazuar në planet zhvillimore të katër qyteteve fqinje: Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë.

Vlerësimi është bërë në rangun e nivelit të kuantifikimit prej -2 si shumë të disfavorshme për qytetin e Prishtinës në kontekst të zhvillimit të bazuar në njohuri deri tek niveli +2 – si shumë të favorshme për zhvillimin e qytetit të Prishtinës me zhvillim të bazuar në njohuri.

Kjo tabelë mëpastaj është përkthyer në grafik, me të cilin paraqiten krahasimet e tri skenarëve zhvillimorë të qyteti të Prishtinës drejt zhvillimit të bazuar në njohuri: zhvillimi : monocentrik, policentrik dhe si regjion urban metropolitan.

Në grafikun e mëposhtëm (Shih fig.63) shohim se skenari I zhvillimit monocentrik aktual të Prishtinës në krahasim me atë policentrik të planifikuar është më I disfavorshëm.

Parametrat “shumë të disfavorshëm të nivelit -2” në skenarin monocentrik janë:

Shkalla urbane, Qasshmëria dhe Vizioni e Strategjia/Rrjetëzimi strategjik për funksionim të Regjionit urban Metropolitan, përdrerisa këto luajnë shumë ndikim në bazën ekonomike e cila është e vetmja me këtë rast I nivelit negative ende – të disfavorshëm për për funksionim të Regjionit urban Metropolitan.

Parametrat e tjerë janë neutral si barazia sociale e cila nuk ndikohet nga cilido aspekt aspekt zhvillimi porse parametrat pozitiv janë : Baza e njohurive, kualiteti I jetës, joshja dhe mbajtja e punëtorëve të klasës kreative dhe të krijimit të njohurive përmes grupëzimeve të reja.,

Kjo paraqitet dhe në grafikun më poshtë të paraqitur (Shih. Fig.65).

Në skenarin e zhvillimit policentrik kemi vetëm rezultate pozitive në përgjithësi sa I përket zhvillimit të bazuar në njohuri të Prishtinës, përderisa ato rezultatet negative të vetmet si: Qasshmëria, Shkalla urbane, Vizioni dhe baza ekonomike të cilat dhe do të duhej të përktheheshin në detyra për të ardhmen, objektiva për përmirësim të metodologjisë për arritjen e synimit të të qenit qytet metropolë – drejt zhvillimit të bazuar në njohuri.




Fig. 65. Rezultatet nga krahasimi I skenarëve të zhvillimit monocentrik dhe policentrik

Në vazhdim do të paraqesim në grafik dhe krahasimin mes tri skenarëve, për të parë se ku do të duhej të përqëndrohemi për më shumë në të ardhmen, drejt synimit për një qytet metropolitan të Prishtinës, drejt Zhvillimit të bazuar në Njohuri.




Fig. 66. Rezultatet nga krahasimi I skenarëve të zhvillimit monocentrik, policentrik dhe RUM

Prej grafikut të mësipërm shohim se dy parametrat negativë, me këtë rast janë: Vizioni dhe strategjia, Rrjetet strategjike sikurse dhe Udheheqja /Mbështetja politike/ Mbështetja shoqërore, me të cilat konkludohet se:

Për një bazë më të mirë ekonomike, qytetit të Prishtinës I duhet shkallë e lartë urbane – madhësi më e madhe territoriale, e cila do të mund të arrihej vetëm me involvimin e qyteteve tjera fqinje të qytetit të Prishtinës, në një regjion urban të përbashkët, për një zhvillim të përbashkët. Në këtë rast kemi sfidat kryesore të cilat do të duhej të tejkalohen si:

Vizioni dhe strategjitë zhvillimore si dokumente porse dhe si qasje do të duhej të përgatiten dhe mbështeten për më shumë nga të gjitha qytetet; Kjo do të nënkuptonte që rrjetet strategjike do të duhej të shihen si rrugëdalje për një zhvillim të përbashkët si regjion, me bashkëpunime të mundshme taktike dhe funksionale;

Udhëheqja /Mbështetja politike, me këtë rast do të duhej të mbështeste dokumentat strategjikë të të gjitha qyteteve përderisa mbështetja shoqërore do të duhej të jetë poashtu e zëshme dhe e fuqishme.

Këto do të duhej të shihen si prioritete funksionale, përderisa sa I përket komponentës fizike të ndërhyjeve dhe të investimeve të mundshme do të ishin sipas prioritetit:

Qasshmëria – me të cilën nënkuptohet investime kapitale në infrastrukturë fizike të komunikimit ndërrurban dhe urbano – rural. Prioritet gjithashtu apo si ndërlidhësëmri është qasje e shpërndarjes së konceptit të policentricitetit në kuptimin urban – rural të shpërndarjes së funksioneve të shumta shërbyese e ekonomike, arsimore, në secilën nga qytetet gjithashtu.

## **VI.II. KONKLuzionet**

---

Në këtë pjesë do të konkludohet/vërtetohen hipotezat dhe pyetjet e hulumtimit në këtë studim, për të vazhduar me rekomandime dhe sygjerime:

- 1. Vërtetohet hipoteza e parë se: Qyteti i Prishtinës, me pozitën dhe potencialet e saj ekzistuese sikurse dhe me trendin e migrimit ditor të punës nga regjioni, pa bashkëpunim e zhvillim të ngushtë urbano-rural me fshatrat e komunës dhe pa bashkëpunim për zhvillim koherent ndërkomunal me komunat tjera fqinje (Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë), nuk do të mund të plotësojë konditat drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.*
- 2. Vërtetohet hipoteza e dytë se: Qyteti i Prishtinës në rast organizimi dhe funksionimi si Regjion Urban Metropolitan, mund të përmbushë kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri. Për më shumë ky është dhe organizim dhe i cili është i rekomanduar sipas dokumentit strategjik kombëtar të Kosovës dhe nomenklaturës së OECD për definim regjionesh urbane.*

Qyteti i Prishtinës me trendin e saj zhvillimor aktual monocentrik porse dhe të planifikuar policentrik, nuk mund të funksionojë drejt objektivave të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, pa

pjesëmarrjen aktive të fshatrave dhe komunave fqinje në aspekt policentriciteti. Kjo për më shumë meqë parametrat kryesorë kyq nuk përmbushen: Shkalla urbane, baza ekonomike, baza e njohurive, qasshmëria, krijimi i grupëzimeve të reja, kualiteti i jetës, joshja e klasës kreative.

Qyteti i Prishtinës me skenar të zhvillimit si regjion urban metropolitan, me pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të fshatrave dhe komunave fqinje në vendimmarrje dhe bashkëpunim të ngushtë, do të përmbushë kriteret drejt caqeve të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri.

### **VI.III. REKOMANDIMET, SUGJERIMET**

---

Ky lloj zhvillimi urban e hapsinor për qytetin e Prishtinës si Regjion Urban Metropolitan, do të jetë i krahasueshëm me nomenklatura evropjane të OECD-Organizatës Evropjanë për Bashkëpunim dhe Zhvillim, do të jetë i krahasueshëm me regjione tjera, do të mund të aplikojë për fonde zhvillimore strukturale evropjane për regjione, në sfera të ndryshme zhvillimore. Ky lloj organizimi metropolitan kërkon qasje të re dhe qeverisje bashkëpunimi të formave të ndryshme të përvojave të ndryshme në botë, të suksesshme dhe të rekomanduara<sup>32</sup>.

*Baza ekonomike* – Me skenarin e zhvillimit si Regjion urban Metropolitan të Prishtinës në bashkëpunim me komunat fqinje, niveli i zhvillimit të bazës ekonomike do të jetë shumë më stabile, i larmishëm dhe i gatshëm për konkurrencë më të gjërë në rajon, përderisa në bashkëpunim të ngushtë me fshatrat dhe komunat fqinje, tregu i punës do të jetë më i zgjëruar, tregu i patundshmërive do të jetë më real dhe konkurent, do të hapen mundësi të reja bashkëpunimi ndërkomunal, shkëmbimi institucional, krijimi dhe aplikimi të njohurive mes akademisë dhe prodhimit, shkëmbimit të përvojave dhe rrjetëzimeve të reja.

Me skenarin e Regjionit Urban Metropolitan, me formë të re organizimi dhe qeverisjeje do të mund të kemi statistika të rregullta valide, të vlefshme e të pranueshme e të monitorueshme për organizma statistikor në Evropë (OECD, BB) të krahasueshme me regjione urbane tjera në Evropë dhe botë. Prishtina – regjion Urban Metropolitan do të mund të hyjë në grupin e aplikimit për fonde të reja strukturore evropjane, iniciativa të reja që mbështesin sfera të ndryshme sektorale, sociale dhe ekonomike, mjedisore si çështje sfiduese të kohës.

*Bazat e Njohurive* - Me skenarin e zhvillimit si Regjion urban Metropolitan të Prishtinës në bashkëpunim me komunat fqinje, niveli i bazës së njohurive - kualiteti i saj i varur drejtpërdrejtë fizik do të ishte më i favorshëm për shkak të kushteve më të mira për punë, jetë dhe rekreim të klasës kreative, studentëve dhe stafit akademik, artistëve e ndërmarrësve me njohuri të reja.

---

<sup>32</sup> *Vand den Berg at all, "Governing Metropolitan Urban Regions", 2006, Rotterdam*

Në rastin e Regjionit Urban Metropolitan do t'ë kemi më shumë mundësi për rrjetëzime dhe bashkëpunime sinkrone në mes të institucioneve shkencore dhe prodhuese, me shkëmbime të njohurive dhe përvojave në nivel regjional e ndërkombëtar;

*Qasshmëria* – Me skenarin e zhvillimit si Regjion urban Metropolitan të Prishtinës në bashkëpunim me komunat fqinje – parametri i qasshmërisë duhet të jetë prioritar, me të cilin do të kemi avantazhe të shumta të ndërlidhjeve të ngushta ndërkomunale, me mundësi të vendimmarrjes drejt zhvillimit të zonës rreth ANP-Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe HK - Stacionit Qendror Hekurrudhor, edhepse gjenden jashtë komunës së Prishtinës.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës do të duhej të shiqohej si inkubator për joshjen dhe grumbullimin e kompanive multinacionale, të cilët do të investonin në regjionin e Prishtinës, përderisa masat fiskale do të duhej të jenë sikronë, për të joshur ata dhe në aspekt financiar. Kontrolli i zhvillimeve në këtë zonë të ANP do të duhej të ishte apsolutisht në favor të investimeve të KMN – kompanive multinacionale, përderisa shërbime rreth tyre të avansojnë dhe të jenë në shërbime të shërbimit të Portit Ajror të Kosovës.

Për sa i përket ndërlidhjeve urbano-rurale, ato duhet të fuqizohen në nivelin e të qenit poliçendra urbane. Fshatrat duhet të lishen dhe funksionojnë shumë më shumë të lidhura mes vete dhe jo vetëm përmes lidhjeve të rrugëve nacionale – Prishtinës, të ndërlidhura fuqishëm dhe mes vete në një rrjet jo vetëm rrugor, i cili do të ishte një avantazh i madh në përgjithësi për racionalizim territori, mbrojtje të mjedisit .

Syacioni qendror hekurudhor do të duhej të jetë sa më në afërsi të qendrës së qytetit të Prishtinës, të propozuar me Planin Zhvillimor Urban të Prishtinës, aty ku qytetari do t'i ketë vajtje ardhjet e lehta, të sigurta dhe pa nevojë të përdorimit të transportit tjetër për në qendër të Prishtinës, prej ku do të mund përmes transportit të jomorizuar, në këmbë apo me bicikleta të vazhdojë për nyjet kryesore të zhvillimit kulturor e tregtar të qytetit të Prishtinës, qendrës historike, qendrës së studentëve. Kjo do e shkarkonte trafikun urban brenda qytetit, do të eliminonte nevojën për mënyrë tjetër transporti nëpërm qytet. Rrjeti i hekurudhës duhet të përdoret dhe për me shumë për cargo apo transport mallrash., sidomos të shkarkuar prej aeroportit e deri tek destinimet kryesore në vend, regjion.

*Kualiteti i jetës* – Në rast të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës, me mundësi të reja zhvillimore dhe mbështetje më të gjërë, do të përmirësohej kualiteti i jetës në qytet dhe në regjion. Mundësitë në këtë rast janë më të mëdha për zhvillime inovative fizike, hapësira të reja e të hapura publike, për pushim e sport, llojllojshmëri ambientesh të cilat janë vlerë e shtuar për

kualitet të jetës. Në rast të rritjes së bazës ekonomike me skenar të regjionit urban metropolitan, shërbimet do të jenë më kualitative dhe me të , kualiteti i jetës do të rritej gjithashtu. Klasa kreative me këtë rast do të jetë më prezent në qytet- regjion urban metropolitan, përdërisa diversiteti kulturor me këtë rast poashtu do të integrohej si në favor të Prishtinës – metropolitane.

Shkalla urbane/Diversiteti kulturor – Në rast të Regjionit Urban Metropolitan të Prishtinës, shkalla urbane do të jetë më e lartë, në favor për një qytet metropolitan të Prishtinës, kriter ky i cili shkon së bashku dhe me laramaninë e mundësive të ndryshme kulturore lokale, në një mjedis koherent metropolitan, me mundësi të njëjta për të përfaqësuar kulturat me vecoritë e tyre të ndryshme artizanale, gastronomike e turistike, atraktive për klasën kreative dhe për vizitorët e shumtë në qytet – regjion metropolitan të Prishtinës.

Aktivitetet e njohurive – Në rast të RUM të Prishtinës do të kemi aktivitete më të larmishme me mundësi grupëzimesh të shumta, më joshëse për ‘Klasën Kreative’, krijimin e iniciativave të reja për njohuri të reja, kombinime të reja, grupime në rritje e sipër, në sferën e kulturës, shkencës e teknologjisë. “*Kapacitetet Organizative*” - të qytetit të Prishtinës mund të thuhet se janë në fazën e tyre tranzicionale, porse ngadalë në përmirësim e sipër, në tentativë të zënive të tredeve aktuale në qeverisje të mirë etj.

Prishtina duke qenë në tranzicion, për të arritur synimin e qytetit -Regjion Urban Metropolitan drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, duhet ndërmarrë masa sipas prioritetit:

Bazat e Njohurive - Në rastin e RUM të Prishtinës, baza e njohurive do të kishte shumë më shumë mundësi për avansim, sikurse në sferën fizike e të kualitetit hapsinor, porase dhe atë profesional, meqë klasa kreative akademike, me avansim të bazës ekonomike do të jetë më e joshur të mbetet në regjion e jo të largohet gjetëk, prej nga do kemi dhe në këtë aspekt konkurrencë. Rrjetëzimi i institucioneve edukative me ato shkencore e prodhuese për më tepër, në kuptim të bashkërendimit të aktiviteteve, për të mirën e zhvillimit të gjithmbarshëm do të ishte e rekomanduar. Ndërmarrja e veprimeve për mbajtjen dhe ngritjen e kualitetit të bazës së njohurive, përmes investimeve në arsim të lartë, hulumtimeve të vazhdueshme për aplikim në praktikë nga autoriteti lokal, hulumtime sipas nevojave aktuale që tentojnë përmbushjen e standardeve të larta dhe koncepteve më të reja për zhvillim.

Kapacitetet Organizative –Mbështetja politike dhe ndërgjegjësimi për nevojën e një organizimi të ri bashkëpunues e qeverisës ndërkomunal në mes komunave (Prishtinës, Lipjanit, Fushë Kosovës, Kastriotit dhe Podujevës) do të duhej të jetë shumë i fuqishëm dhe aktiv.

Riadaptimi i planeve zhvillimore komunale dhe urbane të Prishtinës, sikurse në kuptim të formave të reja zhvillimore më të favorshme për funksionim metropolitan, janë të nevojshme. Aplikimi për fonde evropjane në mbështetje të Regjioneve Urbane Metropolitane, do të duhej të përdorej si stimulim për sfida të reja bashkëpunimi. Kjo për më shumë do të përfronte drejt përmbushjes së kriterëve për qeverisje të mirë, demokraci, transparencë dhe gjithpërfshirje në vendimmarje.

Do të duhej që poashtu të merreshin hapa konkret në vetëdijësimin për mundësitë e reja për format e partneritetit privat dhe publik, gjetjen e formave për zbatim të bashkëpunimit dhe në sfera të investimeve të mëdha kapitale urbane, infrastrukturore e të shërbimeve publike.

### *Sygjerimet e përgjithshme*

---

- I. Shtetet në tranzicion duhet të promovojnë dhe mbështesin Regjionet Urbane Metropolitane si formë të organizimit të qeverisjes së re të mirë, formë të organizimit institucional dhe organizimit hapsinor drejt Zhvillimit të Bazuar në Njohuri, sepse ky është zhvillimi të cilin e kanë sot shumë regjione të sukseshme në Evropë, është përmbushje e Agjendës së Lisbonës dhe është zhvillim i paevitueshëm herët a vonë dhe për qytetet tona.*
- II. Shtetet, qytetet në tranzicion duhet të promovojnë qasjet e reja në planifikim hapsinor strategjik për planet e tyre zhvillimore. Me këtë planifikim qytetet do të fitonin në kohë dhe do të kursenin deri në një masë resurset natyrore, përderisa kapacitetet e tyre organizative udhëheqëse lokale do të binden për mbështetje të ZHBNj, për ta bërë realitet për qytetet e tyre.*
- III. Qytetet në tranzicion duhet të promovojnë bashkëpunimin dhe planifikimin regjional, me çrast rezultati do të ishte i dobishëm për qytetet dhe shoqëritë e tyre dhe për më shumë të regjionit më të gjërë. Qytetet nuk mund të kenë zhvillimin e bazuar në njohuri nëse qëndrojnë të izoluara si ujdhesa në një regjion më të gjërë të pazhvilluar. Qytetet që synojnë ZhBNj do të arrijnë më shpejtë dhe më lartë shkallën e zhvillimit, poqese qendrat e tjera përreth e synojnë atë poashtu.*

## **Referencat**

---

- *Agjencia Statistikore e Kosovës, dhjetor 2013, “Atlasi I regjistrimit të popullsisë në Kosovë, ESK, Prishtinë”, Prishtinë;*
- *Agjencia Statistikore e Kosovës, 2011, “NJERËZ NË LËVIZJE: analizë e mobilitetit ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal të qytetarëve të Kosovës”, Prishtinë*
- *Berndorf A., 2010, “ Strategic Analysis paper - World Population Trends Towards 2050 and Beyond”, Future Directions International Pty Ltd, Australia*
- *CEC, 1999. “European Spatial Development Perspective: towards balanced and sustainable development of the territory of the European Union”, Luxembourg;*
- *Davidson, F. 1999, “Towards sustainable urban development: A strategic approach, Consultative guidelines for Urban Development Cooperation”, EC-Brussels;*
- *DC Agenda, 2003, “Planning a City for Social Equity” – White paper. Washington;*
- *DG, Territorial Cohesion, 2006, “Territorial Agenda of the European Union, Towards a More Competitive Europe of Diverse Regions”, Finland;*
- *Dijkstra L., Poelman H., January 2012, short papers on regional research “CITIES IN EUROPE THE NEW OECD-EC DEFINITION”, Brussels;*
- *Duranton, G., Puga, D., 1999, “Diversity and Specialisation in Cities: Why, where and when does it matter?” London School of Economics, University of Toronto;*
- *EC, CARDS assistance Programme to the Western Balkans 2001, “Regional Strategy Paper (2002-2006)”, Brussels;*
- *ESPON, 2005. Potentials for polycentric development in Europe. ESPON 1.1.1 Final report. Available from [http://www.espon.eu/mmp/online/website/content/projects/259/648/file\\_1174/fr-1.1.1\\_revised-full.pdf](http://www.espon.eu/mmp/online/website/content/projects/259/648/file_1174/fr-1.1.1_revised-full.pdf);*
- *EU pillar, PISG, Energy office, 2003, “Energy strategy and policy of Kosova – white paper”, Prishtina;*
- *Euricur, 2006, “Empowering metropolitan regions through new forms of cooperation, new perspectives on metropolitan regions”, Rotterdam;*
- *European Commission, “Cities and the Lisbon Agenda: Assessing the performance of cities”, Brussels;*
- *European Stability Initiative, 2002. “De-industrialisation and its consequences, a Kosovo story”, Prishtina – Berlin;*
- *Florida, 2002, “The rise of the Creative Class” . <http://www.creativeclass.org/>;*
- *Glasson J. and Marshall T., 2007, “Regional Planning”, Routledge, London;*



- Gribben, A., 2003, “Certifying vocational skills in Kosovo: establishing first institutions”, European Training Foundation, -Prishtina;
- Hekurrudhat e Kosovës Sh.A., 2010., “Revista periodike e Hekurrudhave të Kosovës Nr.II”, Prishtinë;
- [http://ec.europa.eu/regional\\_policy/sources/docoffic/official/reports/som\\_en.htm](http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/som_en.htm);
- International Monetary Fund, 2004. “Aide-Mémoire Staff Visit to Kosovo March 10–19”, Prishtina;
- KK e Fushë Kosovës, Kosovë, mars 2011, “Plani Zhvillimor i Fushë Kosovës”;
- KK e Lipjanit, Kosovë, dhjetor 2004, “Plani Zhvillimor I Lipjanit”;
- KK e Obiliqit/Kastriotit, Kosovë, prill 2010, “Plani Zhvillimor I Kastriotit 2009 - 2020”;
- KK e Podujevës, Kosovë, maj 2010, “Plani Zhvillimor I Podujevës”;
- KK e Prishtinës, Kosovë 2013, “Plani Zhvillimor Urban I Prishtinës 2013 – 2025+”;
- KK e Prishtinës, Kosovë, “Plani Strategjik I Prishtinë 2004 – 2020+”, Prishtinë;
- KK e Prishtinës, Kosovë, 2013, “Plani Zhvillimor Komunal I Prishtinës 2013 – 2023+”;
- KK Prishtina, korrik 1987, “PUP -2000, Generalni Urbanisticki Plan Pristine”, Prishtinw;
- Klassen, Van den Berg, L., and Van der Meer, L.,1988, “The City: Engine Behind Economic Recovery” Euricur, Rotterdam;
- Knight, R., 1994, “Knowledge-based Development: Policy and Planning Implications for Cities”, Internationalies Forschungszentrum, Kulturwissenschaften, Vienna, Austria;
- Kojic B.Dj. “Stari Balkanski gradovi”, Instituti pwr arkitekturw dhe urbanizwm tw Serbisw, IAUS, 1976, Beograd;
- Kosova Government, 2004, “Kosova General Government 2004 Budget”. Pristina, Kosova Government;
- KTA, 2004, “Draft Strategy of the Privatisation Department of the Kosova Trust Agency,” Prishtinw;
- Laundry, Ch., 2000, “The Creative City - a toolkit for urban innovators”. Earthscan publications Ltd, London;
- MESP, 2004, “The Vision, Goals and Principles of Spatial Development in Kosova-2005-2015”, Prishtina;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, nëntor 2011Kosovw, “Plani Hapsinor I Kosovës 2010 – 2020+”;
- Municipality of Prishtina, 2004, “Strategic urban development plan of Prishtina – Prishtina 2020 +”, Prishtina;
- Quigley, J., 2005, “Urban Diversity and economic growth” , The Journal of Economic Perspectives, Washington;

- RePUS, 2007. *Regional Polycentric Urban System. Final report: Interreg III B strategy for a regional polycentric urban system in Central Eastern Europe Economic Integrating Zone.* Available from [http://www.repus.it/repus-docs/repus\\_finalreport.pdf](http://www.repus.it/repus-docs/repus_finalreport.pdf) ;
  - RIINVEST, 2002. “Foreign Direct Investment in Kosova.” *Research Report, Pristina;*
  - Seidel, M. A.2010, “Innovative Spatial Planning Instruments and their Contribution to European Integration”, *Conference-Paper, European Management Institute, University of Waterloo, 2010;*
  - SIDA, 2003, “*Restructuring of railways in Kosova*”- *Final report, Prishtina;*
- 
- The World Bank, “Knowledge Economy Index (KEI) 2012 Rankings” Available from <http://siteresources.worldbank.org/INTUNIKAM/Resources/2012.pdf> ;
  - UK Department of Trade and Industry report, 2003, “*Cities, Regions and Competitiveness*”, London;
  - UNDP, 2012 “*Raporti I zhvillimit njerwzor nw Kosovw 2012*”, *sektori privat dhe punwsimi*”, Prishtinw;
  - UNITED NATIONS, 2008, “ *Spatial planning : Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition*”, New York and Geneva;
  - UNMIK regulation no.2003/30, “*Promulgation of the law on Kosova Spatial Planning*”, Prishtina;
  - *Urban Research & Practice: “City regions and polycentric territorial development: concepts and practice;*
  - Van den Berg et al, 2004, “*European Cities in the knowledge economy*”, Euricur, Rotterdam;
  - Van den Berg, L. Braun, E., Van Winden, W., 2001, “*Growth clusters in European metropolitan cities*” – Euricur, Rotterdam;
  - Van den Berg, L., at al 2003, “*The student City: Strategic Planning for students*”. *Communities in EU cities. Research abstract, EURICUR, Rotterdam:* <http://www.euricur.nl/themes/studentcity.htm>;
  - Van den Berg, L., Braun, E., Van Winden W. 2001, “*Growth Clusters in European Cities:An Integral Approach*”, the Editors of *Urban Studies, Urban and Regional Economics Syllabus-2005, IHS, Rotterdam;*
  - Van den Berg, L., E. Braun, Van der Meer J., 1997, “*Metropolitan Organising Capacity*”. Aldershot, England: Avebury;
  - Van den Berg, L., Berden K., Daemen H., 2004, “*Urban development paradigms and trends*”: IHS, reader master course in urban management and development -2004 2005 Rotterdam;
  - Van den Dool, L.Th. 2004, “*Competitiveness through Organizing Capacity*”, *Public Management: An Introduction for Public Managers in Developing and Emerging Economies Syllabus, IHS, Rotterdam;*

- *Van Winden, W. 2005, "Globalisation and Urban Competitiveness: Challenges for Different Types of Urban Regions", Euricur, Rotterdam;*
- *Van Winden W., Vvan den Berg L., 2004, "Cities in the knowledge economy: new governance challenges", Euricur, Rotterdam;*
- *Veugelers R., Mrak M., 2009, "The Knowledge Economy and Catching-up Member States of the European Union ", Report prepared for Commissioner's Potocnik's Expert Group, "Knowledge for Growth", Brussels;*
- *World Bank report, 2004. "Kosova Economic memorandum", Washington DC;*
- *Zukin Sh., 1995, "The Culture of Cities". Cambridge Massachusetts, USA;*